

VENDIM
Nr. 787, datë 18.12.2024

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË
2024–2030, TË PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT DHE TË PASAPORTËS SË
TREGUESVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 823, datë 24.12.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 dhe të planit të saj të veprimit”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, institucionet e drejtësisë, ministritë e linjës dhe institucionet e tjera përgjegjëse të përcaktuara në strategjinë, në planin e veprimit, si dhe në pasaportën e treguesve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË 2024–2030
Tiranë, 2024

Shkurtime

ASH	Avokatura e Shtetit
AP	Avokati i Popullit
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMA	Autoriteti i Medias Audiovizive
ANT	Analizë të Nevojave për Trajnim
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
BE	Bashkimi Evropian
CPT	Komiteti për Parandalimin e Torturës
CEPEJ	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
DHASH	Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë
DHKND	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
DHKN	Dhoma Kombëtare e Noterisë

EACIDS	Sistemi Elektronik i Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit
ELP	Edukimi Ligjor i Publikut
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJL	Gjykata e Lartë
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJDBE	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
HGJ	Harta Gjyqësore
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
INSTAT	Instituti i Statistikave
IKP	Institucioni i Komisionerëve Publikë
IPSIS	Sistemi Informativ i Planifikimit të Integruar
IPA	Instrumenti i Asistencës së Paraaderimit
KSH	Kuvendi i Shqipërisë
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KED	Këshilli i Emërimeve në Drejtësi
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelit
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KE	Këshilli i Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KV	Komisioni i Venecias
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MSHMP	Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin
MSHRF	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MAPA	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsion
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
M&V	Monitorim dhe Vlerësim
OJQ	Organizata Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE)
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PNK	Plani i Ngritjes së Kapaciteteve

SPAK	Prokuroria e Posaçme
SND	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SKZHIE	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030

Tabela e përmbajtjes

PJESA I – KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i Dokumentit Strategjik
2. Kuadri ligjor dhe institucional dhe lidhja me dokumentet strategjike të tjera
3. Analiza e zbatimit të SDN 2021–2025. Arritjet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i saj
4. Vizioni dhe misioni i dokumentit

PJESA II – QËLLIMI I POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË, MASAT DHE REZULTATET E PRITSHME TË SND 2024–2030

1. Qëllimet e politikës së SND 2024–2030
2. Objektivat specifike, masat dhe rezultatet e pritshme

PJESA III – PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, KOORDINIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

1. Përgjegjësia e institucioneve
2. Llogaridhënia dhe koordinimi
3. Monitorimi dhe Raportimi
4. Vlerësimi

PJESA IV – ANALIZA BUXHETORE

1. Ndarja e shpenzimeve
2. Natyra ekonomike e kostove

ANEKS I

MATRICA E MASAVE DHE AKTIVITETEVE TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË 2024–2030

Matrica me masa, aktivitete, afati i zbatimit të tyre, si dhe institucionet përgjegjëse/bashkëpërgjegjëse

PJESA I – KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrje: Qëllimi i Dokumentit Strategjik

Nga viti 2016, sistemi i drejtësisë vazhdon t'ri nënshtrohet një reforme të thellë synimi i së cilës është adresimi i problematikave të rënda, dhe njëkohësisht përmbushja e standardeve evropiane. Ndryshimet kushtetuese dhe paketa e ligjeve organike të miratuara në kuadrin e Reformës në drejtësi (Reforma), përmbajnë dispozita të përcaktuara qartë që garantojnë pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin, integritetin e sistemit gjyqësor, si dhe përmirësimin e mekanizmave llogaridhënës dhe monitorues të funksionimit të saj.

Hartimi i Strategjisë së Re të Drejtësisë, u mbështetet në një analizë të plotë të historikut të reformave të sistemit të drejtësisë. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë ka luajtur një rol kyç në drejtimin e reformave në këtë sektor, duke synuar përmirësimin e qasjes në drejtësi, rritjen e besimit të publikut në sistemin shqiptar të drejtësisë dhe nxitjen e integritimit evropian. Këto objektiva janë reflektuar në dokumentet e reja për periudhën 2024–2030, të cilat synojnë të vazhdojnë dhe të thellojnë reformat e filluara, duke u mbështetur në arritjet e mëparshme dhe duke adresuar sfidat e reja në fushën e drejtësisë.

Sistemi i drejtësisë ka kaluar nëpër këto faza për të përmbushur standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

- **Faza I (2016–2020).** Në këtë fazë u hodhën bazat ligjore dhe institucionale të reformës në drejtësi, përfshirë ndryshimet kushtetuese dhe ndryshime të tjera legislative në të gjithë sektorin, duke e sjellë kornizën ligjore në standardet evropiane. U krijuan institucione të reja në përputhje me modelet evropiane dhe nisi dhe vijoi me hapa të shpejtë procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve.

- **Faza II (2021–2025).** Në këtë fazë u konsolidua kuadrit institucional, u zbatuan praktikat moderne evropiane në drejtësinë penale, u përmirësua infrastruktura e sistemit të drejtësisë dhe mundësi të reja për teknologjinë e informacionit, përfshirë zgjidhje inovative elektronike, që mbështetën rritjen thelbësore të efikasitetit dhe transparencës në sektorin e drejtësisë.

- **Faza III (2024–2030).** Konsiderohet si faza e fundit e reformave madhore¹. Në këtë fazë synohet të konsolidohet kuadri ligjor në përputhje me *acquis* të BE dhe standardet evropiane, të eliminohet *backlog*-u, të rritet cilësia e shërbimeve dhe të ofrohet një drejtësi në të njëjtat nivele si në vendet e BE-së. Prandaj, faza e tretë e SND-së, do të përqendrohet në konsolidimin e kuadrit institucional dhe përmirësimin e infrastrukturës së sistemit të drejtësisë, për të siguruar që institucionet e drejtësisë janë të pajisura me burimet dhe infrastrukturën e nevojshëm për të funksionuar në mënyrë efektive, si dhe synohet forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe transparencës.

Duke qenë se reforma në drejtësi, ka kaluar dy fazat dhe është në fazën e tretë të saj, u vlerësua e nevojshme ndërmarrja e nismës strategjike që reformon sistemin e drejtësisë përgjatë viteve 2024–2030. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030 është strategjia e tretë e cila adreson gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025, si dhe të gjitha rekomandimet në kuadër të procesit të negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, të specifikuar në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, kapitulli 23 – “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.

Në kuadër të kësaj reforme, një hap vendimtar ishte ngritja e organeve të qeverisjes së gjyqësorit dhe prokurorisë (Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi), si dhe krijimi i një kuadri institucional të plotë për hetimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar që përfshin Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH) dhe Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe atë të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Evidentimi i prioriteteve të reja të sistemit të drejtësisë në kuadër të Reformës në Drejtësi, si zbatimi i hartës gjyqësore, zbatimi i strategjive dhe planeve të komunikimit, rritja e kapaciteteve të KLGJ-së dhe KLP-së në zbatimin e funksioneve të tyre, zvogëlimi i *backlog*-ut në gjykata, plotësimi i vendeve vakante të gjyqtarëve dhe prokurorëve të krijuar kryesisht për shkak të procesit të *vettingut* etj., e bën të nevojshme hartimin e një dokumenti të ri strategjik.

Situata aktuale kërkon realizimin e masave të parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, miratuar me VKM nr. 736 datë 13.12.2023, “Për miratimin e Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës”, i cili përpos masave me rëndësi strategjike për konsolidimin e sistemit të drejtësisë, dikton nevojën për përditësimin e SND-së 2021–2025 dhe miratimin e një Strategjie Ndërsektoriale të Drejtësisë të re, me një kohëzgjatje më të gjatë 2024–2030.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030, Plani i Veprimit si dhe pasaporta e treguesve, hartohen nga Ministria e Drejtësisë, si një dokument politik i Qeverisë Shqiptare dhe si një nga prioritetet kyçe të institucionit, dhe do të adresojë politika të sistemit të drejtësisë sipas masave strategjike të parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës – kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.

Strategjia është hartuar nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë, institucionet e linjës, institucionet e tjera të pavarura dhe

¹ Reformat mund të vijojnë edhe pas përfundimit të fazës III, por është parashikuar që do të jenë të lidhura me përmirësimet graduale në nivel institucional, por pa përfshirë reforma të gjera ndërsektoriale.

institucionet e varësisë së MD-së, pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur me urdhrin nr. 20, datë 31.1.2024 të kryeministrit, “Për hartimin e strategjisë të drejtësisë 2024–2030, të planit të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”, dhe me mbështetjen dhe ekspertizën e Projektit JustAL-it, dhe prezencës së OSCE në Shqipëri, përgatitën Strategjinë e Re të Drejtësisë 2024–2030.

Strategjia dhe dokumentet e saj strategjik është konceptuar si një strategji ombrellë, e cila përmban objektivat më të rëndësishëm dhe rezultatet e pritshme nga zbatimi i saj për 7 vjetët e ardhshëm, hartuar në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Ndryshe nga SND 2021-2025, SND 2024–2030, do të adresojë edhe elementë të tillë si informimi, sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi ligjin, sistemin e drejtësisë dhe aksesin në drejtësi. Pas një analize të kryer nga Ministria e Drejtësisë, është vlerësuar se një nga qëllimet politike të kësaj strategjie duhet t’i dedikohet fushës së edukimit ligjor të publikut, në përmbushje dhe në funksion edhe të Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut 2019–2023. Kjo do të shërbejë për arritjen sa me cilësore të qëllimeve politike, të cilat do të synojnë konsolidimin e kapaciteteve të sistemit të drejtësisë dhe qeverisjes së institucioneve, duke përfshirë fuqizimin e mëtejshëm të edukimit ligjor të publikut, kërkesë e parashtruar edhe nga Bashkimi Evropian.

2. Kuadri ligjor dhe institucional dhe lidhja me dokumente strategjike të tjerë

2.1. Kuadri Ligjor dhe Institucional

Organizimi dhe funksionimi i sistemit të drejtësisë i nënshtrohet parimeve të mirafirmuara në Kushtetutë dhe në ligje, ndër të cilat parimet e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional, parimet e efikasitetit, paanësisë, meritokracisë dhe zhvillimit të karrierës, parimet e objektivitetit, proporcionalitetit, parimin e të drejtës së aksesit në drejtësi dhe atë të një procesi të rregullt ligjor, në respekt të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Reforma në Drejtësi solli ndryshime rrënjësore në sistemin e drejtësisë, duke reformuar si kuadrin normativ dhe atë institucional. Nga pikëpamja normative, u miratuan së pari ndryshimet kushtetuese me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’”, të ndryshuar. Me këto ndryshime kushtetuese, reforma në drejtësi i hapte rrugën ndryshimeve ligjore dhe institucionale me qëllim garantimin e pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizmit, integritetit të sistemit gjyqësor, duke përmirësuar mekanizmat e llogaridhënies dhe monitorimit të funksionimit të saj.

Në kuadrin e reformave institucionale të sistemit të drejtësisë, një hap vendimtar shënoi ngritja dhe funksionimi i plotë i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, si dhe u krijimi i një kuadri të plotë institucional për hetimin dhe ngritjen e akuzës në çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe hetimin e funksionarëve sipas dispozitave parashikuara në Kushtetutë dhe në Kodin e Procedurës Penale. Në këtë kuadër, u krijua dhe u ngrit Byroja Kombëtare e Hetimit, Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë dhe atë të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Me ligjin nr. 16/2022, “Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’”, të ndryshuar, u përcaktua se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit duhet të përfundojë procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (*vetting*) brenda datës 31.12.2024.

“SND 2024–2030” është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, dhe me konventat ndërkombëtare, si më poshtë vijon:

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, së bashku me protokollet shtesë;
- Ligji nr. 7510, datë 8.8.1991, “Për aderimin e RSH-së në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”;

- Ligj nr. 9725 datë 7.5.2007, “Për aderimin e RSH-së në protokollin shtesë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”;
- Ligji nr. 28, datë 20.3.2014, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPAL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional”
- Ligji nr. 9726, datë 7.5.2007, “Për aderimin e RSH-së në protokollin e dytë shtesë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”;
- Ligji nr. 8135, datë 31.7.1996, “Për aderimin në Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues”;
- Ligji nr. 9094, datë 3.7.2003, “Për ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruar”;
- Ligji nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë;
- Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”.

2.2 Lidhja e SND-së me kuadrin ligjor kombëtar

“SND 2024–2030” lidhet me kuadrin ligjor kombëtar për Reformën në Drejtësi. Shqipëria ka një kuadër ligjor dhe nënligjor të plotë që mbulon fushën e sistemit të drejtësisë.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton rregulla të përgjithshme lidhur me rivlerësimin kalimtar të të gjitha subjekteve të rivlerësimit, duke përcaktuar parimet e organizimit të procesit të rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, të metodologjisë, procedurave dhe standardeve të rivlerësimit. Ky ligj përcakton rregulla lidhur me organizimin dhe funksionimin e institucioneve të rivlerësimit si dhe rolin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të organeve të tjera shtetërore dhe të publikut në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcakton rregulla lidhur me statusin e magjistratëve, lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre, pranimin dhe emërimin e tyre, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre, vlerësimin etik dhe profesional të tyre, përgjegjësisë disiplinore, penale dhe civile të tyre. Gjithashtu, në ligj, përcaktohen rregulla lidhur me standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, pagës dhe përfitimeve të tjera financiare dhe shoqërore, transferimit, ngritjes në detyrë apo komandimit të magjistratit.

Ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcakton rregulla lidhur me organizimin dhe funksionimin e sistemit të gjykatave në Republikën e Shqipërisë, kompetencat dhe madhësitë e gjykatave, organizimin e brendshëm të gjykatave, funksionimin e administratës së gjykatës, statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë.

Ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar përcakton parime dhe rregulla lidhur me organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe të Shkollës së Magjistraturës.

Ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcakton rregulla lidhur me organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, kushtet, kriteret dhe procedurat për emërimin e prokurorit të përgjithshëm, marrëdhëniet e prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm me institucionet e tjera shtetërore, me subjekte të tjera publike ose private dhe me publikun, funksionimin e administratës së prokurorisë, statusin e nëpunësve civilë të prokurorisë.

Ligji nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar përcakton rregulla lidhur me organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Njësisë së Pavarur Hetimore, si organe kushtetuese, sipas pikës 4, të nenit 148, të Kushtetutës, së ndryshuar. Ligji nr. 95/2016 përcakton kushte dhe procedura për emërimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, përcakton kompetencat lëndore parësore dhe të tjera të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme, përcakton

kushte dhe kritere shtesë që duhet të përmbushin shtetasit për t'u emëruar, transferuar apo për t'u ngritur në detyrë si gjyqtarë ose punonjës pranë gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorë dhe punonjës pranë Prokurorisë së Posaçme, si dhe për t'u punësuar pranë Njësisë së Pavarur Hetimore, si dhe përcakton marrëdhëniet e Prokurorisë së Posaçme me institucione të tjera shtetërore, subjekte të tjera publike apo private, si dhe me publikun. Gjithashtu, me anë të këtij ligji përcaktohen rregulla lidhur me organizimin dhe funksionimin e procesit të kontrollit të figurës, vëzhgimit të të dhënave financiare dhe vëzhgimit të telekomunikacioneve të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendës drejtorit, hetuesve dhe punonjësve të shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe vëzhgimit të të dhënave financiare dhe vëzhgimit të telekomunikacioneve të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre.

Ligji nr. 111, datë 14.12.2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ka si qëllim të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë; të sigurojë mirorganizimin, miradministrimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike; të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

Të tjera ligje me rëndësi janë:

- Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur”;
- Ligji nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”;
- Ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 146/2014, datë 30.10.2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 97/2013, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar;
- Ligji nr. 119, datë 18.9.2014, “Për të drejtën e informimit”;
- Ligji nr. 55/2018 datë 23.7.2018, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10385 datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror”;
- Ligji nr. 10 031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 110/2018, “Për noterinë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës”;
- Ligji nr. 79/2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”;

- ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;
- Ligji nr. 9614, datë 21.9.2006, “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”;
- Ligji nr. 10 093, datë 9.3.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”;
- Ligji nr. 69 datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 98/2017, “Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 60, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 15 datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 80, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligji nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, i ndryshuar.

Të tjera akte nënligjore me rëndësi janë:

- Urdhri nr. 20 i Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, datë 31.1.2024, “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës, Për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030, të Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve”;
- Urdhri i Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë nr. 90 datë 1.8.2023, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”:
- Programi Qeverisës i Këshillit të Ministrave 2021-2025;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 22.02.2023, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 606, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar
- Dokumenti i Politikave “Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë, Plani i Veprimit (PV) dhe Pasaporta e Treguesve, 2024–2030”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 642, datë 29.10.2021, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, i ndryshuar”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 13.12.2023, “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 11.1.2024, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2024–2026”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS) i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, trajnimin e nëpunësve civilë, si dhe të çdo individi tjetër jashtë shërbimit civil”, i ndryshuar.

2.3 Lidhja e “SND 2024–2030” me dokumentet strategjike:

2.3.1. Lidhja e SND 2024–2030 me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030:

“SND - 2024–2030”, së bashku me dokumentet strategjike harmonizohet dhe është në përputhje të plotë me qëllimet, objektivat dhe parashikimet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (SKZHIE 2022–2030), veçanërisht me shtyllën I “Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë”. Kjo shtyllë parashikon si komponentë kryesorë forcimin e mëtejshëm të institucioneve, funksionimin e sistemit të drejtësisë, modernizimin e shërbimeve publike dhe digjitalizimin, luftën ndaj korrupsionit dhe sigurimin e llogaridhënies dhe transparencës në sektorin publik, zgjerimin e decentralizimit dhe demokracisë vendore si dhe përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në këto procese, të cilët mbeten përparësi kyçe të qeverisjes së mirë për Shqipërinë.

Lidhur me sistemin e drejtësisë, në SKZHIE 2022–2030 parashikohet konkretisht reformimi i sistemit të drejtësisë që synon: i. konsolidimin e ndryshimeve ligjore dhe institucionale; ii. qasje të mirë në sistemin e drejtësisë dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve nga gjykatat, institucionet e drejtësisë penale, nga institucione të tjera të varësisë të Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me standardet Evropiane; iii. përmirësimin e infrastrukturës së sektorit dhe krijimin e një baze të dhënash elektronike për gjyqësorin të cilat ndikojnë në rritjen e efikasitetit dhe llogaridhënies; iv. eliminimin e *backlog*-ut; v. ofrimin e një drejtësie në nivelin dhe në përputhje me standardet e BE-së; vi. forcimin e besimit të publikut dhe transparencës në këtë sektor.

Në seksionin “Reformimi i sistemit të drejtësisë” të SKZHIE-së parashikohen katër qëllime të politikës:

- Qëllimi i parë: Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet evropiane, duke garantuar pavarësinë, eficiencën dhe llogaridhënien;

- Qëllimi i dytë: Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane;

- Qëllimi i tretë: Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit;

- Qëllimi i katërt: Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucionet e sektorit.

2.3.2. Lidhja me Programin e Qeverisë:

SND 2024–2030 lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me Programin Qeverisës 2021–2025, kryesisht me prioritetin “Shqipëria e së drejtës”.

2.3.3. Lidhja e SND 2024–2030 me Strategjinë Ndërsektoriale të Viktimave të Krimit 2024–2030:

Strategjia Ndërsektoriale e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit 2024–2030 është miratuar me vendimin nr. 729, datë 13.12.2023, të Këshillit të Ministrave. Vizioni i kësaj strategjie është: “Një sistem drejtësie penal efektiv, që garanton pa diskriminim të drejtat e viktimave në të gjitha fazat e procesit penal dhe që mban parasysh nevojat e veçanta të tyre”.

“SNMVK 2024–2030” përcakton prioritete që lidhen me informimin, ndërgjegjësimin, komunikimin efektiv me publikun e gjerë lidhur me shërbimet mbështetëse të viktimave të krimit, me mbledhjen, përpunimin, publikimin e statistikave të konsoliduara në përputhje me standardet ndërkombëtare. Dokumenti strategjik ndërsektorial i viktimave të krimit synon përafrim të legjislacionit penal, procedural penal dhe ligjeve të tjera në përputhje me *acquis* e Bashkimit Evropian dhe akteve ndërkombëtare të tjera. Gjatë periudhës së zbatimit të “SNMVK 2024–2030” synohet lehtësimi i aksesit në drejtësi dhe i ndihmës juridike parësore e dytësore, duke forcuar kapacitetet e mbrojtësve ligjorë, lidhur me teknikat e mbrojtjes dhe të komunikimit me viktimat e krimit. Gjithashtu SNMVK synon të përmirësojë aksesin në shërbimet mbështetëse përgjatë viteve

2024–2030, të promovojë drejtësinë restaurese dhe ndërmjetësimin për viktimat në përputhje me standardet evropiane dhe të konsolidojë bashkëpunimin dhe koordinimin e aktorëve në nivel lokal dhe qendror lidhur me shërbimet ndaj viktimave të krimit.

SNMVK 2024–2030 adreson rekomandimet e kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” dhe lidhet me nenin 2, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 “Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së.

2.3.4. Lidhja e SND 2024–2030 me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022–2026

“SND 2024–2030” lidhet me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022–2026 (“SNDM 2022–2026”), e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 892, datë 27.12.2022. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022–2026, plani i saj i veprimit, si dhe pasaporta e treguesve ka katër qëllime strategjike për sistemin e drejtësisë penale për të mitur. Në këtë kontekst, SDM 2022–2026 synon përmirësimin e sistemit të drejtësisë në lidhje me aspekte si informimi, edukimi, ndërgjegjësimi dhe përmirësimi i aksesit në drejtësi, duke ofruar shërbime të cilësore të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, ndërmjetësim, mbledhje, përpunim dhe publikim të statistikave për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale, dhe shërbime mbështetëse për çdo fëmijë.

“SDM 2022–2026” adreson rekomandimet e kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, dhe lidhet me nenin 2 “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 “Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88 “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së.

“SND 2024–2030” synon të avancojë me reformat madhore të nisura në drejtësi që nga viti 2016. Në këtë kuadër “SND 2024–2030”, synon prioritetet që lidhen me informimin, ndërgjegjësimin, përmirësimin e komunikimit publik lidhur me reformën në drejtësi, rritjen e aksesit në drejtësi, forcimin e mekanizmave për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, ngritjen e kapaciteteve të ndërmjetësve, rritjen e cilësisë së arsytimeve të vendimeve gjyqësore, garantimin e parimit të barazisë para ligjit, respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe vendimeve të GJEDNJ-së në kuadër të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sipas Konventave Ndërkombëtare.

2.3.4. Lidhja e “SND 2024–2030” me Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) DHE Raport Progresin të Komisionit Evropian:

SND 2024–2030 lidhet me Planin Kombëtar për Integritimin Evropian 2024–2026 (PKIE), i cili parashikon, se: “*Procesi i negociatave dhe, më pas, anëtarësimi në Bashkimin Evropian, do të mbështesë më tej demokratizimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, do të nxisë konsolidimin e institucioneve publike dhe vazhdimin e proceseve reformuese, duke përshpejtuar zhvillimin ekonomik dhe përfaqsimin me nivelet më të mira evropiane të mirëqenies, konvergjencës dhe gjithëpërfshirjes sociale*”. Në këtë kontekst, “SND 2024–2030”, lidhet me Planin Kombëtar për Integritimin Evropian, lidhur me angazhimet në kuadër të Udhërrëfyesit për Grup-kapitullin 1 “Themelorët” (“Shteti i së Drejtës”). Në vijim të angazhimeve të marra në kuadër të reformave në drejtësi, “SND 2024–2030” duhet të adresojë rekomandimet e Komisionit Evropian në Raportin e vitit 2023 për Shqipërinë, rekomandimet e dhëna në kuadër të takimeve dhe mekanizmave të përbashkët të ngritura, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si dhe përputhshmërinë me objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim Evropian 2022–20304 dhe Programin e Qeverisë Shqiptare, si dhe me dokumentet e tjera strategjike të miratuara.

Plani Kombëtar për Integritimin Evropian (PKIE) 2024–2026 përfshin masa ligjore, institucionale, administrative që parashikohen të shtrihen deri në vitin 2026, me objektiva të synuar që lidhen me përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së dhe forcimin e kapaciteteve për zbatimin e tij. Synohet përafrimi me *acquis* të Bashkimit Evropian gjatë vitit 2024: - Në grup-kapitullin 1 “Themelorët”: projektligji “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”. PKIE 2024–2026 synon përafrim të legjislacionit me *acquis* të Bashkimit Evropian gjatë vitit 2025: - Në

grup-kapitullin 1 “Themelorët”: projektligji, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Për vitin 2026, aktet lidhur me të cilat synohet përafrimi me *acquis* të Bashkimit Evropian janë:
- Në grup-kapitullin 1 “Themelorët”: projektligji, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”; projektligji, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”; projektligji, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit”; si dhe projektligji, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

SND 2024–2030 dhe plani i saj i veprimit adreson rekomandimet e Raport Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023 – kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore/nënkapitulli: Të drejtat themelore”.

2.3.5. Lidhja e “SND 2024–2030” me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA)

“SND 2024–2030” lidhet me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, e miratuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare”, me nenet respektive. Nenin 2 i MSA-së “*Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut*”, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të së Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Evropë të Re, respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare, ato të shtetit të së drejtës si edhe për parimet e ekonomisë së tregut, siç pasqyrohen në dokumentin e Konferencës së Bonit të KSBE-së për Bashkëpunimin Ekonomik, formojnë bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të palëve dhe përbëjnë elementët thelbësorë të kësaj marrëveshjeje.

Në vijim, “SND 2024–2030” lidhet me nenin 70, i cili parashikon përafrim të legjislacionit, imponim të ligjeve dhe rregullave të konkurrencës, ku:

1. Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria përpaket të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojnë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet. 2. Ky përafrim fillon në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes dhe do të shtrihet gradualisht në tërë elementët e *acquis* të Komunitetit të përmendura në këtë Marrëveshje brenda periudhës tranzitore të përcaktuar në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje. 3. Gjatë fazës së parë të përcaktuar në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, përafrimi do të përqendrohet në elementët thelbësorë të *acquis* së Tregut të Brendshëm, ashtu si dhe në fusha të tjera të rëndësishme si konkurrenca, të drejtat mbi pronësinë intelektuale, industriale dhe tregtare, prokurimi publik, standardet dhe certifikimi, shërbimet financiare, transporti detar dhe tokësor – duke i kushtuar rëndësi të veçantë sigurisë dhe standardeve mjedisore, si dhe aspekteve sociale – ligji për kompanitë tregtare, kontabiliteti, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e të dhënave, shëndeti dhe siguria në punë dhe mundësitë e barabarta. Gjatë fazës së dytë, Shqipëria përqendrohet në pjesët e mbetura të *acquis*. Përafrimi kryhet në bazë të një programi, për të cilin do të bihet dakord, ndërmjet Komisionit të Komuniteteve Evropiane dhe Shqipërisë. 4. Shqipëria, në pajtim me Komisionin e Komuniteteve Evropiane, do të përcaktojë modalitetet për monitorimin e zbatimit të veprimeve që ndërmerren për përafrimin e legjislacionit dhe imponimin e ligjeve.

Gjithashtu “SND 2024–2030” lidhet me nenin 78, “Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, të MSA-së, i cili saktëson se: “Në bashkëpunimin e tyre në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, palët i kushtojnë rëndësi të veçantë forcimit të shtetit të së drejtës, dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi, si edhe imponimit të ligjeve e administrimit të drejtësisë në veçanti. Bashkëpunimi synon veçanërisht fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe përmirësimin e efikasitetit të tij, përmirësimin e

funksionimit të policisë dhe organeve të tjera ligjzbatuese, duke siguruar trajnime të mjaftueshme dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

“SND 2024–2030” lidhet edhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, ku përcaktohet, se: “Bashkëpunimi midis palëve përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e komunitetit në fushën e statistikave. Ai synon veçanërisht zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm, të aftë për të siguruar të dhëna të krahueshme, të besueshme, objektive dhe të sakta, që nevojiten për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformës në Shqipëri. Ky sistem duhet gjithashtu t’i mundësojë Institutit Shqiptar të Statistikave të përmbushë më mirë nevojat e klientëve vendës dhe ndërkombëtarë (si të administratës publike ashtu dhe të sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të respektojë parimet themelore të statistikave të nxjerra nga OKB-ja dhe Kodi Statistikor Evropian i Praktikës dhe parashikimet e së drejtës Statistike Evropiane, dhe duhet të zhvillohet drejt *acquis*-së së Komunitetit”.

2.3.6. Lidhja e “SND 2024–2030” me dokumentet e tjera strategjike kombëtare

“SND 2024–2030” lidhet me Strategjinë Kombëtare të Sigurisë 2023-2028, Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin e Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024–2025, Strategjinë kundër Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin e Veprimit 2023–2025, Strategjinë Kombëtare të Rinisë dhe Planin e Veprimit 2022–2029, Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030, dhe Planin e saj të Veprimit 2023–2025, Strategjinë Ndërsektoriale për Administratën Publike, Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024–2030, Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020–2025, Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2021–2030, me Dokumentin Politik të Përfshirjes Sociale 2016–2020, si dhe me Strategjinë për Sigurinë Publike dhe Planin e Veprimit 2024–2026.

2.3.7 Lidhja e “SND 2024–2030” me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

SND 2024–2030 parashikon qëllimet dhe objektivat e hartuar në kuadër të përmbushjes së Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 (OZHQ) dhe Agjendës 2030, konkretisht me Objektivin 16 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), “Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”. SND 2024–2030, lidhet me nënobjektivin 16.3, “Promovimi i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë”. Gjithashtu, SND 2024–2030, lidhet me nënobjektivin 16.6, “Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet”, me nënobjektivin 16.7, “Sigurimi i vendimmarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet”, si dhe me nënobjektivin 16.10, “Sigurimi i aksesit të publikut në informacion dhe mbrojtja e lirive themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare”.

Lidhja e “SND 2024–2030” me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës

Udhërrëfytyesi për Shtetin e së Drejtës – kapitulli 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” mbulon tri aspekte madhore që janë: i. Reforma në Drejtësi; ii. Lufta kundër korrupsionit; dhe iii. Të drejtat themelore. Ky dokument me karakter orientues përcakton fushat dhe objektivat e Reformës në Drejtësi, masat strategjike dhe legjislative, kornizën institucionale, kapacitetet dhe performancën për secilin nga institucionet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë të cilat duhet të jetësohen në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030. Reforma në Drejtësi, vendos objektiva vizionare, në kuadër të konsolidimit të arritjeve të mëtejshme të reformës në drejtësi, duke filluar nga finalizimi i procesit të rivlerësimit nga organet e *vetingut* brenda afateve kushtetuese, te garantimi i qëndrueshmërisë së procesit të rivlerësimit të magistratit gjatë gjithë periudhës në detyrë. Në nivel ndërinstitutional, duhet të forcohen kapacitetet e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, të thellohet bashkëpunimi e koordinimi ndërinstitutional, të përmirësohet komunikimi publik në kuadër të Reformës në Drejtësi. Parimet bazë që udhëheqin Reformën në

Drejtësi janë pavarësia dhe paanshmëria, llogaridhënia, cilësia e drejtësisë, efikasiteti, integriteti, profesionalizimi.

Lidhur me pavarësinë dhe paanshmërinë, duhen emëruar magjistratë në përputhje me parimin e meritës dhe avancimi në karrierë duhet të bazohet në parimin e profesionalizmit dhe kontrollit të pasurisë dhe figurës së magjistratit.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), në funksion të këtij udhërrëfyesi duhet të ketë transparencë të plotë për sa i takon funksionimit të tij. Në kuadër të veprimtarisë funksionale, KED-ja duhet të përafrojë plotësisht procedurat e tij me rekomandimet e Komisionit të Venecias. Një nga masat thelbësore të këtij udhërrëfyesi konsiston në parandalimin e ndërhyrjeve, të brendshme apo të jashtme, që mund të influencojnë gjyqtarët, prokurorët dhe stafin e gjykatave në ushtrimin e detyrës.

Lidhur me llogaridhënien dhe integritetin në të gjitha nivelet e gjyqësorit, duhen përditësuar deklaratat e pasurisë së anëtarëve të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë. Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, duhet të ndjekin sistematikisht raportet e deklarimit të pasurisë nga ILDKPKI-ja dhe duhet të ndërmarrin hetime të mëtejshme në kontekstin e shqyrtimit të pasurisë dhe të figurës së magjistratëve, për të hetuar dhe për të raportuar sipas rastit, në prokurori.

Lidhur me cilësinë në drejtësi, duhet përmirësuar performanca e magjistratëve, duke forcuar kapacitetet nëpërmjet trajnimeve, duke përmirësuar gradualisht infrastrukturën gjyqësore, përfshirë krijimin e ambienteve të përshtatshme për Gjykatën e Apelit. Duhet krijuar kushte që mundësojnë aksesueshmërinë e praktikës gjyqësore, veçanërisht atë të vendimeve të Gjykatës së Lartë, dhe duhet përmirësuar cilësia e arsytimit të vendimeve gjyqësore.

Lidhur me efikasitetin, duhet konsoliduar kuadri i përgjithshëm ligjor dhe institucional për të siguruar reduktimin gradual të çështjeve të mbartura dhe uljen në nivel të arsyeshëm të kohëzgjatjes së procedurave, proporcionalisht me rritjen e personelit në gjykata dhe në prokurori. Këshilli i Lartë Gjyqësor, këshillat e gjykatave dhe Prokuroria e Përgjithshme duhet të zhvillojnë dhe miratojnë një strategji të reduktimit të dosjeve të mbetura dhe të shpërndarjes së barabartë të ngarkesës së punës për gjykatat dhe prokuroritë në të gjitha nivelet. Zbatimi dhe rivlerësimi i hartës gjyqësore, duhet t'i komunikohet në mënyrë të vazhdueshme publikut nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Prokuroria e Përgjithshme. Nga ana tjetër, Prokuroria e Përgjithshme, duhet të ndërmarrë masa organizative/procedurale për të koordinuar dhe monitoruar zbatimin e hartës së re gjyqësore në lidhje me prokuroritë.

Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, duhet të forcojë ndërmjetësimin, me trajnime fillestare dhe të vazhdueshme për ndërmjetësit kandidatë dhe të diplomuar, si dhe të kryejë fushata ndërgjegjësuese për ndërmjetësimin. Gjykatat kanë detyrimin ligjor të informojnë palët lidhur me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me anë të ndërmjetësimin.

Për sa i takon efikasitetin nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, duhet garantuar funksionaliteti i sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve (ICMIS), i cili duhet të përfshijë të gjitha proceset dhe detajet e funksionaliteteve. Miratimi dhe zbatimi i një plani strategjik të sistemit të teknologjisë së informacionit, duhet të sigurojë ndërlidhjen me sistemin e drejtësisë, prokurorinë, gjykatat dhe me institucionet e tjera të drejtësisë në mënyrë të tillë që vijohet përdorimi me efikasitet i sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve.

3. Analiza e zbatimit të SDN 2021–2025. Arritjet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i saj

Nevoja për ndërmarrjen e reformave në sistemin e drejtësisë afirmohet që në vitin 2011, me miratimin e Strategjisë së parë Ndërsektoriale të Drejtësisë, dokument politikash që përmban objektiva të rëndësishëm me afat zbatimi dyvjeçar (2011–2013). Në vijim të kësaj reforme, në vitin 2015, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, në bashkëpunim dhe me kontributin e Ministrisë së Drejtësisë, të institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe ekspertëve vendës dhe partnerëve ndërkombëtarë, hartuan dokumentin e parë analitik lidhur me gjendjen aktuale të sistemit të drejtësisë.

Në vijim, u hodhën bazat ligjore dhe institucionale të reformës në drejtësi në vitin 2016, pasi u miratua Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2017–2020, e cila adresonte ndryshimet kushtetuese

dhe legislative në të gjithë sektorin, me një kornizë ligjore dhe institucionale në përputhje me standardet evropiane, duke parashikuar procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në vijim, u miratua Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2017–2020, ku u hodhën bazat për konsolidimin e sistemit të drejtësisë. Nga evidentimi i nevojave për përmirësim në pesë vitet e ardhshme u hodhën bazat për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025, ku merrej angazhimi të thelloheshin ndryshimet e nisura në fazën e parë të Reformës duke harmonizuar njëkohësisht sistemin e drejtësisë me standardet më të mira të BE-së. Me anë të këtij dokumenti strategjik, synohej konsolidimi i ndryshimeve institucionale, përmirësimi i drejtësisë penale në përputhje me standardet më të mira evropiane, infrastruktura në sistemin e drejtësisë me zgjidhje për IT-në, duke përfshirë këtu zgjidhjet inovative elektronike me një rritje thelbësore të efikasitetit dhe transparencës në sektorin e drejtësisë.

Reforma në Drejtësi është kontribut i vyer dhe i mbështetur nga partnerët ndërkombëtarë si Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian. Gjatë dy fazave të fundit, sistemi i drejtësisë ka pësuar reforma të thella në funksion të përmbushjes së standardeve dhe praktikave më të mira evropiane. Reforma në Drejtësi u krye nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese, ligjore dhe institucionale që synonin garantimin e pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizmit dhe integritetit të sistemit gjyqësor, duke përmirësuar mekanizmat llogaridhënës dhe monitorues të funksionimit të tij.

Në kuadrin e reformave institucionale të sistemit të drejtësisë, një hap vendimtar shënoi ngritja dhe funksionimi i plotë i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe ngritja e një kuadri të plotë institucional për hetimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. U krijua dhe u ngrit Byroja Kombëtare e Hetimit, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (2023), zbatimi i reformës në drejtësi ka vazhduar, duke çuar, përgjithësisht, në progres të mirë.

Pas mbajtjes së Konferencës së Parë Ndërqeveritare, më 19 korrik 2022, ku inicioi dhe procesi i takimeve dypalëshe BE–Shqipëri, vendi ynë ka vijuar me monitorime dhe raportime të rregullta ndaj Bashkimit Evropian. Pas një procesi të detajuar *screening* të kapaciteteve institucionale, administrative dhe të kuadrit ligjor shqiptar, Komisioni Evropian publikoi Raportin e Shqyrtimit Analitik në korrik 2023 lidhur me vlerësimet dhe gjetjet kryesore, për reformën në drejtësi dhe të drejtat e njeriut, pjesë e kapitullit 23 të drejtuar nga Ministria e Drejtësisë.

Në kontekstin e integritetit në BE, reforma në sistemin e drejtësisë dhe përparimi në zbatimin e saj mbeten të lidhura ngushtë me përmbushjen e kritereve për anëtarësim, përfshirë shtetin e së drejtës, luftën kundër korrupsionit dhe mbrojtjen e të drejtave themelore. Është jetike që angazhimet e ndërmarra nga Shqipëria në këtë proces të konkretizohen në hapa dhe masa të matshme, të cilat monitorohen dhe vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, për të siguruar një raportim transparent dhe përgjegjësi të plota për çdo përparim apo pengesë të hasur në rrugëtimin drejt integritetit evropian. Me gjithë arritjet tepër të rëndësishme, jetësimi me sukses i Reformës në Drejtësi kërkon vëmendje të shtuar edhe mbi përgjegjësitë që burojnë për institucionet e përfshira, të cilat kërkojnë përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve sipas standardeve evropiane, si dhe përmirësimin e infrastrukturës së sektorit dhe krijimin e një baze të dhënash elektronike për gjyqësorin.

Në kuadrin e politikave të përgjithshme shtetërore u miratua Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Evropian 2022–2030, dokument ombrellë që siguron prioritizimin e politikave në bazë të gjitha strategjiave sektoriale apo edhe ndërsektoriale. SKZHIE 2022–2030 përcakton drejtime politike prioritare afatmesëm dhe afatgjatë për zhvillimin dhe integrimin e vendit, përfshirë dhe shtatë fushat e përgjegjësisë për sistemin e drejtësisë si: i. sistemi i drejtësisë; ii. lufta kundër korrupsionit; iii. të drejtat e njeriut; iv. sistemi i vuajtjes së dënimit; v. procesi legjislativ dhe zgjedhor; vi. çështjet e pronësisë; vii. demokracia.

Gjatë tre vjetëve të fundit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025 janë marrë vendime të rëndësishme, konkretisht me miratimin e hartës së re gjyqësore, si dhe me amendimin e ndryshimeve kushtetuese për zgjatjen e mandatit kushtetues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili pritet të përfundojë në dhjetor 2024. Gjykata Kushtetuese ka plotësuar vakancat e anëtarëve dhe është plotësisht funksionale. Për vitin 2022, u emëruan 22 prokurorë dhe 23 gjyqtarë të rinj të sapodiplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, duke lehtësuar vakumine krijuar për shkak të vakancave që pësoi sistemi i gjyqësorit nga procesi i *vetingut*. U propozuan dhe u miratuan nismat ligjore për institucionet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si dhe u përmirësua kuadri rregullator lidhur me funksionimin e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Prokuroria ka shënuar progres lidhur me rritjen e numrit të hetimeve të kryera dhe po punohet intensivisht për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura nga Gjykata e Lartë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka trajtuar me prioritet kërkesat e trashëguara nga institucionet e mëparshme. Shkolla e Magjistraturës ka siguruar trajnime cilësore në përputhje me nevojat e magjistratëve. Qendra e Teknologjisë së Informacionit miratoi për herë të parë Udhërrëfyesin për zhvillimin e Sistemit të ri të Menaxhimit të Çështjeve.

Ministria e Drejtësisë, si institucioni lider për reformën në drejtësi, ka koordinuar me sukses punën me 55 institucione dhe përgatiti 23 prezantime gjatë takimeve bilaterale. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin 2022 ka tejkaluar targetin për ofrimin e ndihmës parësore dhe dytësore juridike falas me rritjen e numrit të fushatave ndërgjegjësuese për shërbimet e ndihmës juridike falas dhe shpërndarjen e materialeve promovuese. Për herë të parë, është bërë e mundur dhe është miratuar masterplani i ri i burgjeve, ku prioritet përbën ngritja e kapaciteteve të stafit dhe përmirësimi i performancës profesionale.

Duke qenë se Reforma në Drejtësi ka kaluar dy fazat dhe është në fazën e tretë të saj, është vlerësuar e nevojshme hartimi i një dokumenti strategjik që përcakton drejtëtimet e zhvillimeve në sistemin e drejtësisë për vitet 2024–2030. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030, Plani i saj i veprimtimit dhe pasaporta e treguesve (këtu e në vijim “SND 2024–2030”) është strategjia e tretë e cila adreson gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025, si dhe të gjitha rekomandimet në kuadër të procesit të negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, të specifikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, kapitulli 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”. Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës është një dokument orientues i cili, pasi vendos piketat kryesore për adresimin e prioritetëve të Reformës në Drejtësi, rekomandon konsolidimin e një dokumenti strategjik me qasje ndërsektoriale për të orientuar zhvillimet në sistemin e drejtësisë për vitet 2024–2030.

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian (ngritur sipas Urdhrit të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë nr. 57, datë 24.4.2023) konsolidoi gjetjet e tij në një dokument të vetëm, Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës, i cili është dokumenti kryesor me karakter sa orientues edhe rekomandues lidhur me ndërmarrjen e masave strategjike dhe institucionale për sistemin e drejtësisë, duke vendosur piketat hapëse të grup-kapitullit të parë ‘Themeloret’ në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Pjesë e rekomandimeve të këtij Udhërrëfyesi është edhe përditësimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025. Objektivat e kësaj SND 2024–2030 lidhen me konsolidimin e arritjeve të Reformës në Drejtësi, dhe garantimin e pavarësisë, paanshmërisë, llogaridhënies, cilësisë dhe efikasitetit në sistemin e drejtësisë.

Në mënyrë periodike, si institucioni lider për hartimin e politikave në fushën e drejtësisë, Ministria e Drejtësisë ka ndjekur dhe monitoruar zbatimin e SND 2021–2025 dhe ka hartuar raportet e monitorimit të cilat gjenden të publikuara në faqen zyrtare të saj: <https://www.drejtësia.gov.al/plani-i-veprimtimit-të-strategjisë-ndërsektoriale-të-drejtësisë/>

Në mënyrë të përmbledhur, **Raporti Vjetor i Monitorimit për vitin 2021** evidentoi disa arritje të rëndësishme gjatë zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, ku konkretisht mund të përmendim:

- Nga 120 dosje të parashikuara për t'u vlerësuar për vitin 2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka përmblyllur 167 dosje, duke tejkaluar kështu me 39% synimin e vendosur.

- Kolegji të Posaçëm të Apelimit ka shpallur 38 vendime, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në 29 vendime; ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe ndalimin e subjekteve të rivlerësimit të emërohen gjyqtarë apo prokurorë të çdo niveli, anëtar i KLGJ-së ose i KLP-së, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare: në 1 vendim; ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit: në 5 vendime; ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit: në 1 vendim; prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke urdhëruar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të vazhdojë kryerjen e procesit të rivlerësimit: në 1 vendim; prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në 1 vendim. Gjatë periudhës janar–dhjetor 2021, në regjistrin e denoncimeve të publikut të KPA-së janë regjistruar 151 denoncime.

- KLGJ ka sugjeruar draftpropozimet ligjore mbi paketën e eficiencës miratuar nga Kuvendi në mars të 2021-shit. Pjesë e kësaj pakete ishin ligjet bazë të reformës ndër të cilat përmendim ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorive në Republikën e Shqipërisë”.

- Për të shmangur efektet e uljes së numrit të prokurorëve nga procesi i *vetingut*, Kuvendi i RSH-së, me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm ka shtuar 30 vende për oficerë të policisë gjyqësore në strukturën e prokurorisë, shoqëruar me fondin përkatës nga Ministria e Financave. Në vijimësi, duke analizuar kërkesat dhe nevojat e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm janë kryer ndërhyrje strukturore për funksionimin sa më eficient të prokurorive.

- Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që në vitin e parë të funksionimit (2020) dhe duke vijuar në vitin 2021, ka nisur ngritjen e grupeve të punës për administrimin dhe kategorizimin e ankesave të dorëzuara pranë organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare deri në krijimin e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pas përfundimit të procesit të kategorizimit, ka vijuar puna me shpërndarjen e ankesave me objekt magjistratë prokurorë dhe gjyqtarë të administruara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas një përparësie të caktuar.

- Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka treguar një vëmendje të veçantë lidhur me rritjen e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke i dhënë prioritet zhvillimit të trajnimeve nga ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë që nga krijimi i institucionit. Konkretisht, për trajnimin e njësisë së inspektorëve deri tani Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka pasur bashkëpunime me organizata të huaja si Taiex, Opat, Cepej, Misioni Euralius V etj., dhe me ASPA-n. Me partnerë të huaj janë kryer 9 trajnime gjatë vitit 2021.

- Është rinovuar rrjeti informatik i Gjykatës Kushtetuese, janë siguruar *software*-et dhe *hardware*-et e planifikuara.

- Është krijuar databaza e të dhënave të lektorëve dhe trajnerëve të Shkollës së Magjistraturës, që kanë njohuri mbi legjislacionin e BE-së. Është kryer identifikimi nga pikëpamja sasiore e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve që do të trajnohen lidhur me legjislacionin dhe standardet e BE-së dhe praktikën ndërkombëtare. Gjatë kësaj periudhe zbatimi të planit të veprimit, janë identifikuar edhe problematika, duke ndikuar në realizueshmërinë e disa prej objektivave të strategjisë dhe në arritjet e qëllimit themelor dhe përfundimtar të politikave.

- 8153 persona kanë përfituar ndihmë juridike parësore gjatë vitit 2021 duke tejkaluar duke rritur vlerën e synuar me 94.12%.

- % e inspektimeve të kërkuara ligjërisht për noterët publikë të kryera nga MD janë tejkaluar nga vlera e synuar për vitin 2021, duke arritur në 63%.

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë pas kryerjes së analizës në lidhje me nevojën për hartimin e legjislacionit, ka ndërmarrë të gjitha proceset për të hartuar draft-aktet nënligjore sipas ndryshimeve të paketës legjislative penitenciare. Gjithashtu,

janë hartuar të gjitha rregulloret, ku ndër to është në proces miratimi Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve me Vendim të Këshillit të Ministrave.

- Është kryer studimi i status *quo-së* dhe analiza e ndërhyrjes për Kodin e Procedurës Penale (KPP). Është përgatitur projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012 të ndryshuar, i cili iu përcoll për mendim institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare.

- DPB-ja është në hapat e fundit të finalizimit të programit “Aftësitë për jetën”, të cilat do të adresojnë nevojat e të burgosurve në funksion të rehabilitimit holistik të tyre dhe riintegrimin të mëtijshëm në shoqëri. Gjatë vitit 2021, janë miratuar 2 manuale të rëndësishme për stafet e kujdesit psikosocial në IEVP, për punën rehabilituese me personat me probleme të abuzimit/varësisë nga substancat narkotike, të rinjtë e grup-moshës 18–21-vjeçare, personat me probleme të shëndetit mendor, vlerësimi i riskut dhe i nevojave.

- Gjatë vitit 2021, mbipopullimi është eliminuar plotësisht dhe mesatarisht popullimi gjatë 2021 ka qenë -590 vende, ose -14%. Eliminimi i mbipopullimit në burgje ka ardhur si rezultat i masave konkrete në investime, si rikonstruksioni i dy godinave në IEVP Lezhë, investim i Qeverisë Shqiptare, ashtu edhe përmes kryerjes rast pas rasti të një studimi të kujdesshëm të shpërndarjes dhe akomodimit të burgosurve në IEVP.

- Është rishikuar dhe miratuar ligji nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet huaja në çështjet penale”, i ndryshuar 97/21, datë 7.7.2021.

Raporti Vjetor i Monitorimit për vitin 2022 ka evidentuar gjetjet e mëposhtme.

I. Lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të parë të politikës “*Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, eficiencën dhe llogaridhënien*”, janë arritur rezultatet e mëposhtme:

- Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka ecur me ritme të rregullta në vitin 2022. KPK-ja arriti të përfundojë vlerësimin e 75% subjekteve që i nënshtrohen *vetingut*, duke përmbushur kështu objektivin e vendosur në pasaportën e treguesve për vitin 2022. Ndryshimet Kushtetuese në lidhje me zgjatjen e mandatit të organeve të rivlerësimit (deri në dhjetor 2024) kanë dhënë garancitë e nevojshme për t’u mundësuar atyre përfundimin e të gjithë procesit në mënyrë efektive dhe në kohë.

- KLGJ-ja, KLP-ja dhe ILD-ja kanë përgatitur analiza në lidhje me kuadrin ligjor të institucioneve të tyre dhe kanë sugjeruar ndryshimet e nevojshme në lidhje me ligjin për statusin, ligjin për qeverisjen, si dhe të ligjeve të tjera përkatëse.

- ILD-ja ka nxjerrë një numër të konsiderueshëm urdhrash dhe aktesh administrative që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e brendshëm të ILD-së për të garantuar cilësinë dhe efikasitetin e veprimtarive të kryera dhe të shërbimeve të ofruara.

- ILD-ja ka kryer 3 inspektime tematike në bazë të Metodologjisë së miratuar. Dy prej tyre kanë përfunduar dhe raportet përkatëse u janë dërguar institucioneve përkatëse për zbatimin e rekomandimeve.

- 23 gjyqtarë dhe 22 prokurorë të rinj janë emëruar nga KLGJ-ja dhe KLP-ja në vitin 2022, pas diplomimit nga SHM-ja.

- KLGJ-ja ka ngritur në detyrë 6 (gjashtë) gjyqtarë në GJL dhe 11 gjyqtarë në gjykatat e Apelit (7 ngritje në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, 1 në Gjykatën Administrative të Apelit, 3 në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar), si edhe 1 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

II. Lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të dytë të politikës “*Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane*”, janë arritur rezultatet e mëposhtme:

- Falë plotësimit të vendeve vakante në GJL gjatë vitit 2022 (është arritur kuota 15 gjyqtarë, nga 19 të parashikuar në ligj) dhe miratimit të disa masave për reduktimin e *backlog*-ut, GJL-ja ka nisur një trend pozitiv të reduktimit gradual të *backlog* dhe të uljes së *disposition time* të çështjeve.

- Gjykata Kushtetuese është funksionale. Në bazë të propozimeve të KED-së, gjatë vitit raportues u plotësuan edhe tre vende vakante të tjera në GJK. Kryetari i GJK është zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve të GJK-së. Miratimi i Kodit të Etikës për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese shënon një tjetër arritje të këtij viti. Infrastruktura dhe logjistika e Gjykatës Kushtetuese lehtësojnë punën e përditshme të gjyqtarëve dhe personelit mbështetës.

- GJK-ja arriti të reduktojë me sukses volumin e çështjeve në pritje, duke arritur dhe tejkaluar objektivin e vitit 2025 në pasaportën e treguesve që në vitin 2022.

- Shkolla e Magjistraturës ofroi formim fillestar në auditorë për 163 kandidatë për magjistratë dhe 4 kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë në vit të parë, të dytë dhe të tretë të Programit të Formimit Fillestar dhe diplomoi 46 kandidatë. Ajo realizoi 81 aktivitete trajnuese me magjistratë të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor dhe nëpunës civilë gjyqësorë, bazuar në një metodologji të riparë, si për vlerësimin e nevojave për trajnim, edhe për cilësinë e trajnimit dhe eficiencën e tij. SHM ka krijuar, gjithashtu, një bazë të dhënash të lektorëve dhe trajnerëve me ekspertizë në të drejtën e BE-së, të cilët janë angazhuar të trajtojnë ligjin e BE në kurrikulën e formimit fillestar dhe vazhdues dhe lidhjen e tij me ligjin shqiptar. Me qëllim adresimin e nevojave të menjëhershme të sistemit të drejtësisë, duke garantuar edhe aksesin në drejtësi për qytetarët, harta e re gjyqësore u miratua me VKM-në nr. 495, datë 21.7.2022, “Mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”. Harta gjyqësore e reformuar përfshin, ndër të tjera, 13 gjykata të shkallës së parë dhe 1 (një) gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe 2 gjykata administrative të shkallës së parë dhe 1 gjykatë administrative apeli, dhe përcakton kompetencat e tyre territoriale përkatëse.

- KLGJ-ja miratoi Planin e Komunikimit për Gjykatat në Nëntor 2022 dhe ka nisur zbatimin e tij.

- ILD-ja ka vendosur një procedurë për komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët e cila tashmë ka rezultate shumë të mira. Nisma siguron qasje të lehtë në drejtësi dhe transparencë.

- Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka arritur rezultate të shkëlqyera në vitin 2022 dhe ka zbatuar të gjitha masat përkatëse të planit të veprimit. Gjithashtu, ka tejkaluar shumë vlerat e synuara në pasaportën e treguesve për ndihmën juridike falas, parësore dhe dytësore. Gjithashtu, janë organizuar me sukses me mbështetjen e programeve të donatorëve, disa trajnime, të listuara në planin e veprimit.

- Është miratuar statuti i ri i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësuesve. Në vitin 2022 janë dhënë 247 licenca. Gjithashtu, 89 kandidatë janë trajnuar për t'u licencuar përmes provimit në MD. 27 ndërmjetës janë trajnuar për trajnim të vazhdueshëm, i cili është i detyrueshëm.

III. Lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të tretë të politikës “*Një sistem i drejtësisë penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit*”, janë arritur rezultatet e mëposhtme:

- Në vitin 2022 janë trajnuar dhe emëruar 21 oficerë të policisë gjyqësore dhe 21 prokurorë në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Gjithashtu, gjatë vitit 2022, kanë marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme, 741 prokurorë dhe 84 oficerë të policisë gjyqësore.

- Në qershor 2022, BKH-ja plotësoi numrin total të hetuesve të parashikuar në organigramë (60 hetues). 60 hetuesit e BKH-së morën pjesë në 36 trajnime. Ata janë angazhuar në hetimet e rreth 300 hetimeve procedurale.

- SPAK-u ka bërë progres drejt funksionalitetit të plotë. Nga 20 pozicione të parashikuara, 17 prokurorë janë ngritur në detyrë si prokurorë në SPAK. Janë organizuar dhe zhvilluar trajnime të posaçme për prokurorët e SPAK-ut.

- Të gjitha masat e parashikuara në OS 3.4 janë zbatuar me sukses nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës.

- Gjatë periudhës janar– dhjetor 2022 janë trajnuar 1774 punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (44% e numrit total).

- Është hartuar raporti analitik për kushtet e punës në burgje/identifikimi i problemeve dhe nevojave për përmirësim dhe hartimi i një plan veprimi masash në zbatim të gjetjeve të raportit analitik. Roli aktiv mbështetës i KE në arritjen e shumicës së rezultateve nga DPB.

IV. Lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të katërt të politikës *“Një sistem i drejtësisë penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit”*, janë arritur rezultatet e mëposhtme:

- Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar udhëzuesin për zhvillimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve si një hap i parë për zhvillimet e ardhshme të sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve gjyqësore.

- Më datë 22.4.2022, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, KLGJ-ja nisi sistemin e ri dhe inovativ *online* (pilotimi), mbi njoftimet elektronike të avokatëve lidhur me proceset gjyqësore, me qëllim përmirësimin e shërbimit të drejtësisë.

- Është ngritur dhe vënë në funksion rrjeti i intranetit WAN ndërmjet KLGJ-së dhe 38 Gjykatave.

- U krijua një infrastrukturë mbështetëse (Server, Storage, firewal etj.) për rrjetin e klasifikuar me qëllim shkëmbimin e materialeve konfidenciale nga anëtarët e KLGJ. U ngrit gjithashtu një infrastrukturë mbështetëse (Server, Storage, firewall etj.) për programin e digjitalizimit të arkivit gjyqësor.

- Ka filluar zbatimi i Regjistrimit Elektronik të OJF-ve. Ai bazohet në udhëzimet e ligjit nr. 80/2021, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” dhe parashikohet të hyjë në funksion në fund të vitit 2023.

- Objektivi i Ministrisë së Drejtësisë, në cilësinë e institucionit drejtues për kriterin politik dhe kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, në kuadër të procesit të negociatave, është përgatitja për zhvillimin e takimeve dypalëshe BE–Shqipëri; përditësimi dhe përmirësimi i dokumenteve të analizës së mangësive ligjore (AML), tabelave të përputhshmërisë (TOC) dhe analizës institucionale dhe administrative (AIA), për kapitullin 23. Konferenca e parë ndërqeveritare ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian u mbajt në Bruksel më 19 korrik 2022. U hartua një plan masash në janar 2022 për të adresuar rekomandimet e raportit të Komisionit për Shqipërinë në 2021 dhe monitorimi i tij vazhdoi gjatë gjithë vitit 2022; vazhdoi procesi i monitorimit të masave ligjore dhe zbatuese të parashikuara në PKIE 2022–2024 për kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”; PKIE 2022–2024 u miratua me VKM-në nr. 91, datë 09.02.2022;

- Takimet shpjeguese për kapitullin 23 dhe funksionimin e institucioneve demokratike u zhvilluan gjatë muajit shtator, si p.sh. takimet dypalëshe BE-Shqipëri për Kapitullin 23 që u mbajtën në datat 24 dhe 25 nëntor 2022.

Raporti Vjetor i Monitorimit për vitin 2023, mbi zbatimin e SND 2021–2025, është raporti vjetor i tretë i monitorimit të zbatimit të SND 2021-2025. Ky raport është hartuar në një kohë që përkon me realizimin e gjysmës së afatit kohor 5 vjeçar, të zbatueshmërisë së SND 2021–2025.

I. Lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit politik për *“Funksionimin e plotë dhe profesional të institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, eficiencën dhe llogaridhënien”*, konstatohet se:

- Vijueshmëria e procesit të verifikimit kalimtar të subjekteve të vlerësimit nga organet ekzistuese të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve po ecën me ritme të mira, si nga ana e KPK-së dhe KPA-së. Referuar treguesve për vitin 2023, ka gjasa që ky proces të finalizohet brenda afatit ligjor nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ndërkohë që, sa i takon Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke marrë në konsideratë numrin e subjekteve që janë për gjykim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, numrin potencial të ankimeve të pritshme për raportet të cilat janë ende në vlerësim në KPK, si dhe numrin mesatar të raporteve përfundimtare të vlerësuara në

një muaj nga ana e KPA-së për vitin 2023, ekziston një risk potencial lidhur me përfundimin e procesit brenda afatit ligjor (qershori i vitit 2026) nga ana e KPA-së. Bazuar në raportimin e KPA-së numri mesatar i çështjeve për 1 muaj është 5 çështje për vitin 2023. Kjo tregon një tendencë që mund të ndikojë afatin ligjor të mandatit të KPA-së.

- Ndërmarrja nga ana e institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (KLGJ, KLP) e masave të cilat sigurojnë vijueshmërinë e standardeve të procesit të verifikimit kalimtar të subjekteve, edhe pas përfundimit të organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, mbetet një sfidë e cila duhet adresuar në të ardhmen. Zhvillimi i kapaciteteve të KLGJ-së dhe KLP-së, procedurat e emërimit, promovimit dhe transferimit të magistratëve duhet të kalojnë nëpërmjet sistemit të kontrolleve të integritetit përpara hyrjes në karrierën e magistraturës si dhe gjatë karrierës, si dhe kontrollit të pasurisë. Standardet e larta të vendosura nga organet e *vetingut* lidhur me kontrollin e pasurisë dhe figurës, duhet tashmë të pranohen dhe zbatohen nga KLGJ-ja dhe nga KLP-ja. Për të ndihmuar këtë proces, duke marrë në konsideratë faktin se organet e *vetingut* janë në fund të mandatit të tyre, do të ishte e rekomandueshme rialokimi i stafit të KPK-së dhe KPA-së, në përputhje me parimin e ruajtjes dhe valorizimit të kapaciteteve me vlerë të veçantë specializimi.

- Po kështu, sa i përket kompletimit të paketës nënligjore, bazuar në komponentin e lidhur me KLP, edhe pse kemi një numër aktesh nënligjore të miratuara në fund të vitit 2023, ka ende boshllëk nënligjor. Për sa më sipër, kërkohet një planifikim më i mirë i procesit të draftimit dhe miratimit të akteve, në mënyrë që ky proces të marrë kohën e nevojshme dhe të mundësojë miratimin e akteve nënligjore me cilësi dhe në kohën e duhur. Cilësia e akteve nënligjore, e të gjitha organeve të drejtësisë, përfshirë këtu edhe gjykatat dhe institucionet e varësisë, mbetet një sfidë e së ardhmes e cila ndikon drejtpërsëdrejti në mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë dhe është një parakusht për funksionimin me eficiencë të këtyre institucioneve.

- Përfundimi i procesit të trajtimit të ankesave të mbartura nga institucionet e mëparshme (*backlog*), nga ana e ILD-së evidentohet si një arritje e konsiderueshme përgjatë vitit 2023, e lidhur me arritjen e objektivave të Qëllimit I të Politikës.

- Vakancat në numrin e inspektorëve magistratë dhe jo-magjistratë në ILD mund të ndikojnë në numrin e inspektimeve të planifikuara dhe tematike, gjë që kërkon adresimin sa më të shpejt të kësaj çështjeje dhe plotësimin e vakancave të inspektorëve magistratë dhe jomagjistratë, por veçanërisht plotësimin e pozicioneve të inspektorëve magistratë në ILD. Për këtë problematikë, duhen marrë në konsideratë disa aspekte me qëllim rekrutimin jo vetëm të kandidatëve magistratë të cilët përmbushin kriteret ligjore, por gjithashtu sigurimin e një procesi rekrutimi që mundëson transferimin e magistratëve me përvojë të cilët zotërojnë kapacitetin e duhur profesional dhe integritet të lartë për të hetuar organet gjyqësore dhe magistratët në detyrë. Sigurisht, do të nevojiteshin edhe ndryshime ligjore për të garantuar këtë rezultat, pra ngritjen dhe forcimin e imazhit të inspektorëve të ILD-së si një model për të gjithë magistratët dhe për të garantuar respektimin dhe vlerësimin e tyre nga kolegët e gjyqësorit.

- Po kaq e rëndësishme është, brenda vitit 2024 dhe 2025, në bashkëpunim me partnerët dhe me institucionet e tjera, marrja e masave nga ana e ILD-së lidhur me forcimin e kapaciteteve të inspektimit; promovimin e imazhit publik të inspektorëve; hapjen e thirrjeve me qëllim tërheqjen e inspektorëve të profilit të lartë dhe; rekrutimin e inspektorëve me inspektorë të profilit të lartë.

II. Lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit politik "*Forcimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi, në përputhje me standardet kushtetuese, ligjore dhe evropiane*", konstatohet se:

- Ka arritje në drejtëm të plotësimin të vakancave dhe forcimit të kapaciteteve infrastrukturore në Gjykatën Kushtetuese, gjë e cila konsiderohet një premisë për funksionimin e plotë të kësaj Gjykate.

- Gjithashtu, po vijon implementimi me sukses i hartës së re gjyqësore, me ngritjen e 13 gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Megjithatë, infrastruktura në zbatim të hartës së re gjyqësore nuk është e siguruar, pasi ka probleme me miratimin e shesheve

të ndërtimit nga ana e bashkive për godinat e reja të gjykatave. Mungesa e një studimi të mirëfilltë fizibiliteti mbetet një shqetësim potencial në sigurimin e infrastrukturës ndërtimore.

- Plotësimi i vakancave të magistratëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë të juridiksionit të përgjithshëm, mbetet një problematikë e cila vjen më së shumti si pasojë e procesit të *vetingut*. Në adresimin dhe plotësimin e vakancave është e rëndësishme që KLGJ të marrë në konsideratë masa për të mundësuar emërimet, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të magistratëve, bazuar në vlerësime etike dhe profesionale të rregullta dhe në kohë. Momentalisht, vakancat në Gjykatën e Apelit për gjyqtarë dhe staf administrativ janë problematika më e madhe pasi ambientet për Gjykatën e Apelit nuk janë konceptuar për këtë numër gjyqtarësh dhe anëtarësh stafi.

- Zhvillimi i standardeve të plota dhe të gjithanshme lidhur me treguesit e performancës së gjykatave përbën një risk për monitorimin e performancës së gjykatave, sipas standardeve më të mira. Pjesë e procesit të zhvillimit të standardeve duhet të konsiderohet ngritja e mekanizmave monitorues të zbatimit të tyre.

- Fillimi i punës për hartimin e një strategjie të mirëfilltë dhe një plan veprimi me masa konkrete, për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, mund të konsiderohet si një hap pozitiv për krijimin e hapësirave për uljen e *backlog*-ut dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjeve gjyqësore.

- Evidentohet një përpjekje e mirë në plotësimin e kuadrit nënligjor për funksionimin e gjykatave por nevojitet një mbështetje më e madhe për zbatimin e këtyre akteve si dhe për vlerësimin e efikasitetit për zbatimin e legjislacionit dytësor.

- Referuar raportimeve nga institucionet, konstatohen arritje në drejtim të metodologjisë së trajnimeve të magistratëve në mënyrë që ato të jenë sa më të dobishme për përfituesit e tyre dhe të rrisin cilësinë e gjyqësorit, po ashtu edhe për procesin e trajnimit të magistratëve dhe të subjekteve të tjera. Në përputhje dhe me rekomandimet e *Screening Report* të BE-së, në emërimin e profileve profesionale të Shkollës së Magistraturës duhet marrë parasysh plotësimi i kriterëve profesionalë dhe etikë në mënyrë që të shmanget përfshirja e magistratëve të shkarkuar nga procesi i *vetingut*. Krijimi i modeleve pozitive në përgatitjen e magistratëve të rinj është një nga synimet më të rëndësishme të agjendës së ardhshme.

- Sa i takon arritjes së objektivit “Informimi dhe rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve të ligjit, ‘Për ndihmën juridike falas’ për të drejtat e tyre për ndihmë dhe akses në institucione”, konstatohet progres i dukshëm nëpërmjet organizimit të fushatave ndërgjegjësuëse, materialeve promovuese, ndërtimit dhe përmirësimit të website informativ dhe i aksesueshëm për të gjitha grupet vulnerabël.

- Në drejtim të zbatimit të sistemeve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mbetet sfida puna në drejtim të rritjes së kapaciteteve të DHKN-së, rritjes së numrit të rasteve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rrugë alternative, gjetjen e mekanizmave për ta bërë ndërmjetësimin më të aksesueshëm, si dhe kërkimi dhe aplikimi i praktikave më të mira evropiane.

III. Lidhur me përmbushjen e objektivave të Qëllimit Politik “Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit”, konstatohet se:

- Me gjithë hapat e bëra deri tashmë, procesi i hartimit dhe miratimit të ndryshimeve të reja të Kodit Penal, në përputhje me *acquis* dhe rekomandimet e *Screening Report*, në fushën penale dhe kriminalitetin, ende mbetet i pafinalizuar. Duhet theksuar se hartimi i Kodit të ri Penal në përputhje me *acquis* e BE-së është sfidues dhe kërkon kohën, burime dhe profesionalizmin e duhur. Kështu cilësia e Kodit të ri Penal duhet konsideruar si prioritet.

- Lidhur me strukturat e SPAK-ut, duhet të vijojë plotësimi i vakancave në pozicionet e oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Nga ana e institucionit janë paraqitur synime për struktura më eficiente, të kompletuara me njësi të analizës së riskut, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe operacionale, si dhe rekrutimi i kapacitetet njerëzore cilësore.

- Institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, pavarësisht hapave pozitivë në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, ndeshen ende me disa nevoja, si p.sh., Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, paraqet nevoja lidhur me zgjerimin e hapësirave dhe përmirësimin e standardeve të godinave të degëve lokale, gjë e cila do të sigurojë përmirësimin e shërbimit që ofron kjo drejtori.

- Mbetet sfida bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e drejtësisë penale, veçanërisht bashkëpunimi midis prokurorive dhe shërbimit të provës, për të mundësuar respektimin e afateve ligjore për ekzekutimin e vendimeve me shërbim prove. Vonesa në ekzekutimin e shërbimit të provës ndikon në zbatimin e duhur të shërbimit të provës si dënim alternativ, efektin individual të këtij ndëshkimi si dhe cenon besimin në sistemin e drejtësisë.

IV. Lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit politik *“Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektivi i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucionet e sektorit”*, konstatohet se:

- Miratimi dhe implementimi me një sërë aktivitetesh i Strategjisë dhe planit të komunikimit në fushën e drejtësisë është një arritje e regjistruar përgjatë vitit 2023 nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

- Në vijim të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për herë të parë, Qeveria Shqiptare me vendimin nr. 729, datë 13.12.2023, miratoi Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024– 2030, të propozuar nga Ministria e Drejtësisë, në përputhje me prioritetet dhe programin e Qeverisë Shqiptare, duke siguruar një kuadër të plotë për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit.

- Ndërkohë, digjitalizimi i sistemit të drejtësisë dhe vënia në funksion e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve paraqet vështirësi dhe sfida, të cilat duhen adresuar. Vonesat në ndërtimin e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve paraqesin një risk të konsiderueshëm, në vënien në funksion të këtij sistemi. Zbatimi i udhërrëfyesit ndërinstitucional për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë dhe në këtë kuadër ndërlidhja e sistemeve të menaxhimit të çështjeve të çdo institucioni në një sistem të integruar të menaxhimit të çështjeve, duke marrë në konsideratë hapat e ngadaltë deri më tani, mbart në vetvete, gjithashtu, një risk të konsiderueshëm dhe kërkon përpjekje maksimale për vënien në jetë.

- Digjitalizimi i sistemit të drejtësisë dhe vënia në funksion e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve, synohet të arrihet nëpërmjet: plotësimit të vakancave, rritjes së kapaciteteve, ndryshimeve ligjore, bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve, si dhe sigurimit të buxheteve të nevojshme, për vënien në funksion të sistemit.

- Rritja në tërësi e bashkëpunimit ndërinstitucional, për zbatimin e politikave dhe reformave, gjithsesi, mbetet sfida e agjendës së ardhshme.

Në kuadrin e vlerësimit afatmesëm të SND 2021– 2025, raporti i fundit i monitorimit evidentoi, nga ana e përmbajtjes, nevojën e përditësimit të Strategjisë për të reflektuar qëllime të politikës lidhur më ngushtë me arritjet e nevojshme për të garantuar integritetin në BE. Sa u përket aspekteve procedurale dhe të menaxhimit të monitorimit të Strategjisë dhe raportimit u evidentua nevoja për ngritjen dhe përdorimin e një Mekanizmi të Paralajmërimit të Hershëm, i cili ka për qëllim të sigurojë që vlerësimi mbi ecurinë e Strategjisë të kryhet në çdo fazë të zbatimit të saj, dhe problematikat e mundshme të adresohen dhe zgjidhen në kohën e duhur dhe efektivisht. Një mekanizëm i tillë është një risi e përfshirë në monitorimin dhe raportimin e SND 2024– 2030.

Me gjithë arritjet e shënuara, duhet theksuar se konsolidimi i arritjeve të Reformës në Drejtësi përgjatë viteve 2024– 2030 bën të nevojshme politika që përmirësojnë kuadrin ligjor në fuqi lidhur me sistemin e drejtësisë, për një drejtësi efikase mbështetur në parime të konsoliduara nga Reformën në Drejtësi, si parimet e pavarësisë, paanësisë, profesionalizmit, integritetit në sistemin gjyqësor e në prokurori. Politikat e reja synojnë të reformojnë sistemin e drejtësisë, forcojnë kapacitetet e institucioneve të drejtësisë, harmonizojnë legjislacionin në fushën e sistemit të drejtësisë, në përputhje me *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane, rritjen e komunikimit publik dhe rikthimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Dokumenti ndërsektorial i drejtësisë, synon të sjellë reforma rrënjësore në drejtësi që forcojnë parimet e pavarësisë dhe integritetit të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe fuqizojnë

rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke vendosur standarde kontrolli të figurës dhe të pasurisë ndaj anëtarëve jomagjistratë në përbërjen e Këshillave deri më sot dhe transparencë të plotë. Përgjatë viteve 2024–2030, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në funksion të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, duhet të miratojë aktet nënligjore sipas ligjit duke siguruar standardet e cilësisë. Kjo strategji synon gjithashtu zbatimin me efektivitet të rregulloreve mbi organizimin e gjykatave dhe prokurorive nga institucionet përkatëse (KLGJ, KLP, PP) lidhur me zbatimin e hartës së re gjyqësore.

Procesi i *vetingut*, nën mbikëqyrjen e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ka shënuar progres por nevojitet që procesi i rivlerësimit të përfundojë brenda afateve kushtetuese ligjore. Standardet e kontrollit të figurës dhe kontrollit të pasurisë duhet të aplikohen te magjistratët gjatë gjithë vazhdimësisë së karrierës të statusit të magjistratit. Procesi i rivlerësimit, si dhe kontrolli i integritetit duhet të zbatohet përpara dhe gjatë gjithë karrierës së statusit të magjistratit. Garantimi i standardeve të kontrollit të pasurisë passjell nevojën lidhur me përditësimin dhe verifikimin periodik të deklaratave të pasurisë të anëtarëve magjistratë gjyqësorë dhe prokurorë. KLGJ-ja dhe KLP, duhet të sigurojnë ndjekjen sistematike të raporteve të deklarimit të pasurisë nga ILDKPKI-ja dhe të ndër marrin hetime të mëtejshme në kontekstin e shqyrtimit të pasurisë dhe të figurës së magjistratëve. Synohet që gjatë viteve 2024–2030, të plotësohen vakancat për inspektorët e ILDS-së me profil magjistrat. Rritja e efikasitetit është kushti themelor për vlerësimin dhe promovimin e magjistratëve. Angazhime të tjera në nivel strategjik janë marrja e masave parandaluese për çdo ndërhyrje abuzuese, të brendshme apo të jashtme, që u bëhet gjyqësorëve, prokurorëve dhe stafit të gjykatave.

Më tej, kjo strategji synon të adresojë politika në kuadër të përmirësimit të performancës së magjistratëve, duke iu referuar përmirësimeve lidhur me trajnimin fillestar dhe vazhdues të magjistratëve, si dhe duke iu referuar forcimit të nevojshëm të kapaciteteve të cilësisë, efikasitetit, integritetit të stafit pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, duke parandaluar praktikat e dëmshme lidhur me përfshirjen në të ardhmen të magjistratëve të shkarkuar nga *veting*-u. Masat e nevojshme për ndryshime ligjore duhet të forcojnë kapacitetet e Shkollës së Magjistraturës, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në mënyrë që të garantohen standardet e vlerësimit lidhur me kontrollin e pasurisë dhe të figurës së kandidatëve jomagjistratë,

Forcimi i parimeve të disponueshmërisë/aksesueshmërisë të vendimeve gjyqësore, veçanërisht të Gjykatës së Lartë, si dhe unifikimi i vendimeve të gjykatave nga Gjykata e Lartë, përbëjnë gjithashtu një element të rëndësishëm të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030.

Synimi i kësaj strategjie është të sigurojë një drejtësi thelbësisht efikase nëpërmjet rritjes së cilësisë së arsytimit të vendimeve gjyqësore, me rritjen e eficiencës dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara në gjykata dhe në prokurori. Sfidë por dhe perspektivë premtuese mbetet trendi lidhur me uljen dhe eliminimin e *backlog*-ut në gjykata, ngritja dhe funksionimi i plotë i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve (ICMS), përdorimi me efikasitet të plotë i këtij sistemi të unifikuar në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë, si dhe përmirësimi i infrastrukturës në gjykata, me qëllim forcimin e parimit të aksesit në drejtësi nga publiku i gjerë. Për këtë qëllim, sigurimi i burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare, ndikon ndjeshëm lidhur me përmbushjen në mënyrë efektive të detyrave funksionale të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit.

Jetësimi i prioriteteve strategjike të reformës në drejtësi, passjell nevojën lidhur me fuqizimin e kapaciteteve të strukturave të posaçme, si Prokuroria e Posaçme, Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Gjykatat Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Objektivat e Reformës në Drejtësi garantojnë rritjen e efikasitetit në sistemin gjyqësor dhe në prokurori, por gjithmonë duke u orientuar nga nismat ligjore në këtë drejtim. Aksesit në drejtësi, duhet të jetë i hapur për publikun e gjerë, duhet të jetë i mirorganizuar në gjykata dhe në prokurori, duke siguruar që transferimi apo ngritja në detyrë e magjistratëve të jenë funksionale në kuadër të marrjes së masave implementuese dhe vlerësuese në mënyrë periodike të hartës së re gjyqësore. Rezultatet e Reformës në Drejtësi duhet të jenë të prekshme, pasi ato synojnë trendin për uljen e ngarkesës së punës dhe forcimin e kapaciteteve të ndihmësve ligjorë, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane.

Në vijimësi të arritjeve të rezultateve të prekshme, kjo strategji synon të përmirësojë mekanizmin referues për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, të forcojë rolin e ndërmjetësimit dhe rolin e gjykatave në këtë fushë, të rrisë ndërgjegjësimin dhe numrin e rasteve të shërbimeve të ndërmjetësimit nga publiku i gjerë. Gjithashtu, për sektorin e drejtësisë, mbetet sfida ulja e mbipopullimit në burgje. Ndërsa lidhur me fushën penale dhe të kriminalitetit mbetet e domosdoshme miratimi i një Kodi të Ri Penal, në përputhje me *acquis* e BE-së duke u bazuar në rekomandimet e *Screening Report*.

Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional i drejtësisë mbetet një nga prioritetet kyçe të sistemit të drejtësisë. Ndaj edhe në kuadër të bashkëpunimit, vlerësohet si e nevojshme ndërmarrja e masave përmirësuese lidhur me komunikimin publik për Reformën në Drejtësi, si dhe masave që ndikojnë në rritjen e ndërgjegjësimin të edukimit ligjor të publikut dhe zbatimin me efikasitet të strategjive dhe planeve të komunikimit. Zbatimi në kohë dhe në mënyrë efektive i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke përfshirë edhe vendimet e GJEDNJ-në, është një nga prioritetet thelbësore për sektorin e drejtësisë, me qëllim respektimin e Konventës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe protokolleve të saj shtesë.

Situata aktuale dhe vlerësimi mbi Edukimin Ligjor të Publikut në Shqipëri

Edukimi ligjor i publikut në Shqipëri ka fituar një rëndësi të jashtëzakonshme në vitet e fundit, duke u bërë një komponent thelbësor në forcimin e shtetit të së drejtës dhe në krijimin e një shoqërie të drejtë dhe të informuar. Ky proces përfshin përhapjen e njohurive ligjore te qytetarët, duke siguruar që ata të jenë të informuar mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe mbi funksionimin e institucioneve të drejtësisë. Në një vend si Shqipëria, ku historia e sistemit ligjor ka qenë shpeshherë e ndërlikuar dhe e ndikuar nga faktorë të ndryshëm sociopolitikë, edukimi ligjor i publikut është bërë një domosdoshmëri. Ai nuk është vetëm një mjet për të informuar qytetarët për ligjet ekzistuese, por edhe një mënyrë për të krijuar një kulturë ligjore të fortë dhe të qëndrueshme.

Një shoqëri e informuar ligjërish është një shtyllë e rëndësishme për një shtet të fortë të së drejtës. Edukimi ligjor ndihmon në krijimin e një kulture ligjore ku ligjet respektohen dhe zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë. Kjo kontribuon në ndërtimin e institucioneve të drejtësisë të besueshme dhe të qëndrueshme. Në të njëjtën kohë, edukimi ligjor i publikut ndihmon në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike. Kur qytetarët janë të informuar mbi të drejtat e tyre dhe mbi mënyrën se si funksionojnë institucionet e drejtësisë, ata janë më të aftë për të kërkuar llogari nga këto institucione. Kjo ndihmon në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimit me pushtetin.

Në Shqipëri, edukimi ligjor i publikut fitoi një rëndësi të veçantë, veçanërisht pas analizës së kryer në vitin 2015 nga grupi i ekspertëve të Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. Kjo analizë nxori në pah një sërë problemesh dhe nevojën urgjente për projekte të mirëkoordinuara, plane dhe strategji që mund të përmirësojnë edukimin ligjor të qytetarëve. Edukimi ligjor është një element thelbësor për forcimin e shtetit të së drejtës dhe për fuqizimin e qytetarëve në njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Analiza e kryer në këtë periudhë evidentoi se edukimi ligjor në Shqipëri përballëj me sfida të theksuara. *Së pari*, mungesa e koordinimit dhe institucionalizimit ka qenë një pengesë e madhe. Edukimi ligjor i publikut është realizuar kryesisht nga organizata jofitimprurëse dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, por pa një qasje të mirëkoordinuar dhe të institucionalizuar. *Një tjetër problem* ka qenë korniza ligjore e paqartë. Ligjet ekzistuese shpesh përmendnin institucionet përgjegjëse për edukimin ligjor, por nuk specifikojnë detyrime të qarta për to. Kjo mungesë qartësie ligjore ka rezultuar në përgjegjësi të papërcaktuara qartë dhe pa mekanizma të qartë zbatimi. *Përveç kësaj*, mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore ka qenë një sfida tjetër e rëndësishme. Institucionet përballen me mungesa të theksuara të burimeve të nevojshme për të realizuar aktivitetet e edukimit ligjor. Kjo ndikon në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e programeve të edukimit ligjor, duke i bërë ato të paqëndrueshme dhe të varura nga financime të përkohshme.

Me qëllim minimizimin e këtyre sfidave u hartua Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP), miratuar me vendimin e Kuvendit numër 47/2019, “Për miratimin strategjisë për edukimin ligjor të publikut, 2019–2023”. Ky dokument strategjik shërbeu si kuadri i parë rregullues kushtuar në mënyrë specifike Edukimit Ligjor të Publikut (ELP). Strategjia synonte të siguronte një qasje gjithëpërfshirëse dhe të mirëkoordinuar për edukimin ligjor në vend duke promovuar aktivizimin qytetar dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

Strategjia Kombëtare ELP 2019–2023 bazohej në katër shtylla kryesore:

- *Përmirësimi i organizimit dhe funksionimit institucional në ofrimin e ELP-së;*
- *Garantimi dhe forcimi i bashkëpunimit efektiv ndërinstitucional në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për realizimin e ELP-së;*
- *Sigurimi i performancës efektive dhe eficiente të institucioneve publike dhe të pavarura, medias dhe shoqërisë civile;*
- *Ndërojtësimi i publikut për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës.*

Nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë, më 2020-n u hartua edhe plani i veprimit të ELP-së, i cili parashikonte masa dhe aktivitete për institucionet publike dhe jopublike për periudhën 2020–2023, me qëllim rritjen e nivelit të informimit të publikut mbi të drejtat e tyre, kuadrin ligjor në fuqi dhe mjetet që individët kanë në dorë për të aksesuar sistemin e drejtësisë dhe rivendosur në vend të drejtat e tyre të cenuara.

Strategjia i ngarkoi Kuvendit detyrën për ngritjen e Rrjetit Kombëtar të ELP-së me përbërjen e përfaqësuesve të institucioneve kryesore kushtetuese ose të krijuara me ligj (si Presidenti, Kuvendi, Kryeministria, Avokati i Popullit, Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale etj.), përfaqësuesve të ministrive, institucioneve të drejtësisë, AMA-s, të Radiotelevizionit Shqiptar, dhomave të profesioneve të lira, si: noterë, avokatë, ndërmjetës dhe përmbaues gjyqësorë privatë, përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, shoqatat e Bashkive, Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile, Organizatat e Shoqërisë Civile që punojnë për edukimin ligjor të publikut, organizata ndërkombëtare dhe fakultete të drejtësisë. Për koordinimin e rrjetit u ngritën nga Kuvendi i RSH-së organet e rrjetit: Komisioni Drejtues i Edukimit Ligjor të Publikut (KDELP) dhe Bordi Këshillimor (BK).

Paralelisht me SELP, masa lidhur me edukimin ligjor të publikut kanë qenë të përfshira edhe në dokumente të tjera strategjike si Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë (I dhe II) apo Strategjia për Drejtësinë për të Mitur (I dhe II).

Pas miratimit të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” sistemi i informimit ligjor të publikut synohej të mbulohej edhe përmes Qendrave të Ndihmës Juridike Falas dhe klinikave të ligjit. Megjithatë, vonesat lidhur me ngritjen e këtyre qendrave dhe kufizimet buxhetore patën ndikim edhe në realizimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit mbi Edukimin Ligjor të Publikut. Gradualisht, me ngritjen e qendrave të reja të ndihmës juridike, Drejtoria e Ndihmës Juridike luan një rol thelbësor lidhur me informimin dhe edukimin ligjor të publikut. Krahas saj, institucionet e sistemit të drejtësisë, gjykatat, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Drejtësisë kanë hartuar në periudha 2-vjeçare Strategjitë dhe Planet e Komunikimit, të cilat vendosin bazat kryesore të nismave të ndërmarra nga këto institucione lidhur me edukimin ligjor të publikut mbi sistemin e drejtësisë.

Megjithatë, analiza lidhur me zbatimin e SELP-së tregoi se në më shumë se 40% të masave të Planit të Veprimit të kësaj strategjie nuk ishin zbatuar në përfundim të periudhës së mbuluar nga ky dokument strategjik. Arsyet lidheshin kryesisht me mungesën e koordinimit midis institucioneve kryesore përgjegjëse dhe Kuvendit lidhur me zbatimin e masave respektive, mungesën e burimeve financiare të nevojshme për realizimin e aktiviteteve lidhur me edukimin ligjor të publikut apo kufizimet lidhur me burimet njerëzore të cilat pamundësonin zbatimin në të njëjtën kohë edhe të detyrave funksionale, edhe të aktiviteteve të edukimit ligjor të publikut.

Me qëllim krijimin e një rrjeti më të koordinuar të informimit ligjor të publikut dhe adresimit të sfidave me të cilat është përballur edukimi ligjor i publikut gjatë zbatimit të SELP 2019–2023, edukimi ligjor i publikut është parashikuar si një qëllim politik i rëndësishëm në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030. Qëllimi 5 i kësaj Strategjie thekson rëndësinë e edukimit ligjor të publikut si një mjet për të përmirësuar qasjen në drejtësi, për të fuqizuar qytetarët dhe për të forcuar shtetin e së drejtës. Ky qëllim synon të sigurojë që edukimi ligjor të jetë një prioritet në politikat publike dhe të mbështetet nga të gjitha institucionet përkatëse. Strategjia parashikon si autoritetet kryesore përgjegjëse të ngarkuara me informimin dhe edukimin ligjor të publikut të gjitha institucionet që janë pjesë e Sistemit të Drejtësisë në vend. Për secilin prej tyre, Plani i Veprimit detajon masa dhe aktivitete për të gjithë periudhën e shtrirjes së SND III nga 2024–2030 duke u fokusuar kryesisht në planifikimin e masave dhe aktiviteteve me synim garantimin e:

- a) informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të publikut mbi sistemin e drejtësisë përmes përdorimit të mjeteve dhe metodave inovative të komunikimit;
- b) forcimit të bashkëpunimit efektiv të institucioneve të sistemit të drejtësisë për realizimin e ELP dhe rritjen e aksesit të qytetarëve në informacionin mbi kuadrin ligjor dhe sistemin e drejtësisë;
- c) rritjen e njohurive dhe kuptueshmërisë së publikut mbi proceset e integritit evropian përmes iniciativave të edukimit ligjor të publikut.

4. Vizioni dhe misioni i dokumentit

VIZIONI	MISIONI
“Shqipëria konsolidon arritjet e Reformës në sistemin e drejtësisë në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, me synimin për të rritur më tej efikasitetin e drejtësisë në përputhje me standardet evropiane”.	“Avancimi strategjik i reformave në sistemin e drejtësisë, të ndërtuara mbi bazat e pavarësisë dhe paanshmërisë, që thekson rëndësinë e transparencës, përgjegjësisë dhe siguron akses universal, në përputhje me standardet më të mira evropiane”.

PJESA II

QËLLIMI I POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË, MASAT DHE REZULTATET E PRITSHME TË SND 2024–2030

Qëllimet e politikës së SND 2024–2030
SND 2024–2030 përmban 5 (pesë) qëllime kryesore:

- Qëllimi i parë** —————> Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e arritjeve të reformës në drejtësi në përputhje me standardet evropiane
- Qëllimi i dytë** —————> Forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë

Qëllimi i tretë —————> Rritja e efikasitetit të institucioneve në sistemin e drejtësisë

Qëllimi i katërt —————> Forcimi i cilësisë së drejtësisë

Qëllimi i pestë —————> Drejtësi më e afërt me qytetarët

Qëllimi politik 1: Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e arritjeve të reformës në drejtësi në përputhje me standardet evropiane

Shqipëria ka zbatuar një reformë thelbësore në drejtësi që nga viti 2016 me qëllim ristrukturimin e të gjithë sistemit të drejtësisë. Reforma e vazhdueshme në drejtësi është bazuar së pari, në ristrukturimi institucional të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë, duke përfshirë edhe reformën e Gjykatës Kushtetuese dhe ngritjen e institucioneve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, bazuar kjo në një reformë tërësore të kuadrit ligjor dhe rregullativ.

Vijueshmëria e procesit të verifikimit kalimtar të subjekteve të vlerësimit (*vetting*) nga organet ekzistuese të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve po ecën me ritme të mira, si nga ana e KPK-së dhe KPA-së, si dhe nga IKP-ja. Megjithatë, gjatë këtyre viteve të zbatimit të Reformës, janë hasur edhe sfida, të cilat Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030 synon t'i adresojë nëpërmjet masave dhe nismave konkrete të përfshira në qëllimin e parë të saj.

Konkretisht, nëpërmjet këtij qëllimi politik, institucionet do të angazhohen të çojnë përpara arritjet e Reformës, në drejtëm të konsolidimit dhe kompletimit të kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe në përafrimin e plotë të direktivave dhe standardeve të BE-së. Në këtë kuadër nëpërmjet objektivave të parashikuara në këtë qëllim synohet që, nëpërmjet analizave të thelluara, të përmirësohet kuadri strategjik dhe rregullativ, duke përfshirë një sërë ligjesh, përfshirë Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin Civil, Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Familjes, si dhe ligje të tjera të evidentuara si të nevojshme për konsolidimin, pavarësinë, integritetin dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë. Ky qëllim synon që gjetjet dhe rekomandimet e evidentuara nga institucionet në analizat e tyre të brendshme, si dhe të evidentuara nga ekspertët vendës dhe ndërkombëtarë mbi ecurinë e Reformës, të pasqyrohen në një legjislacion të konsoliduar, në përputhje me *acquis* të BE-së, si dhe në praktika institucionale, sipas standardeve më të mira.

Në të njëjtën kohë, ruajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapacitetit profesional, pavarësisë dhe efikasitetit të institucioneve të qeverisjes së drejtësisë është një tjetër element thelbësor për të konsoliduar dhe vijuar arritjet e Reformës.

Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimi i komunikimit publik janë, gjithashtu, thelbësore për arritjen e këtij qëllimi. Në këtë kuadër, nëpërmjet masave konkrete do të sigurohet që bashkëpunimi efektiv ndërmjet institucioneve përgjegjëse të garantojë që Reforma të zbatohet në mënyrë koherente dhe të harmonizuar në të gjitha nivelet e qeverisjes së drejtësisë. Nga ana tjetër, përmirësimi i komunikimit publik rrit transparencën dhe besimin e publikut në Reformën në Drejtësi, duke krijuar një lidhje të fortë midis institucioneve dhe qytetarëve.

Për arritjen e këtij qëllimi politik, institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me institucionet partnerë vendës dhe ndërkombëtarë do të fokusohen në përmbushjen e 4 objektivave specifikë duke garantuar jo vetëm konsolidimin dhe qëndrueshmërisë së reformës në drejtësi, por edhe duke siguruar që legjislacioni vendës të jetë në përputhje me standardet evropiane, që proceset dhe institucionet të jenë të qëndrueshme, efikase dhe të mbrojtura nga çdo ndërhyrje, duke garantuar një sistem drejtësie të besueshëm dhe të respektuar.

Objektivi specifik 1.1: Përditësimi i legjislacionit të Reformës në Drejtësi në përputhje me parimet e pavarësisë, llogaridhënies, efikasitetit, cilësisë dhe sigurimi i harmonizimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së;

Objektivi specifik 1.2: Përfundimi i procesit të rivlerësimit kalimtar (*vetingu*) brenda afateve kushtetuese dhe vendosja e mekanizmave për të siguruar qëndrueshmërinë e këtij procesi;

Objektivi specifik 1.3: Ruajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapacitetit profesional, pavarësisë dhe efikasitetit të organeve të qeverisjes së drejtësisë;

Objektivi specifik 1.4: Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimi thelbësor i komunikimit publik.

Lidhja midis qëllimit politik 1 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi politik 1 lidhet me Objektivin 16 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ, “Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”. SND 2024–2030, lidhet me nënobjektivin 16.3, “Promovimi i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë”. Gjithashtu, SND 2024–2030, lidhet me nënobjektivin 16.6, “Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet”, me nënobjektivin 16.7, “Sigurimi i vendimmarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet” si dhe me nënobjektivin 16.10, “Sigurimi i aksesit të publikut në informacion dhe mbrojtja e lirisë themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare”.

Objektivi specifik 1.1: Përditësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi në përputhje me parimet e pavarësisë, llogaridhënies, efikasitetit, cilësisë dhe sigurimi i harmonizimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së;

Zbatimi i Reformës në Drejtësi, përpjekja për adoptimin e mekanizmave dhe standardeve më të mira për të garantuar funksionimin e plotë të institucioneve të krijuara nga Reforma kanë evidentuar nevojën për përmirësimin e legjislacionit dhe për përafrimin me *acquis* të BE-së, në përputhje me agjendën e integritetit në BE.

Përditësimi Kodeve me qëllim përafrimin me *acquis* të BE-së është një hap konkret që adreson nevojën për një sistem drejtësie në përputhje me standardet ndërkombëtare. Këto ndryshime ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të sistemit të drejtësisë, duke ofruar mbrojtje të plotë të të drejtave të individëve gjatë procesit gjyqësor. Një sistem që përmbush këto standarde është thelbësor për ndërtimin e besimit në drejtësi dhe për ruajtjen e integritetit të procesit gjyqësor.

Kontrollet e rregullta të përshtatshmërisë ligjore janë të domosdoshme për të siguruar që ndryshimet ligjore dhe praktikatat e zbatimit të qëndrojnë në përputhje me *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane. Ky proces përforcon parimet e reformës në drejtësi dhe siguron që legjislacioni të mbetet i përditësuar dhe efektiv në përmbushjen e kërkesave të standardeve ndërkombëtare.

Avancimi i reformës përfshirë ndryshimet ligjore dhe forcimi i kontrollit të pasurive dhe figurës është një tjetër aspekt i rëndësishëm për të ruajtur besimin e publikut dhe për të forcuar integritetin e sistemit të drejtësisë. Këto masa ndihmojnë në sigurinë që individët që mbajnë pozita të rëndësishme të jenë të pastër nga korrupsioni dhe të përgjegjshëm për veprimet e tyre, duke kontribuar në ndërtimin e një sistemi të drejtësisë të besueshëm dhe të drejtë. Po ashtu, parashikimi i masave mbi rritjen e mëtejshme të kapaciteteve të organeve të specializuara për korrupsionin dhe krimin e organizuar përmirëson efikasitetin dhe cilësinë e hetimit nga ana e këtyre organeve.

Marrja e masave për mospërfshirjen e ish-magjistratëve të shkarkuar/dorëhequr, dhe forcimi i kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës janë masa që ndihmojnë në ruajtjen e integritetit të institucioneve të drejtësisë dhe në përmirësimin e përgatitjes dhe trajnimit të magjistratëve të ardhshëm. Këto masa kontribuojnë në krijimin e një sistemi drejtësie që është në përputhje me standardet më të larta evropiane dhe që është i gatshëm për të trajtuar me efikasitet dhe integritet sfidat e tij.

Të gjitha këto masa janë të ndërlidhura dhe përbëjnë një strategji të integruar që siguron përmbushjen e objektivit specifik për përditësimin e legjislacionit të Reformës në Drejtësi dhe për krijimin e një sistemi drejtësie të qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet evropiane.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030, janë ndryshuar 6 ligjet e reformës në drejtësi, duke reflektuar elementet e analizës së institucioneve mbi problematikat e zbatimit të tyre;
- Deri në fund të vitit 2030, ligji vendës është përafuar, të paktën “pjesërisht”, me 40 akte ligjore të BE-së.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objektivi specifik 1.1 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së, “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 1.1 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat

1.1.1 Koordinimi i zhvillimit dhe zbatimit të politikave shtetërore, në lidhje me rritjen e pavarësisë, përgjegjshmërisë, cilësisë dhe efikasitetin e drejtësisë;

1.1.2 Përditësimi i Kodit Penal në përputhje me *acquis* të BE-së;

1.1.3 Përditësimi i Kodit të Procedurës Penale në përputhje me *acquis* të BE-së;

1.1.4 Përditësimi i Kodit Civil në përputhje me *acquis* të BE-së;

1.1.5 Përditësimi i Kodit të Procedurës Civile në përputhje me *acquis* të BE-së;

1.1.6 Përditësimi i Kodit Familjar në përputhje me *acquis* të BE-së për sistemin e drejtësisë;

1.1.7 Përditësimi i ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, në përputhje me *acquis* të BE-së për sistemin e drejtësisë;

1.1.8 Kontrollat e rregullta të përshtatshmërisë ligjore dhe miratimi i ndryshimeve ligjore të nevojshme për konsolidimin, pavarësinë, integritetin, efikasitetin dhe rritjen e besimit të publikut, ndërmerren në përputhje me *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane dhe forcojnë më tej parimet e reformës në drejtësi të vitit 2016;

1.1.9 Avancimi i reformës nëpërmjet ndryshimeve ligjore, duke përfshirë vijueshmërinë e rezultateve pozitive të procesit të verifikimit dhe forcimin e rregullave për kontrollin e pasurive dhe të figurës për aktorët e sistemit të drejtësisë;

1.1.10 Kryerja e ndryshimeve ligjore për masat që sigurojnë efikasitet lidhur me burimet njerëzore në gjykata dhe zyrat e prokurorisë;

1.1.11 Marrja e masave për mospërfshirjen e ish-magjistratëve të shkarkuar/dorëhequr gjatë *vetingut* në veprimtaritë e institucioneve të sistemit të drejtësisë;

1.1.12 Forcimi i kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës;

1.1.13 Rritja e mëtejshme e kapaciteteve të organeve të specializuara për korrupsionin dhe krimin e organizuar në mënyrë që ato të mund të kryejnë në mënyrë efektive hetimin dhe gjykimin.

Treguesit kryesorë:

- Numri i ligjeve dhe projektligjeve që pasqyrojnë propozimet për ndryshimet e ligjeve të reformës nga institucionet e pavarura të drejtësisë;

- Numri i akteve ligjore të BE-së me të cilat ligji vendës është përafuar të paktën “pjesërisht”.

Objektivi specifik 1.2: Përfundimi i procesit të rivlerësimit kalimtar (*vetingut*) brenda afateve kushtetuese dhe vendosja e mekanizmave për të siguruar qëndrueshmërinë e këtij procesi.

Përfundimi i procesit të rivlerësimit kalimtar kërkon që të gjitha çështjet pezull të verifikimit të përfundojnë në mënyrë efektive dhe të përmbushin afatet e parashikuara nga Kushtetuta, ndaj Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Komisioneri Publik janë të angazhuar për të siguruar finalizimin e të gjitha çështjeve pezull të verifikimit dhe duke siguruar që asnjë rast të mos mbetet në pritje pa u shqyrtuar.

Në të njëjtën kohë, është e nevojshme që Kolegji i Posaçëm i Apelimit të përshpejtojë ritmin e gjykimin të ankimimeve, me qëllim që ankimimet të shqyrtohen dhe të zgjidhen brenda afateve kushtetuese, duke përmbushur parashikimet e saj dhe duke ndihmuar në përmbylljen e procesit të *vetingut* në kohën e duhur. Përshpejtimi i këtij procesi është thelbësor për të garantuar që të gjitha çështjet të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me ligjin.

Pjesë e rëndësishme e përfundimit të procesit të *vetingut* është sigurimi që të gjitha çështjet që kanë dyshime për elemente të veprës penale të referohen në organet e prokurorisë.

Pas referimit, shërbimet e prokurorisë kanë një rol proaktiv në nisjen e procedimeve penale ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve që janë subjekt i *vetingut* dhe për të cilët janë zbuluar elementë penalë. Ky hap është thelbësor për të siguruar që çdo akt i paligjshëm të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe të përgjegjshme, duke forcuar më tej besimin në sistemin e drejtësisë dhe duke kontribuar në ruajtjen e standardeve të larta të integritetit dhe transparencës.

Rezultati i pritshëm:

- Pas përfundimit të mandatit të Institucionit të Komisionerëve Publikë, SPAK-u mban të njëjtin standard, në lidhje me përqindjen e ankimeve të paraqitura pranë KPA-së, për çështje të papërfunduara;

- Garantohet vazhdimësia e procesit të *vetingut* nëpërmjet vendime penale të fajësisë ndaj subjekteve të *vetingut* që nuk e kaluan procesin e rivlerësimit, në rastet kur janë evidentuar elemente të korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objektivi specifik 1.2 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 1.2 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

1.2.1 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Komisioneri Publik sigurojnë finalizimin e të gjitha çështjeve pezull të verifikimit;

1.2.2 Kolegji i Posaçëm i Apelimit përshpejton ritmin në gjykimin e ankimimeve dhe ndërmerr të gjithë hapat përkatës për të siguruar finalizimin e çështjeve dhe përmbush parashikimet ligjore brenda afatit kushtetues;

1.2.3 Institucionet e *vetingut* sigurojnë referimin sistematik të çështjeve në prokurori, ku ka dyshime për elementë penalë;

1.2.4 Shërbimet e prokurorisë në mënyrë proaktive nisin procedimin penal ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, procesi i *vetingut* të të cilëve ka zbuluar elementë penalë.

Treguesit kryesorë:

- Përqindja e ankimeve nga SPAK-u, për çështjet e papërfunduara të rivlerësimit të magistratëve pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit;

- Përqindja e subjekteve që nuk e kanë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar të cilët janë dënuar për korrupsion me vendim të formës së prerë, nga gjykatat e posaçme, duke garantuar të drejtën për një proces të drejtë ligjor.

Objektivi specifik 1.3: Ruajtja dhe zhvillimi i mëtëjshëm i kapacitetit profesional, pavarësisë dhe efikasitetit të organeve të qeverisjes së drejtësisë.

Për të ruajtur dhe zhvilluar kapacitetin profesional, pavarësinë dhe efikasitetin e organeve të qeverisjes së drejtësisë, është e nevojshme një qasje e integruar dhe e koordinuar që përfshin disa hapa thelbësorë.

Referuar raporteve të progresit, zbatimi i vazhdueshëm i reformës në drejtësi ka nxitur integritetin dhe profesionalizmin në organet e qeverisjes së drejtësisë dhe ka reduktuar ndikimin politik, por paraqiten ende disa sfida, si: mangësi në emërimet e anëtarëve jo magistratë të Lartë

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në lidhje me kontrollin e historikut dhe verifikimin e pasurisë, si dhe transparencën dhe meritokracinë e procesit të emërimeve. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) përbëhen, të dy, nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve janë magistratë të zgjedhur nga kolegët e tyre dhe pesë janë juristë të zgjedhur nga Parlamenti në bazë të një liste të krijuar nga një nënkomision parlamentar. Janë raportuar, gjithashtu, sfida në lidhje me konkurrencën dhe transparencën në lidhje me zbatimin e procedurave aktuale të përzgjedhjes nga Parlamenti.

Në këtë objektiv specifik, parashikohen masa për anëtarët jo magistratë të institucioneve të drejtësisë, duke përfshirë edhe ata të emëruar në KLGJ dhe KLP, për të siguruar që edhe ata i nënshtrohen standardeve të ngjashme të kontrollit të historikut dhe deklaratave të pasurisë, të zbatueshme për magistratët. Dispozitat ligjore që rregullojnë zgjedhjen e anëtarët jo magistratë të Këshillave nga Parlamenti dhe zbatimin e tyre në praktikë, nuk arrijnë të ruajnë përzgjedhjen e kandidatëve që demonstrojnë nivelin më të lartë të pavarësisë apo kompetencave, e cila është problematike, gjë e cila do të adresohet nëpërmjet masave të këtij objekti.

Gjithashtu, për të garantuar cilësinë e vendimmarrjes, është e rëndësishme të organizohen trajnime të rregullta që mbulojnë pajtueshmërinë me legjislacionin e brendshëm, *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane. Këto trajnime ndihmojnë në përmirësimin e vendimmarrjes dhe në sigurimin e një sistemi drejtësie të efektshëm dhe të drejtë.

Për të mbështetur transparencën dhe komunikimin, organet e qeverisjes së drejtësisë duhet të zbatojnë dhe të monitorojnë programe të detajuara transparence që mbulojnë të gjitha aspektet e vendimmarrjes së tyre. Këto programe përfshijnë vendimet për karrierën, menaxhimin e stafit dhe funksionimin e gjykatave dhe prokurorive, duke siguruar që publiku të jetë i informuar dhe i përfshirë në procesin e vendimmarrjes.

Në përmbledhje, këta hapa të integruar me masa dhe aktivitete konkrete do të ndihmojnë në forcimin e kapacitetit profesional dhe efikasitetit të organeve të drejtësisë, duke siguruar një sistem të qëndrueshëm dhe të besueshëm që përmbush standardet më të larta të drejtësisë dhe integritetit.

Rezultati i pritshëm:

- Deri më 2030-n nëpunësit dhe stafi administrativ i KLGJ-së dhe KLP-së janë trajnuar për çështje që lidhen me detyrat e tyre funksionale.

Lidhja e objektivit specifik me nënkaptullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objektivi specifik 1.3 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor”, të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 1.3 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

1.3.1 KLP-ja miraton aktet nënligjore të nevojshme për të përfunduar procedurën e vlerësimit për prokurorët, duke përfshirë miratimin e rregullat e procedurave të vlerësimit në PP dhe rregullat e procedurës për drejtuesit e prokurorive;

1.3.2 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhet të përafrojë plotësisht procedurat e tij me rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe të rrisë transparencën;

1.3.3 Organet e qeverisjes së drejtësisë të përfshira në vetingun e anëtarëve të Këshillave ose të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, veçanërisht anëtarëve jomagjistratë duhet të marrin masa të rregullta për rritjen e kapaciteteve për kontrollin e figurës dhe të pasurisë/integritetit;

1.3.4 Organet e qeverisjes së drejtësisë dhe të tjerët të përfshirë në vetingun e anëtarëve të Këshillave ose Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, veçanërisht të anëtarëve jo magistratë: të kryejnë kontrole të figurës dhe të pasurisë/integritetit në përputhje me standardet e larta të vetingut;

1.3.5 Cilësia e vendimeve të KLGJ-së dhe KLP-së, duke përfshirë pajtueshmërinë me legjislacionin e brendshëm, *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane, sigurohet nëpërmjet trajnimeve të organizuara;

1.3.6 KLGJ-ja zbaton më tej një program transparence dhe komunikimi për të gjithë elementet e vendimmarrjes së tyre, duke përfshirë vendimet për karrierën, menaxhimin, rekrutimin e stafit, funksionimin e gjykatave dhe monitoron dhe raporton në mënyrë të vazhdueshme publikisht për zbatimin e tij;

1.3.7 Miratimi dhe zbatimi i një programi transparence dhe komunikimi nga KLP-ja për të gjitha elementet e vendimmarrjes së tyre, duke përfshirë vendimet për karrierën, menaxhimin, rekrutimin e stafit në funksion të prokurorive, si dhe monitorimi dhe raportimi publik i vazhdueshëm.

Treguesit kryesorë:

- Përqindja e nëpunësve/stafit administrativ të KLGJ-së dhe KLP-së, të trajnuar për çështje që lidhen me detyrat e tyre funksionale.

Objektivi specifik 1.4: Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimi thelbësor i komunikimit publik.

Me gjithë arritjet e evidentuara në drejtim të bashkëpunimit ndërinstitucional të sektorit të drejtësisë, si rezultat i zbatimit dhe monitorimit të disa strategjive ndërsektoriale në fushën e drejtësisë, avancimi në rrugën e reformës kërkon rritje të kapacitetit të institucioneve të drejtësisë, për të siguruar bashkëpunimin e duhur, koordinimin ndërmjet institucioneve, monitorimin dhe raportimin e duhur dhe për të qenë transparent dhe të besueshëm në raport me publikun.

Referuar progresraportit në nëntor 2023, Shqipëria duhet të sigurojë një bashkëpunim efektiv ndërmjet institucioneve të drejtësisë, shpërndarje të burimeve të mjaftueshme dhe funksionim efikas dhe sistematik të sektorit të drejtësisë. Po ashtu, janë evidentuar ankesa të vazhdueshme nga media dhe shoqëria civile për transparencën dhe shtrirjen e informacionit, duke bërë të nevojshme të përmirësohet kuadri rregullator dhe të konsolidohet praktika për komunikimet mediatike dhe aksesin në informacion, bazuar në parimet e transparencës.

Arritja e objektivit adresohet në planin e veprimit me masa dhe aktivitete konkrete, ndaj për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet Këshillave, do të intensifikohen mbledhjet e përbashkëta dhe do të sigurohet komunikimi i drejtpërdrejtë me publikun, në lidhje me konkluzionet e mbledhjeve. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një lidhjeje më të fortë dhe më të besueshme me qytetarët, duke ofruar informacion të qartë dhe krijuar institucione transparente.

Gjithashtu, do të përgatiten planet e komunikimit dhe transparencës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, SPAK-u, Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si dhe Ministria e Drejtësisë. Këto plane do të synojnë të zhvillojnë më tej mirëkuptimin dhe të rrisin besimin e publikut në Reformën në Drejtësi. Me këto plane, do të krijohet një komunikim i hapur dhe i besueshëm me publikun, duke kontribuar në një proces reformash gjithëpërfshirëse dhe të mbështetura nga qytetarët.

Rezultati i pritshëm:

- Gjatë kohëzgjatjes së SND 2024–2030 garantohen të paktën 2 takime vjetore të përbashkëta të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objektivi specifik 1.4 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së, “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 1.4 lidhet, gjithashtu, me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

1.4.1 Kapaciteti i duhur i institucioneve të drejtësisë për të siguruar bashkëpunimin e duhur, si dhe mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin për avancimin e reformës në drejtësi;

1.4.2 Vijimi i bashkëpunimit të Këshillave, duke intensifikuar mbledhjet e përbashkëta dhe sigurimin e komunikimit të drejtpërdrejtë me publikun për ndjekjen e konkluzioneve të mbledhjeve;

1.4.3 Planet e komunikimit dhe transparencës të përgatitura nga KLGJ-ja, KLP-ja, SPAK, Gjykatat e Posaçme dhe MD-ja, për të zhvilluar më tej mirëkuptimin dhe rritjen e besimit të publikut tek Reforma në Drejtësi.

Treguesit kryesorë:

- Numri i takimeve të përbashkëta të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstytucional.

Qëllimi politik 2 – Forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë

Ky qëllim thekson rëndësinë e ndarjes së pushteteve dhe eliminimin e ndikimeve të jashtme që mund të cenojnë vendimet e gjykatësve dhe prokurorëve. Në nivel kombëtar, përpjekjet janë të përqendruara në përmirësimin e kornizës ligjore dhe institucionale që siguron autonominë e organeve të drejtësisë dhe krijimin e mekanizmave të fortë të llogaridhënies për të garantuar që ata që shkelin parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë të mbajnë përgjegjësi.

Gjithashtu, ky qëllim përfshin përpjekjet për të forcuar transparencën në proceset gjyqësore dhe për të siguruar që drejtësia jo vetëm të administrohet, por edhe të perceptohet si e drejtë nga publiku. Kjo përfshin masa për të parandaluar korrupsionin brenda sistemit të drejtësisë dhe për të përmirësuar proceset e rekrutimit dhe të promovimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke i bazuar ato në meritokraci dhe kritere objektive.

Në dimensionin ndërkombëtar, ky qëllim synon të harmonizojë sistemin e drejtësisë me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, duke përfshirë përmirësimin e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare dhe rritjen e shkëmbimeve profesionale dhe institucionale për të siguruar që sistemi ynë i drejtësisë të jetë i përputhshëm me angazhimet ndërkombëtare dhe të arrijë një nivel të lartë të integritetit dhe paanshmërisë.

Për arritjen e këtij qëllimi politik, institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me institucionet e tjera, partnerë vendës dhe ndërkombëtarë do të fokusohen në përmbushjen e pesë objektivave specifike:

Objektivi specifik 2.1: Garantimi i emërimeve dhe zi hvillemit të karrierës së magistratëve në sistemin e drejtësisë, bazuar në meritokraci.

Objektivi specifik 2.2: Forcimi i kapaciteteve institucionale, të magistratëve edhe jomagjistrateve për parandalimin dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e brendshme dhe të jashtme.

Objektivi specifik 2.3: Sigurimi i zbatimit të njëtrajtshëm të standardeve të ndarjes së rastësishme të çështjeve.

Objektivi specifik 2.4: Kontrollat e figurës dhe pasurisë në sistemin e drejtësisë kryhen në përputhje me standardet e vetëgjit.

Objektivi specifik 2.5: Përforcimi i mekanizmave të llogaridhënies së magistratëve.

Lidhja midis qëllimit politik 2 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi politik 2 lidhet me objektivin 16 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ, “Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”. SND 2024–2030, lidhet me nënobjektivin 16.3, “Promovimi i shtetit të së drejtë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë”. Gjithashtu, SND 2024–2030, lidhet me nënobjektivin 16.6, “Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet”, me nënobjektivin 16.7, “Sigurimi i vendimmarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet”, si dhe me nënobjektivin 16.10, “Sigurimi i aksesit të publikut në informacion dhe mbrojtja e lirisë themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare”.

Objektivi specifik 2.1: Garantimi i emërimeve dhe i zhvillimit të karrierës së magistratëve në sistemin e drejtësisë, bazuar në meritokraci.

Objektivi specifik “Garantimi i emërimeve dhe zhvillimit të karrierës së magistratëve në sistemin e drejtësisë, bazuar në meritokraci” synon të sigurojë që proceset e emërimit dhe promovimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të bazohen në kritere objektive, të qarta dhe të drejta me targete të qarta të vendosura në Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës që rrjedhin nga *Screening Report*. Ky objektivi është jetësor për të garantuar një sistem drejtësie që është i drejtë, i pavarur dhe i besueshëm për publikun.

Në Shqipëri, proceset e emërimit dhe promovimit të magistratëve janë kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Megjithatë, për të përmirësuar këto procese dhe për t’u siguruar që ato janë plotësisht transparente dhe të bazuara në meritë, këto institucione kanë rishikuar rregullat e tyre të brendshme. Ky rishikim synon të sigurojë që çdo emërim dhe ngritje në detyrë të bëhet mbi bazën e performancës, kompetencave profesionale, dhe integritetit të kandidatëve, duke shmangur çdo lloj ndikimi të padrejtë ose favorizimi.

Për të arritur këtë, KLGJ-ja dhe KLP-ja kanë vendosur të promovojnë transparencën në procesin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Një aspekt kyç i kësaj është publikimi i rregullt i procedurave të ngritjes në detyrë, duke u dhënë të gjithë kandidatëve mundësinë për të marrë pjesë në këto procese në mënyrë të barabartë dhe të drejtë. Ky proces i hapur dhe transparent synon të forcojë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe të inkurajojë një kulturë të meritokracisë dhe profesionalizmit brenda këtij sistemi.

Me anë të këtyre masave, objektivi synon të sigurohet që karriera e magistratëve të zhvillohet në mënyrë të drejtë dhe të bazuar në meritë, duke promovuar një sistem drejtësie që është i drejtë dhe i barabartë për të gjithë.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030, KLGJ-ja dhe KLP-ja arrijnë të zbatojnë 100% të planeve vjetore përkatëse të vlerësimit të rregullt etik dhe profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

- Deri në fund të vitit 2030, 80% e magistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë) janë vlerësuar me të paktën një vlerësim të plotë etik dhe profesional

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 1 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së, “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky qëllim objektiv lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 1 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

2.1.1 Këshillat plotësojnë rregullat e tyre të brendshme me qëllim emërimin dhe zhvillimin e karrierës së magistratëve në sistemin e drejtësisë, bazuar në meritokraci.

2.1.2 KLGJ-ja dhe KLP-ja sigurojnë më tej promovimin transparent të gjyqtarëve dhe prokurorëve duke publikuar rregullisht procedurat e ngritjes në detyrë.

Treguesit kryesorë:

- Përqindja e magistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë) për të cilët është përfunduar vlerësimi i rregullt etik dhe profesional nga KLGJ-ja/KLP-ja në përputhje me planin vjetor respektiv, sipas nivelit të vlerësimit;

- Përqindja e magistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë) në sistemin e drejtësisë të vlerësuar me të paktën një vlerësim të plotë etik dhe profesional.

Objektivi specifik 2.2: Forcimi i kapaciteteve institucionale, të magistratëve edhe jomagjistratëve për parandalimin dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e brendshme dhe të jashtme.

Ky objektivi është i rëndësishëm për ndërtimin e një sistemi drejtësie të qëndrueshëm dhe të pavarur, duke forcuar kapacitetet e institucioneve dhe individëve të përfshirë në këtë sistem për të parandaluar dhe mbrojtur nga ndikimet dhe ndërhyrjet e brendshme dhe të jashtme. Për të arritur këtë, janë parashikuar disa masa kyçe që përfshijnë forcimin e integritetit, reagimin ndaj ndikimeve të padrejta dhe mbledhjen e të dhënave për të adresuar këto ndikime.

Një pjesë e rëndësishme e këtij objektivi është forcimi i integritetit nëpërmjet trajnimit të ofruar nga Shkolla e Magjistraturës. Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, ofron programe trajnimi të specializuara për magistratët dhe jomagjistratët. Këto trajnime duhet të përqendrohen në ndihmën e magistratëve për të menaxhuar dhe mbrojtur veten nga ndikimet e brendshme dhe të jashtme që mund të kërcënojnë pavarësinë e tyre dhe integritetin e sistemit të drejtësisë.

Në të njëjtën kohë, është e nevojshme që këshillat të reagojnë ndaj deklaratave publike që ushtrojnë ndikim të padrejtë mbi magistratët. Këshillat duhet të jenë të angazhuar për të marrë masa parandaluese ndaj këtyre ndikimeve dhe për të siguruar një mjedis të drejtë dhe të paanshëm për magistratët, duke i mbrojtur ata nga presionet dhe ndikimet e jashtme që mund të dëmtojnë funksionimin e drejtë të sistemit të drejtësisë.

Për më tepër, mbledhja e të dhënave, analiza dhe vlerësimi i çështjeve janë të rëndësishme për të përballuar ndikimet e padrejta dhe presionet ndaj magistratëve. Këto procese ndihmojnë në identifikimin e problemeve dhe në formimin e strategjive për t'i përballuar ato. Këshillat duhet të angazhohen në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për të reaguar në mënyrë të shpejtë dhe efikase ndaj presioneve politike, intimidimit dhe akuzave që mund të ndikojnë negativisht në integritetin e sistemit të drejtësisë.

Nëpërmjet këtyre masave synohet krijimi i një ambienti të mbrojtur dhe të pavarur për magistratët dhe institucionet që operojnë në sistemin e drejtësisë, duke forcuar kapacitetet e tyre për të parandaluar dhe mbrojtur nga ndërhyrjet e brendshme dhe të jashtme që mund të kërcënojnë funksionimin e drejtë dhe të paanshëm të këtij sistemi.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030 magistratët dhe anëtarët e institucioneve janë trajnuar rregullisht mbi tematika lidhur me rastet e ndërhyrjeve të brendshme dhe të jashtme.

Lidhja e objektivit specifik me nënkaptullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 2 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së, “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor”, të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky qëllim politik lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 2 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

2.2.1 Forcimi i integritetit dhe trajnimi i ofruar nga Shkolla e Magjistraturës dhe institucionet e qeverisjes;

2.2.2 Këshillat reagojnë ndaj deklaratave publike ku ushtrohet ndikim i padrejtë mbi magistratët dhe marrin masa parandaluese;

2.2.3 Mbledhja e të dhënave, analiza dhe vlerësimi i çështjeve ku Këshillat do të reagojnë përmes deklaratave publike ndaj presionit politik, intimidimit dhe akuzave ndaj magistratëve.

Treguesit kryesorë:

- Numri i trajnimeve dhe i pjesëmarrësve (magjistratë dhe anëtarë të institucioneve) mbi tematika lidhur me rastet e ndërhyrjeve të brendshme dhe të jashtme.

Objektivi Specifik 2.3: Sigurimi i zbatimit të njëtrajtshëm të standardeve të ndarjes së rastësishme të çështjeve.

Ky objektivi përqendrohet në forcimin e transparencës dhe paanshmërisë në sistemin e drejtësisë, duke siguruar që ndarja e çështjeve gjyqësore të bëhet në mënyrë të rastësishme dhe të

paanshme. Kjo është thelbësore për të garantuar që çdo çështje të trajtohet në përputhje me ligjin dhe për të parandaluar çdo formë të mundshme të ndërhyrjes ose ndikimit të padrejtë në procesin gjyqësor.

Për të arritur këtë qëllim, Këshillat e Gjyqësorit do të angazhohen në monitorimin e vazhdueshëm të çështjeve gjyqësore penale që lidhen me korrupsionin aktiv dhe pasiv në sistemin e drejtësisë. Ky monitorim ka për qëllim të identifikojë dhe adresojë çdo shkelje të mundshme në ndarjen e rastësishme të çështjeve, duke siguruar që çdo rast të trajtohet me drejtësi dhe pa ndikime të jashtme.

Një masë kyçe në këtë proces është vendosja e një sistemi të paralajmërimit të hershëm për monitorimin e ndarjes së çështjeve nga gjykatat. KLGJ-ja do të kryejë një analizë të thellë për të vendosur një sistem që do të garantojë një zbatim konsistent të ndarjes së rastësishme të çështjeve. Ky sistem do të ndihmojë në identifikimin e shpejtë të çdo problemi ose shkeljeje në proces dhe në zbatimin e masave korrigjuese kur është e nevojshme.

Për më tepër, KLGJ-ja do të sigurojë që rregullat për ndarjen e rastësishme të çështjeve të zbatohen në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë. Ky proces do të bazohet në kritere transparente dhe të drejta, duke garantuar se çdo çështje të trajtohet në mënyrë të barabartë dhe pa preferenca të padrejta.

Në këtë mënyrë, ky objektiv synon të forcojë besimin në sistemin e drejtësisë duke garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm në ndarjen dhe trajtimin e çështjeve gjyqësore.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030 garantohet përdorimi i sistemit elektronik në hedhjen e shortit për plotësimin e trupit gjyqësor. Shorti manual përdoret vetëm në raste përjashtimore.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 3 lidhet me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së, “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor”, të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektiv lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 3 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

2.3.1 Monitorimi i vazhdueshëm kryhet nga Këshillat lidhur me çështjet gjyqësore penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv në gjyqësor;

2.3.2 KLGJ-ja kryen një analizë për vendosjen e sistemit të paralajmërimit të hershëm të monitorimit të ndarjes së çështjeve nga gjykatat për të garantuar zbatimin konsistent të ndarjes së rastësishme të çështjeve dhe masat e duhura korrigjuese kur është e nevojshme;

2.3.3 KLGJ-ja dhe PP-ja, sigurojnë se rregullat për ndarjen e rastësishme të çështjeve zbatohen në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme në gjykata dhe prokurori bazuar në kritere transparente dhe të drejta.

Treguesit kryesorë:

- Shkalla (%) e përdorimit të shortit elektronik në hedhjen e shortit për plotësimin e trupit gjyqësor.

Objektivi specifik 2.4: Kontrollat e figurës dhe pasurisë në sistemin e drejtësisë kryhen në përputhje me standardet e vetingut.

Në përputhje për të forcuar integritetin dhe transparencën në sistemin e drejtësisë, objektivi specifik 2.4 synon të sigurojë që kontrollat e figurës dhe pasurisë të anëtarëve të këtij sistemi të jenë në përputhje të plotë me standardet rigoroze të *vetingut*. Ky objektiv është thelbësor për të garantuar që zyrtarët gjyqësorë dhe prokurorët të jenë të paanshëm, të pavarur dhe të përmbushin standardet më të larta të integritetit.

Një masë kyçe e këtij objektiv është përfshirja e ILDKPKI-së, e cila ka për detyrë të sigurojë përditësimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të deklaratave të pasurisë nga anëtarët e sistemit

gjyqësor dhe të prokurorisë. Përmes këtij procesi, ILDKPKI-ja jo vetëm që grumbullon dhe analizon të dhënat e deklaruara, por, gjithashtu, kryen hetime të thelluara për të identifikuar çdo parregullsi të mundshme. Në rastet kur zbulohen shkelje, çështjet i referohen prokurorisë për veprime të mëtejshme, duke u bazuar në standardet e larta të *vetingut* që janë vendosur tashmë.

Paralelisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin sistematik të raporteve të deklarimit të pasurisë të siguruara nga ILDKPKI-ja. Këto këshilla ndjekin nga afër këto raporte dhe, nëse është e nevojshme, ndërmarrin hetime të mëtejshme për të siguruar që pasuria dhe figura e anëtarëve të sistemit gjyqësor të jenë të pajtueshme me standardet e kërkuara. Ky proces, gjithashtu, përfshin hetime efikase dhe, kur është e nevojshme, referime në prokurori për trajtimin e mëtejshëm të çështjeve.

Një tjetër masë e rëndësishme është përcaktimi i kriterit të eksperiencës në procesin e *vetingut* si kriter preferencial në shpalljet e reja nga KLGJ-ja dhe KLP-ja për vendet vakante. Kjo masë synon të përfshijë më tej ekspertizën dhe përvojën e atyre që kanë qenë pjesë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA), IKP-së (Institucioni i Komisionerëve Publik) në vendimmarrjet e reja. Duke bërë këtë, synohet që eksperiencia e tyre në trajtimin e çështjeve të *vetingut* të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për pozicione në sistemin e drejtësisë.

Për më tepër, është parashikuar që deklaratat e pasurisë së anëtarëve të institucioneve të pavarura të drejtësisë të përditësohen dhe të verifikohen periodikisht. Ky hap është i domosdoshëm për të mbajtur një nivel të lartë të transparencës dhe për të garantuar që deklaratat e pasurisë të përputhen me realitetin dhe nuk fshehin pasuri të pashpjegueshme.

Në këtë mënyrë, ky objektiv synon të konsolidojë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë duke siguruar që çdo zyrtar brenda tij të jetë i kontrolluar dhe i pajtueshëm me standardet e larta të *vetingut*, duke mbrojtur kështu integritetin e gjithë sistemit dhe duke siguruar që përvojat më të mira të procesit të *vetingut* të integrohen në të ardhmen e këtij sistemi.

Rezultati i pritshëm:

- ILDKPKI-ja garanton efikasitetin e mekanizmave të kontrollit dhe të masave kundra shkeljeve në lidhje me deklarimin e pasurisë për subjektet që i nënshtrohen këtij detyrimi dhe kontribuon në ndërgjegjësimin e subjekteve, i reflektuar në një trend konstant ose në ulje të numrit të masave administrative ndaj subjekteve të kontrollit.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 4 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së, “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky qëllim objektiv lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 4 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

2.4.1 ILDKPKI-ja siguron përditësime të vazhdueshme dhe të qëndrueshme të deklaratave të pasurisë së anëtarëve të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë dhe heton dhe raporton çështjet, sipas rastit, në prokurori, bazuar në praktikën e vendosur nga standardet e larta të procesit të *vetingut*;

2.4.2 KLGJ-ja dhe KLP-ja sigurojnë ndjekjen sistematike të raporteve të deklarimit të pasurisë nga ILDKPKI-ja dhe hetime të mëtejshme në kontekstin e shqyrtimit të pasurisë dhe të figurës së tyre, duke përfshirë sigurimin e hetimeve efikase në vijim dhe referimin në prokurori;

2.4.3 Deklaratat e pasurisë së anëtarëve të institucioneve të pavarura të drejtësisë përditësohen dhe verifikohen në mënyrë periodike.

Treguesit kryesorë:

- Numri i masave administrative ndaj subjekteve të organeve gjyqësore, si rezultat i kontrolleve të plota të kryera ndaj tyre.

Objektivi Specifik 2.5: Përforcimi i mekanizmave të llogaridhënies së magjistratëve.

Nëpërmjet këtij objektiivi synohet të forcohen mekanizmat e llogaridhënies për magjistratët, duke krijuar një kornizë të fortë që garanton paanshmëri, pavarësi dhe integritet në sistemin gjyqësor shqiptar. Për të arritur këtë, është e nevojshme që Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD) të ketë kapacitetet e duhura për të kryer detyrat e tij me efikasitet dhe pavarësi.

Një nga masat kryesore për të përmbushur këtë objektiv është hartimi i rregullave për përbërjen dhe vjetërsinë e ILD-së, duke vendosur garanci të mjaftueshme për të siguruar që ky organ të jetë i mbrojtur nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga legjislativi dhe ekzekutivi. Këto rregulla janë të nevojshme për të ruajtur paanshmërinë dhe profesionalizmin e ILD-së, duke garantuar kështu integritetin e proceseve të saj.

Një tjetër masë e rëndësishme është plotësimi gradual i vakancave në radhët e inspektorëve të ILD-së. Për këtë qëllim, është e rëndësishme që pozicioni i inspektorit të jetë tërheqës dhe të përfshijë masa për përforsimin e stafit mbështetës të ILD-së, në mënyrë që ky institucion të mund të përmbushë nevojat e tij objektive dhe të funksionojë në mënyrë efektive.

Gjithashtu, burimet konsistente dhe të përshtatshme të akorduara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) janë një tjetër komponent thelbësor për përforsimin e llogaridhënies së magjistratëve. Këto burime duhet të sigurojnë që hetimet disiplinore të iniciuara nga ILD-ja të kryhen në kohë dhe në mënyrë sistematike, duke rritur kështu efektivitetin e këtyre hetimeve dhe duke garantuar zbatimin e standardeve të larta të llogaridhënies.

Për më tepër, rregullat për monitorimin periodik të telekomunikacionit të personelit të Gjykatave Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë përcaktuar për të siguruar që sistemi të funksionojë në përputhje me parimet e proporcionalitetit, qartësisë dhe parashikueshmërisë. Zbatimi i këtij sistemi është një tjetër masë kyçe për të siguruar që monitorimi të jetë i drejtë dhe në përputhje me standardet evropiane, duke ruajtur kështu integritetin e procesit.

Së fundmi, zbatimi dhe ndjekja e mëtejshme e dokumenteve strategjike të KLGJ-së për hetimin administrativ të sinjalizuesve dhe shqyrtimin e rasteve të korrupsionit brenda KLGJ-së është thelbësore për të garantuar që çdo rast korrupsioni të trajtohet me seriozitetin dhe efikasitetin e duhur. Këto masa synojnë të përforcojnë transparencën dhe llogaridhënien në sistemin gjyqësor, duke rritur kështu besimin e publikut në këtë institucion dhe duke kontribuar në forcimin e sundimit të ligjit në Shqipëri.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030 ILD zbaton 100% të planeve vjetore të inspektimeve pranë gjykatave dhe prokurorive;

- Deri në fund të vitit 2030 garantohet konfirmimi nga Këshillat (KLGJ, KLP) i një përqindjeje të lartë të kërkesave të ILD-së për aplikimin e një mase disiplinore.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektiivi specifik 5 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së, “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektiv lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektiivi specifik 5 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

2.5.1 Hartimi i rregullave për përbërjen dhe vjetërsinë e ILD-së, të cilat vendosin garanci të kënaqshme të paanshmërisë, pavarësisë dhe profesionalizmit për mbrojtjen e institucionit nga ndikimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i legjislativit dhe ekzekutivit;

2.5.2 Plotësimi gradual i vakancave në radhët e inspektorëve në ILD, duke synuar që ky pozicion të bëhet i pëlqyeshëm dhe rritja e kapaciteteve të stafit mbështetës të ILD-së për t’ju përgjigjur nevojave objektive të institucionit;

2.5.3 KLP-ja dhe KLGJ-ja akordojnë burime konsistente dhe të përshtatshme në lidhje me hetimet disiplinore të iniciuara nga ILD-ja në kohë dhe në mënyrë sistematike;

2.5.4 Përcaktimi i rregullave të monitorimit periodik të telekomunikacionit të personelit të Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për një sistem funksional në përputhje me parimet e proporcionalitetit, qartësisë dhe parashikueshmërisë. Sistemi është zbatuar në përputhje me standardet evropiane;

2.5.5 Zbatimi dhe ndjekja e mëtejshme e dokumenteve strategjike të KLGJ-së për hetimin administrativ të sinjalizuesve dhe shqyrtimin e rasteve të korrupsionit brenda KLGJ-së.

Treguesit kryesorë:

- Përqindja e inspektimeve të përfunduara sipas planit vjetor të inspektimeve pranë gjykatave dhe prokurorive;
- Përqindja e vendimeve të KLGJ-së dhe të KLP-së që pranojnë kërkesën e ILD për masë disiplinore.

Qëllimi politik 3

Rritja e efikasitetit të institucioneve në sistemin e drejtësisë

Me qëllim hartimin e masave të reja që trajtojnë rekomandimet specifike të Raportit të Shqyrtimit dhe përputhen me angazhimet e ndërmarra nga Shqipëria në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, për sa i përket efikasitetit dhe cilësisë së sistemit të drejtësisë është parashikuar ky qëllim politik, i cili është zberthyer për realizimin e tij në disa objektiva specifike.

Në këto dokumente konstatohet se për të përmirësuar efikasitetin e sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë, është e nevojshme të miratohet një plan veprimi që përfshin rishikimin e ligjeve dhe rregullave procedurale lidhur me masat që synojnë rritjen e efikasitetit, përfshirë edhe mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Ky plan duhet të adresojë problemet e kohëzgjatjes së procedurave, rendimentin e ulët dhe numrin e madh të çështjeve të pazgjidhura. Ndërkohë, është e rëndësishme të avancohen emërimet në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë plotësimin e vakancave në Gjykatën e Lartë dhe SPAK-un, si dhe trajtimin e çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Apelit dhe gjykatat e shkallës së parë.

Në këtë kontekst qëllimi politik 3 synon përmirësimin e kapacitetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe gjykatave, duke përfshirë Gjykatën e Lartë, për të zbatuar masa që do të rrisin efikasitetin e tyre operativ. Po ashtu, janë parashikuar masa konkrete për përmirësimin e kapaciteteve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), si dhe i zyrave të prokurorisë, për të implementuar strategji që do të optimizojnë efikasitetin e punës së tyre.

Një tjetër aspekt kyç është përmirësimi i kapacitetit të Prokurorisë Speciale Antikorrupsion dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit. Këto institucione duhet të sigurojnë hetime dhe procedime penale që janë në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të promovohen dhe përkrahen mekanizmat e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, që ofrojnë një mënyrë më efikase dhe të shpejtë për të trajtuar konfliktet.

Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit është, gjithashtu, një faktor kyç në rritjen e efikasitetit të gjykatave dhe prokurorive. Implementimi i mjeteve moderne teknologjike do të ndihmojë në përshpejtimin e proceseve dhe përmirësimin e menaxhimit të informacionit. Gjithashtu, ky qëllim politik synon përmirësimin e kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të varësisë për të forcuar aksesin në drejtësi për të gjithë qytetarët, duke siguruar që sistemi i drejtësisë të jetë më i aksesueshëm dhe më i efektshëm në ofrimin e shërbimeve të tij.

Përmbushja e këtyre objektivave është thelbësore për të ndërtuar një sistem të drejtësisë më të fortë dhe më të drejtë, i cili do të kontribuojë në forcimin e sundimit të ligjit dhe në rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë. Investimi në kapacitetet dhe teknologjitë e reja do të ndihmojë në përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës, duke e bërë sistemin e drejtësisë më të përshtatshëm dhe të efektshëm për nevojat e shoqërisë.

Për arritjen e këtij qëllimi politik, institucionet përgjegjëse, në bashkëpunim me institucionet e tjera, partnerë vendës dhe ndërkombëtarë, do të fokusohen në përmbushjen e gjashtë objektivave specifike:

Objektivi specifik 3.1: Përmirësimi i kapacitetit të KLGJ-së dhe gjykatave, përfshirë GJL-në, për zbatimin e masave që rrisin efikasitetin.

Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i kapacitetit të PP-së, KLP-së dhe zyrave të prokurorisë, për zbatimin e masave që rrisin efikasitetin.

Objektivi specifik 3.3: Përmirësimi i kapacitetit të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, me qëllim sigurimin e hetimeve dhe procedimeve penale efektive në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

Objektivi specifik 3.4: Përkrahja/promovimi dhe rritja e përdorimit të mekanizmave të zgjidhjes alternative me marrëveshje.

Objektivi specifik 3.5: Rritja e efikasitetit në gjykata dhe prokurori me anë të mjeteve të Teknologjisë së Informacionit dhe komunikimit.

Objektivi specifik 3.6: Përmirësimi i kapaciteteve të MD dhe institucioneve të varësisë për të përforcuar aksesin në drejtësi.

Lidhja midis qëllimit politik 3 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi politik 3 lidhet me objektivin 16 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ, “Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”. SND 2024–2030, lidhet me nënobjektivin 16.3, “Promovimi i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë”. Gjithashtu, SND 2024–2030, lidhet me nënobjektivin 16.6, “Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet”, me nënobjektivin 16.7, “Sigurimi i vendimmarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet”, si dhe me nënobjektivin 16.10, “Sigurimi i aksesit të publikut në informacion dhe mbrojtja e lirisë themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare”.

Objektivi specifik 3.1: Përmirësimi i kapacitetit të KLGJ-së dhe gjykatave, përfshirë GJL, për zbatimin e masave që rrisin efikasitetin.

Plotësimi i vakancave për magistratët në gjykata e shkallës së parë dhe të dytë të juridiksionit të përgjithshëm vazhdon të mbetet një problematikë e rëndësishme, kryesisht për shkak të procesit të *vetingut*. Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës nënvizon nevojën për qëndrueshmëri në plotësimin e vakancave nga Këshilli i Lartë i Gjyqësorit (KLGJ), duke përfshirë masa që mundësojnë emërimet, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të magistratëve, duke u bazuar në vlerësime etike dhe profesionale të rregullta dhe në kohë. Problematikat më të mëdha janë vakancat në Gjykatën e Apelit për gjyqtarë dhe staf administrativ, të cilat janë përkeqësuar për shkak të kushteve të papërshtatshme të ambienteve për këtë numër të lartë gjyqtarësh dhe anëtarësh stafi.

Nëpërmjet këtij objektivi specifik, KLGJ-ja do të zbatojë hartën e re gjyqësore përmes përmirësimit të infrastrukturës së gjykatave, riorganizimit të burimeve njerëzore, trajnimeve të stafit dhe vlerësimit të vazhdueshëm. Do të analizojë dhe përshtatë aktet nënligjore për të garantuar funksionimin efikas të sistemit gjyqësor.

Në këtë kuadër, ky objektivi synon përmirësimin e kapacitetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykatave, duke përfshirë Gjykatën e Lartë, për të rritur efikasitetin e sistemit gjyqësor. Për këtë qëllim, synohet përmirësimi i strategjive për të rritur efikasitetin dhe për të reduktuar çështjet e prapambetura, sigurimi i burimeve të nevojshme për zbatimin e këtyre strategjive, përmirësimi i procesit të emërimeve dhe avancimit të gjyqtarëve, si dhe sigurimi i zbatimit efikas dhe në kohë të vendimeve gjyqësore dhe të GJEDNJ-së. Po ashtu, synohet rritja e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave për krimet e gjuhës së urrejtjes, duke pasur parasysh rekomandimet e ODIHR-it.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030 shërbimi përmbarimor do të ekzekutojë 30% dosje më shumë se dosjet e ekzekutuara në vitin 2024.

- Gjatë periudhës së SND 2024–2030 regjistrohet një përmirësim progresiv i DT-së (*Disposition Time*), sipas shkallëve të gjykatave dhe llojit të çështjeve (civile, penale, administrative)

- Deri në fund të vitit 2027 garantohet plotësimi progresiv i vakancave (70% të organikës së gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm; 80% të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm; 90% e stafit jomagjistrat në të gjitha shkallët e gjykatave) dhe në vitet në vijim sigurohet mbajtja ose rritja e standardit.

- Deri në fund të vitit 2026 garantohet reduktimi progresiv i çështjeve të mbartura (30% për çështjet civile dhe tregtare të gjykatës së shkallës së parë juridiksioni i përgjithshëm; 20% për çështjet penale; 25% për çështjet e gjykatës së apelit; 35% për çështjet e gjykatës administrative) dhe në vitet në vijim sigurohet mbajtja ose rritja e standardit.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 3.1 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së, “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor”, të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 3.1 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

3.1.1 Implementimi i hartës së re gjyqësore nga KLGJ-ja dhe gjykatat.

3.1.2 KLGJ-ja/këshillat e gjykatave harton/jnë dhe miraton/jnë një strategji efikasiteti/reduktimi të çështjeve të prapambetura/shpërndarje të barabartë të ngarkesës për gjykatat në të gjitha nivelet.

3.1.3 Garantimi i burimeve njerëzore dhe buxhetit të duhur për të siguruar zbatimin praktik të strategjisë së efikasitetit/reduktimit të çështjeve të prapambetura/shpërndarjen e ngarkesës së punës në gjykata.

3.1.4 KLGJ-ja përparon me emërimet e gjyqtarëve.

3.1.5 KLGJ-ja zgjeron më tej procedurat e vlerësimit dhe avancimit në karrierë të gjyqtarëve bazuar në kriteret cilësore dhe sasore.

3.1.6 Sigurohet zbatim i kohë dhe efikas i vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

3.1.7 Zbatim i qëndrueshëm dhe në kohë i vendimeve të GJEDNJ-së, përfshirë vendimet në fushën e pronësisë.

3.1.8 KLGJ-ja siguron mbledhjen dhe raportimin e të dhënave përkatëse për krimet e urrejtjes duke reflektuar rekomandimet e ODIHR-it.

Treguesit kryesorë:

- Raporti i dosjeve të ekzekutuara nga përmbauesi shtetëror me dosjet e regjistruara (%);
- Përqindja e zvogëlimit të DT (*Disposition Time*), sipas shkallëve të gjykatave dhe llojit të çështjeve (civile, penale, administrative);

- Plotësimi i vakancave në gjykata;

- Përqindja e reduktimit të çështjeve të mbartura (sipas shkallëve të gjykatave).

Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i kapacitetit të PP-së, KLP-së dhe zyrave të prokurorisë, për zbatimin e masave që rrisin efikasitetin.

Ky objektivi specifik synon përmirësimin e kapacitetit dhe efikasitetit të sistemit të drejtësisë duke forcuar rolin dhe funksionalitetin e Prokurorisë së Përgjithshme (PP), Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), dhe zyrave të prokurorisë. Në këtë kuadër, do të hartohet dhe miratohet një strategji që synon rritjen e efikasitetit dhe shpërndarjen e barabartë të ngarkesës për prokuroritë në të gjitha nivelet. Për të mbështetur këtë strategji, do të sigurohen burime njerëzore dhe buxhet i mjaftueshëm për të mundësuar zbatimin e saj praktik.

Do të përparojë procesi i emërimeve të prokurorëve dhe do të zgjerohet procedura e vlerësimit dhe avancimit në karrierë për prokurorët, duke u bazuar në kriteret cilësore dhe sasore dhe duke rritur transparencën.

Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme dhe prokuroritë do të zbatojnë Hartën e Re Gjyqësore duke finalizuar projektet infrastrukturore, riorganizuar burimet njerëzore sipas kërkesave të reja

dhe siguruar trajnime të rregullta për stafin. Gjithashtu, do të kryhen analiza periodike mbi zbatimin e akteve nënligjore dhe, bazuar në gjetjet, do të propozohen ndryshime për të garantuar një funksionim sa më efikas të prokurorive në përputhje me hartën e re.

Në fushën e sigurisë dhe drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe PP-ja do të mbledhin dhe raportojnë të dhëna të sakta për krimet e lidhura me gjakmarrjen dhe krimet e urrejtjes, duke ndjekur udhëzimet përkatëse dhe rekomandimet ndërkombëtare. Përveç kësaj, Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Përgjithshme do të angazhohen për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi sulmet ndaj gazetarëve, duke kontribuar në mbrojtjen e lirisë së shtypit dhe sigurinë e gazetarëve. Këto masa do të kontribuojnë në forcimin e sistemit të drejtësisë dhe rritjen e besimit të publikut në të.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030 garantohet ulja progresive e ngarkesës për prokuror e cila pritet të ndikojë pozitivisht në efikasitetin e punës së prokurorisë, si dhe në cilësinë e hetimeve penale.

Lidhja e objektivit specifik me nënkaptullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 3.2 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së, “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor”, të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objekti lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 3.2 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

3.2.1 Implementimi i hartës së re gjyqësore nga PP dhe prokuroritë;

3.2.2 KLP-ja dhe PP-ja hartojnë dhe miratojnë një strategji efikasiteti, shpërndarje të barabartë të ngarkesës për prokuroritë në të gjitha nivelet;

3.2.3 Garantimi i burimeve njerëzore dhe buxhetit të duhur për të siguruar zbatimin praktik të strategjisë së efikasitetit/shpërndarjen së ngarkesës së punës në prokurori;

3.2.4 KLP-ja përparon me emërimet e prokurorëve;

3.2.5 KLP-ja zgjeron më tej procedurat e vlerësimit dhe avancimit në karrierë të prokurorëve bazuar në kriteret cilësore dhe sasiore;

3.2.6 Sigurohet zbatimi në kohë dhe efikas i vendimeve penale të formës së prerë;

3.2.7 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe PP sigurojnë mbledhjen dhe raportimin e të dhënave përkatëse për krimet e lidhura me gjakmarrjen dhe krimet e urrejtjes bazuar në udhëzimet e PP-së të vitit 2019, duke reflektuar rekomandimet e ODIHR;

3.2.8 Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Përgjithshme sigurojnë informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi rastet e sulmeve ndaj gazetarëve.

Treguesit kryesorë:

- Numri mesatar i çështjeve për prokuror.

Objektivi Specifik 3.3: Përmirësimi i kapacitetit të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit me qëllim sigurimin e hetimeve dhe procedimeve penale efikase në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

SPAK ka identifikuar nevojën për plotësimin e vakancave në pozicionet e oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës brenda Byrosë Kombëtare të Hetimit. Institucioni ka shprehur synimin për të krijuar struktura më efikase dhe të mirëpajisura, të cilat do të përfshijnë njësi të analizës së riskut, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe operacioneve. Për të arritur këto objektiva, theksi vihet në rekrutimin e personelit me kapacitete të larta profesionale dhe eksperiencë të duhur, duke siguruar kështu një staf cilësor dhe të plotësuar. Këto përmirësime synojnë të rrisin efektivitetin e operacioneve dhe të forcojnë kapacitetet hetimore të SPAK-ut.

Në këtë kontekst, ky objektivi specifik lidhet me përmirësimin e kapacitetit të Prokurorisë Speciale Antikorrupsion dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit për të siguruar hetime dhe procedime penale efikase, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet

zhvillimit të një strategjie për shpërndarjen e barabartë të ngarkesës për prokurorët dhe organet e policisë gjyqësore, duke siguruar burimet njerëzore dhe buxhetore të nevojshme për zbatimin e saj. SPAK-u do të rritet specializimi për hetime proaktive, përfshirë ato financiare, dhe do të sigurohet zbatimi efikas i vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Këto masa janë të destinuara të rrisin kapacitetin dhe efikasitetin e institucioneve në luftën kundër korrupsionit.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030 sistemi gjyqësor do të forcojë efektivitetin e trajtimit të sekuestrimeve dhe konfiskimeve në proceset penale lidhur me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke rritur progresivisht numrin e tyre.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 3.3 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së, “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor”, të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 3.3 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

3.3.1 SPAK-u harton dhe miraton një strategji efikasiteti për shpërndarje të barabartë të ngarkesës për prokurorët dhe OPGJ-në.

3.3.2. Sigurimi i burimeve njerëzore dhe buxhetit të duhur për zbatimin praktik të strategjisë së efikasitetit për shpërndarjen e ngarkesës së punës në SPAK (Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit).

3.3.3 Përmirësimi i funksionimit të SPAK-ut dhe specializimi i brendshëm institucional për të kryer hetime proaktive (përfshirë hetime financiare) gjatë ndjekjes penale të korrupsionit.

3.3.4 Sigurohet zbatimi në kohë dhe efikas i vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Treguesit kryesorë:

- Përqindja e konfiskimeve në raport me kërkesat për sekuestrim në procesin penal lidhur me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Objektivi specifik 3.4: Përkrahja/promovimi dhe rritja e përdorimit të mekanizmave të zgjidhjes alternative me mosmarrëveshje.

Zbatimi i sistemeve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përballet me disa sfida, duke përfshirë nevojën për rritjen e kapaciteteve të DHKN, shtimin e numrit të rasteve të zgjidhura në mënyrë alternative, gjetjen e mekanizmave për të bërë ndërmjetësimin më të aksesueshëm dhe aplikimin e praktikave më të mira evropiane.

Në këtë kontekst ky objektivi specifik synon të përmirësojë përdorimin e mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve duke forcuar dhe promovuar ndërmjetësimin si një alternativë efektive për zgjidhjen e konflikteve.

Për të arritur këtë, do të përforcohet sistemi i ndërmjetësimit përmes ofrimit të trajnimeve për kandidatët dhe ndërmjetësit e akredituar, si dhe kryerjes së fushatave ndërgjegjësuese që synojnë rritjen e numrit të ndërmjetësve. Do të rritet transparenca në procedurat e licencimit për të nxitur rritjen e numrit të ndërmjetësuesve, si dhe do të duhet të informojnë palët për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim sipas parashikimeve ligjore.

Ky proces do të monitorohet dhe vlerësohet nga institucione përkatëse si KLGJ-ja dhe ILD-ja, për të siguruar që standardet dhe praktikat e duhura të respektohen, duke shërbyer dhe në lehtësimin e ngarkesës së gjykatave dhe reduktimin e kostove.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030, krahasuar me vitin 2024, 30% më shumë e çështjeve të referuara nga gjykatat, do të zgjidhen me ndërmjetësim, duke forcuar kështu efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të ndërmjetësimit në trajtimin e çështjeve gjyqësore.

- Deri në fund të vitit 2030, krahasuar me vitin 2024, do të zgjidhen me ndërmjetësim 30% më shumë e çështjeve të filluara me ndërmjetësim.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 3.4 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së, “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor”, të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 3.4 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

3.4.1 Dhoma e Ndërmjetësve vazhdon të forcojë sistemin e ndërmjetësimit duke ofruar trajnime fillestare dhe të vazhduara për kandidatët ndërmjetës dhe ndërmjetësit e akredituar; duke kryer fushata ndërgjegjësuese për ndërmjetësimin dhe rritur numrin e ndërmjetësve;

3.4.2 Forcimi i transparencës së procedurave të licencimit me synim rritjen e numrit të ndërmjetësve;

3.4.3 Detyrimi ligjor i gjykatave për të informuar, siç duhet palët për mundësinë e përdorimit të ndërmjetësimit vlerësohet nga KLGJ-ja në vlerësimin e performancës;

3.4.4 Detyrimi ligjor i gjykatave për të informuar, siç duhet palët për mundësinë e përdorimit të ndërmjetësimit vlerësohet nga ILD-ja në kuadër të inspektimeve tematike.

Treguesit kryesorë:

- Raporti midis çështjeve të zgjidhura me ndërmjetësim të referuara nga gjykatat dhe numrit total të çështjeve të referuara për ndërmjetësim nga gjykatat (%);

- Raporti midis çështjeve të zgjidhura me ndërmjetësim dhe numrit total të çështjeve të filluara me ndërmjetësim (%).

Objektivi specifik 3.5: Rritja e efikasitetit në gjykata dhe prokurori me anë të mjeteve të teknologjisë të informacionit dhe komunikimit.

Për të përmirësuar efikasitetin e sistemit të drejtësisë është rekomanduar që të rritet përdorimi i sistemeve të sigurta dhe të unifikuara të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në të gjitha nivelet e gjykatave dhe prokurorive. Po ashtu, është kërkuar përmirësimi në mbledhjen, publikimin dhe raportimin e të dhënave statistikore gjyqësore. Synimi është që të gjitha institucionet e drejtësisë të demonstrojnë zotësi, udhëheqje dhe koordinim të ngushtë në këtë proces, për të krijuar një sistem efikas dhe të integruar që përmirëson menaxhimin e çështjeve dhe ndihmon në optimizimin e komunikimit dhe bashkëpunimit në sistemin e drejtësisë.

Ndaj për këtë qëllim objektivi 3.5 synon rritjen e efikasitetit në sistemin e drejtësisë duke integruar teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në funksionimin e gjykatave dhe prokurorive ku do të ndërmerren disa masa kryesore. Do të forcohen kapacitetet e Prokurorisë Speciale përmes përdorimit të avancuar të teknologjisë së informacionit dhe do të dizajnohet Sistemi për Menaxhimin e Integruar të Çështjeve (ICMS), që përfshin një hartë të detajuar të proceseve dhe funksionaliteteve. Infrastrukturat teknologjike në gjykata dhe prokurori do të përmirësohen për të mbështetur implementimin dhe funksionimin e sistemeve të reja. Do të ngrihet dhe mirëmbahet një sistem për menaxhimin e çështjeve në përputhje me standardet teknologjike dhe legislative. Plani strategjik për zbatimin e teknologjisë do të përfshijë ndërveprimin e sistemeve dhe do të miratohet nga Bordi i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit. Do të sigurohen burimet e nevojshme njerëzore dhe mbështetje buxhetore për krijimin dhe mbështetje të sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe do të ofrohen trajnime për përdorimin e tij.

Për të përmirësuar statistikën e sistemit të drejtësisë do të implementohen udhëzimet e ministrit të Drejtësisë bazuar në metodologjinë e CEPEJ-it. Këto masa do të kontribuojnë në ndërtimin e një sistemi të drejtësisë më efikas, të integruar dhe transparent, për të përmirësuar qasjen në drejtësi dhe për të modernizuar infrastrukturën e drejtësisë.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2027 ka përfunduar zhvillimi i softere-it për sistemin e ri të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore (ICMS), dhe deri në fund të vitit 2029 garantohet implementimi i plotë me të gjitha funksionalitetet e ICMS.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 3.5 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 3.5 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

3.5.1 Forcimi i efikasitetit të SPAK-ut nëpërmjet përdorimit të mjeteve të Teknologjisë së Informacionit;

3.5.2 Dizënjimi i Sistemit për Menaxhimin e Integruar të Çështjeve (ICMS), duke përfshirë hartëzimin e të gjitha proceseve, detajet e funksionaliteteve nga Bordi i Qendrës së QTT-së;

3.5.3 Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në gjykata dhe prokurori;

3.5.4 Ngritja e sistemit të menaxhimit të çështjeve të prokurorisë me standardet aktuale teknologjike e legjislative dhe mirëmbajtja e *software*-t të sistemit;

3.5.5 Mirëmbajtja e sistemeve të menaxhimit të çështjeve;

3.5.6 Miratimi nga Bordi i Qendrës së TI-së i planit strategjik për zbatimin e sistemit të teknologjisë së informacionit duke përfshirë ndërveprueshmërinë në sistemin e drejtësisë, në lidhje me prokurorinë, gjykatat dhe institucionet e tjera të drejtësisë;

3.5.7 Garantimi i burimeve e duhura njerëzore dhe mbështetjes buxhetore për krijimin e një Sistemi të Menaxhimit të Çështjeve (ICMS), i cili garanton dhe siguron ndërlidhje me bazat e të dhënave dhe sistemet përkatëse dhe ndërveprimet bazuar në parashikimet vjetore;

3.5.8 Qendra e TI-së siguron koordinimin e duhur në zbatimin e sistemeve të menaxhimit të çështjeve duke siguruar ndërveprueshmëri;

3.5.9 Qendra e TI-së është e pajisur me burimet e nevojshme njerëzore dhe ka kompetencat e duhura me qëllim funksionimin në mënyrë efektive;

3.5.10 Ofrimi i trajnimeve për funksionet dhe përdorimin e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve;

3.5.11 Zhvillimi i kapaciteteve Teknologjisë së Informacionit të GJK dhe mundësimi i aksesit në praktikën gjyqësore;

3.5.12 Përmirësimi i statistikave kombëtare të drejtësisë nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të Udhëzimit të Ministrit për statistikave kombëtare të drejtësisë, bazuar në metodologjinë e CEPEJ në konsultim me institucionet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Treguesit kryesorë:

- Shkalla e implementimit të sistemit të menaxhimit të integruar të çështjeve (ICMS).

Objektivi specifik 3.6: Përmirësimi i kapaciteteve të MD-së dhe institucioneve të varësisë për të përforcuar aksesin në drejtësi.

Institucionet që janë nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë, pavarësisht përparimeve të bëra në drejtëm të përmirësimit të infrastrukturës, vazhdojnë të përballen me disa sfida. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit Shtetëror paraqesin nevojat për zgjerimin e hapësirave dhe përmirësimin e standardeve të godinave të degëve lokale. Përmirësimi dhe kështu nevojave do të kontribuonte në përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga këto institucione.

Një sfidë e vazhdueshme mbetet bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e drejtësisë penale, veçanërisht ndërmjet prokurorive dhe institucionit të Shërbimit të Provës, për të siguruar respektimin e afateve ligjore për ekzekutimin e vendimeve me shërbim prove. Vonesat në

ekzekutimin e vendimeve me shërbim prove ndikojnë negativisht në zbatimin e dënimit alternativ, reduktojnë efektin individual të tij dhe dëmtojnë besimin në sistemin e drejtësisë.

Rrjedhimisht, objektivi specifik 3.6 synon përmirësimin e kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të varësisë për të forcuar aksesin në drejtësi. Ky objektivi përfshin disa masa kyçe të cilat janë konsolidimi i masterplanit të burgjeve për rinovimin e infrastrukturës dhe rritjen e kapaciteteve akomoduese; miratimi i planit të integritetit për të adresuar risqet e integritetit në sistemin penitenciar; dhe miratimi i rregullave të brendshme për institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, për të përmbushur rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe CPT-së.

Gjithashtu, synohet ngritja e kapaciteteve për të zbatuar rekomandimet e CPT-së dhe optimizimi i ndërhyrjeve përmes instrumenteve psikoedukative dhe mbështetje psikosociale.

Në këtë kuadër, do të sigurohen burimet e nevojshme për ndërtimin/rikonstruksionin e institucioneve për ekzekutimin e vendimeve penale. Do të rritet efikasiteti i IEVP-ve dhe Shërbimit të Provës, si dhe kapacitetet e DNJF-së. Rishikimi i akteve nënligjore (paketës rregullatore) dhe rritja e aksesit në ndihmën juridike falas, si dhe përmirësimi i efektivitetit të Shërbimit të Noterisë dhe Shërbimit të Përmbartimit përmes kapaciteteve dhe digjitalizimit janë gjithashtu pjesë e këtij objekti specifik, zbrërthyer me tej me masa konkrete.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij objekti specifik synohet rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e drejtësisë penale, veçanërisht bashkëpunimi midis prokurorive dhe shërbimit të provës, për të mundësuar respektimin e afateve ligjore për ekzekutimin e vendimeve me shërbim prove. Vonesa në ekzekutimin e shërbimit të provës ndikon në zbatimin e duhur të shërbimit të provës si dënim alternativ, efektin individual të këtij ndëshkimi, si dhe cenon besimin në sistemin e drejtësisë.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030 pritet të ketë rritje progresive të numrit të të burgosurve të përfshirë në aktivitetet rehabilituese kundrejt numrit total të personave që vuajnë dënimin, duke forcuar kështu rehabilitimin e tyre dhe integrimin e mëvonshëm në shoqëri;

- Deri në fund të vitit 2030 do të ketë përmirësim progresiv të situatës së mbipopullimit në burgje si rrjedhojë e adresimit të sfidave në sistemin e drejtësisë dhe politikave efektive të paraburgimit;

- Deri në fund të vitit 2030 do të reduktohet progresivisht kohëzgjatja mesatare e dhënies së ndihmës juridike parësore falas duke garantuar në këtë mënyrë moszvarritjen e procedurave, dhe akses efektiv në drejtësi për qytetarët.

Lidhja e objekti specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 3.6 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 3.6 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

3.6.1 Konsolidimi i Masterplanit të Burgjeve duke përfshirë ndër të tjera masa për rinovimin e infrastrukturës së burgjeve dhe rritjen e kapaciteteve akomoduese për të dënuarit me burgim;

3.6.2 Miratimi i Planit të Integritetit që adreson risqet e integritetit në sistemin penitenciar;

3.6.3 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve miraton rregullat e brendshme për çdo institucion të ekzekutimit të vendimeve penale, duke synuar adresimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Komitetit të Helsinkit dhe CPT-së;

3.6.4 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Ministria e Drejtësisë vazhdojnë të ndërmarrin masa për ngritjen e kapaciteteve për të rritur aftësinë raportuese dhe zbatuese të rekomandimeve të CPT-së;

3.6.5 Optimizimi i ndërhyrjes dhe pasurimi i portofolit të stafit me instrumente psikoedukative dhe terapeutike, këshillim klinik, qasje terapeutike, maksimizimi i mbështetjes psikosociale;

3.6.6 Qeveria siguron burime të përshtatshme për ndërtimin dhe rinovimin e I EVP-ve;

3.6.7 Ngritja dhe funksionimi institucionit për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masën mjekësore në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

3.6.8 Rritja e efektivitetit të I EVP-ve nëpërmjet rekomandimeve të inspektimeve të brendshme dhe të jashtme;

3.6.9 Rritje e efikasitetit të Shërbimit të Provës nëpërmjet përmirësimit të organizimit të punës dhe forcimit të kapaciteteve;

3.6.10 Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore për mirëfunksionimin e DNJF-së;

3.6.11 Rishikimi i paketës rregullatorë, në lidhje me konsolidimin e praktikës për ofrimin e ndihmës ligjore.

3.6.12 Informimi, ndërgjegjësimi dhe rritja e aksesit të subjekteve të ligjit për Ndhmën Juridike Falas mbi të drejtat e tyre dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

3.6.13 Rritja e efektivitetit të Shërbimit të Noterisë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve, llogaridhënies dhe digjitalizimit.

3.6.14 Rritja e efektivitetit të Shërbimit të Përmbarrimit nëpërmjet rritjes së kapaciteteve, llogaridhënies dhe digjitalizimit.

Treguesit kryesorë:

- Përqindja e personave të burgosur të punësuar, që ndjekin kurse profesionale ose që ndjekin arsimin e detyruar, përkundëjt numrit total të personave që vuajnë dënimin;

- Raporti i numrit të shtretërve me numrin e të burgosurve (%);

- Kohëzgjatja mesatare midis kërkesës për ndihmë juridike parësore falas dhe dhënies së ndihmës juridike parësore falas.

Qëllimi politik 4

Forcimi i cilësisë së drejtësisë

Në referim të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, Këshillat duhet të avancojnë në miratimin e akteve nënligjore për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke synuar një balancë më të mirë midis kriterëve cilësorë dhe sasiorë, si dhe rritjen e transparencës së procesit përmes këtyre metodologjive.

Shkolla e Magjistraturës duhet të ndryshojë rregulloren e saj të brendshme për të siguruar që provimi i pranimit të reflektojë standardet më të mira të BE-së dhe që pranimet të bëhen bazuar në njohuri dhe kapacitete. Gjithashtu, Shkolla e Magjistraturës duhet të pasurojë programet e trajnimit vazhdues, duke u fokusuar në nevojat e identifikuara për specializimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. KLGJ-ja duhet të sigurojë publikimin dhe të përmirësojë kërkimin e vendimeve gjyqësore, veçanërisht të GJL-së. GJL-ja duhet të vazhdojë unifikimin e vendimeve të gjykatave dhe për rrjedhojë, të përmirësojë më tej praktikën gjyqësore. Vlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nga KLGJ-ja dhe KLP-ja duhet të përfshijë, ndër të tjera, standardet e arsytimit të vendimeve gjyqësore. Duhet të merren masa për të siguruar që vendimet gjyqësore të jenë të aksesueshme dhe lehtësisht të arritshme për publikun.

Sa më sipër qëllimi politik 4 fokusohet në forcimin e cilësisë së drejtësisë duke siguruar burimet financiare, njerëzore dhe infrastrukturore të nevojshme për funksionimin efektiv të sistemit të drejtësisë.

Kjo përfshin përmirësimin e performancës së magjistratëve në gjykata dhe prokurori, forcimin e kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës për të përmirësuar trajnimin dhe kurrikulat e trajnimit gjyqësor, dhe sigurimin e aksesit të publikut në vendimet e gjykatave. Qëllimi është, gjithashtu, që të garantohet qëndrueshmëria e praktikave gjyqësore dhe të përmirësohet cilësia e arsytimit të vendimeve, duke kontribuar kështu në rritjen e besueshmërisë dhe transparencës në sistemin e drejtësisë.

Për arritjen e këtij qëllimi politik, institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me institucionet e tjera, partnerë vendës dhe ndërkombëtarë do të fokusohen në përmbushjen e katër objektivave specifike:

Objektivi Specifik 4.1: Sigurimi i burimeve financiare, njerëzore dhe infrastrukturore për mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë.

Objektivi Specifik 4.2: Përforcimi i performancës së magjistratve në gjykata dhe prokurori

Objektivi Specifik 4.3: Forcimi i kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës me qëllim përmirësimin e trajnimit gjyqësor dhe kurrikulave të trajnimit.

Objektivi Specifik 4.4: Sigurimi i aksesit në vendimet e gjykatave dhe qëndrueshmërisë së praktikave gjyqësore me qëllim përmirësimin e cilësisë së arsyetimit të vendimeve dhe rritjes së transparencës për publikun.

Lidhja midis qëllimit politik 4 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi politik 3 lidhet me objektivin 16 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), “Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”. SND 2024–2030, lidhet me nënobjektivin 16.3, “Promovimi i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë”. Gjithashtu, SND 2024–2030, lidhet me nënobjektivin 16.6, “Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet”, me nënobjektivin 16.7, “Sigurimi i vendimmarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet” si dhe me nënobjektivin 16.10, “Sigurimi i aksesit të publikut në informacion dhe mbrojtja e lirive themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare”.

Objektivi specifik 4.1: Sigurimi i burimeve financiare, njerëzore dhe infrastrukturore për mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë.

Pavarësisht arritjeve të rëndësishme, avancimi i Reformës në Drejtësi kërkon vëmendje të shtuar ndaj përgjegjësive që burojnë për institucionet e përfshira. Këto institucione duhet të përmirësojnë vazhdimisht shërbimet e tyre sipas standardeve evropiane, si dhe të përmirësojnë infrastrukturën e sektorit, duke krijuar një bazë të dhënash elektronike për gjyqësorin. Ka pasur përparime në plotësimin e vakancave dhe forcimin e kapaciteteve infrastrukturore në Gjykatën Kushtetuese, çka konsiderohet një parakusht për funksionimin e plotë të kësaj Gjykate.

Gjithashtu, po vijon me sukses implementimi i hartës së re gjyqësore, duke përfshirë ngritjen e 13 gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit me juridiksion të përgjithshëm. Megjithatë, infrastruktura e nevojshme për zbatimin e kësaj harte nuk është ende e siguruar, pasi ka probleme me miratimin e shesheve të ndërtimit nga ana e bashkive për godinat e reja të gjykatave. Mungesa e një studimi të mirëfilltë të fizibilitetit mbetet një shqetësim potencial në sigurimin e infrastrukturës ndërtimore.

Ndaj ky objektivi specifik synon sigurimin e burimeve financiare, njerëzore dhe infrastrukturore të nevojshme për funksionimin e efektshëm të sistemit të drejtësisë. Është e nevojshme që të sigurohet vazhdimësia e alokimit të duhur të burimeve financiare për institucionet e drejtësisë nga Qeveria dhe Kuvendi.

Në këtë kontekst janë parashikuar masa konkrete për përmirësimin e infrastruktura gjyqësore, duke përfshirë krijimin e ambienteve të përshtatshme për gjykatën e apelit dhe plotësimi i vendeve vakante për magjistratë përmes emërimeve nga Këshillat dhe Gjykata Kushtetuese, për të siguruar që institucionet e drejtësisë të jenë të pajisura me burimet dhe infrastrukturën e nevojshme për të funksionuar në mënyrë efikase.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030 garantohet përputhshmëri sa më e plotë midis buxhetit të kërkuar nga institucionet dhe atij të miratuar nga Kuvendi, me qëllim sigurimin e burimeve financiare, njerëzore dhe infrastrukturore të mjaftueshme për mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 4.1 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 4.1 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

4.1.1 Qeveria/Kuvendi siguron vazhdimësi të nivelit të duhur të alokimit të burimeve për institucionet e sistemit të drejtësisë.

4.1.2 Përmirësimi gradual i infrastrukturës gjyqësore, duke përfshirë ambiente të përshtatshme për Gjykatën e Apelit.

4.1.3 Plotësimi i vendeve vakante për magistratë nga Këshillat dhe për këshilltar ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese.

Treguesit kryesorë:

- Raporti (%) midis buxhetit të miratuar dhe buxhetit të kërkuar nga institucioni (për shpenzime kapitale dhe korrente).

Objektivi specifik 4.2: Përforcimi i performancës së magistratëve në gjykata dhe prokurori.

Objektivi specifik 4.2 ka për qëllim përmirësimin e performancës së magistratëve në gjykata dhe prokurori duke siguruar miratimin e akteve nënligjore për vlerësimin e performancës dhe duke rishikuar metodologjinë e vlerësimit për të arritur një balancë më të mirë ndërmjet kriterëve cilësore dhe sasiorë. Ky objektivi, gjithashtu, përfshin miratimin e rregullave të brendshme për cilësinë e drejtësisë dhe zbatimin e rekomandimeve nga inspektimet tematike të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për të përmirësuar performancën e magistratëve në gjykata dhe prokurori, synohet miratimi i akteve të reja për vlerësimin e performancës dhe rishikimi i metodologjisë për të arritur një balancë më të mirë ndërmjet kriterëve cilësore dhe sasiorë, si dhe rritja e transparencës së procesit.

Objektivi është i zburthyer në masa të cilat parashikojnë përmirësimin e performancës përmes miratimit të rregullave të brendshme për cilësinë e drejtësisë, zbatimin të rekomandimeve nga inspektimet e rregullta dhe anketave që synojnë përmirësimin e kënaqësisë së përdoruesve të gjykatave.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030 ka rritje progresive të përmbushjes së pritshmërive të përdoruesve të gjykatave në lidhje me funksionimin e gjykatave dhe prokurorive, aksesin në drejtësi dhe besimin në institucione, i evidentuar nga anketime periodike.

Lidhja e objektivit specifik me nënkaptullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 4.2 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 4.2 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

4.2.1 Këshillat përparojnë me miratimin e akteve nënligjore të mbetura për vlerësimin e performancës;

4.2.2 Këshillat rishikojnë metodologjinë e tyre për vlerësimin e performancës për të arritur një balancë më të madhe ndërmjet kriterëve cilësore dhe sasiorë, si dhe rritje të transparencës së procesit dhe zbatim të metodologjisë;

4.2.3 Monitorimi dhe vlerësimi periodik i akteve nënligjore që lidhen me cilësinë e punës dhe rishikimi i tyre sipas nevojës;

4.2.4 Përmirësimi i performancës së magistratëve bazuar në rekomandimet e inspektimeve tematike dhe institucionale të kryera nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë;

4.2.5 Performanca e gjykatave përmirësohet nëpërmjet anketave të përmbushjes së pritshmërive të përdoruesve të gjykatave të kryera nga KLGJ-ja/gjykatat.

Treguesit kryesorë:

- Niveli i përmbushjes së pritshmërive të përdoruesve të gjykatave në lidhje me funksionimin e gjykatave/prokurorive, aksesin në drejtësi dhe besimin në institucione.

Objektivi specifik 4.3: Forcimi i kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës me qëllim përmirësimin e trajnimit gjyqësor dhe kurrikulave të trajnimit.

Ky objektivi specifik synon forcimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës (SHM) për të avancuar trajnimin dhe zhvillimin e profesionistëve të sistemit të drejtësisë. Për të arritur këtë, SHM-ja do të angazhohet në një proces të thelluar rishikimi dhe përditësimi të rregulloreve dhe kurrikulave të saj, me qëllim që të përmbushë standardet më të larta ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian.

Një nga masat kyçe do të jetë rishikimi i Rregullores së Brendshme për të siguruar që provimi i pranimit të pasqyrojë aftësi dhe kompetenca të nevojshme, dhe jo thjesht njohuri teorike mbi ligjin. Ky proces do të përfshijë gjithashtu sigurimin e stafit dhe burimeve të përshtatshme, në përputhje me analizat dhe parashikimet për nevojat akademike dhe njerëzore, për të garantuar mbështetje të mjaftueshme për trajnimin e magistratëve.

Në këtë drejtim, SHM-ja do të forcojë programin e saj dhe do të përmirësojë mentorët, duke rishikuar dhe miratuar kurrikulën e formimit fillestar dhe të vazhduar, e cila do të jetë në përputhje me nevojat e identifikuara dhe do të ndihmojë në specializimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Përveç kësaj, do të kryhet një analizë për të siguruar që metodologjia për vlerësimin e trajnerëve të përputhet me standardet evropiane, duke përgatitur një metodologji të re në përputhje me rezultatet e kësaj analize.

SHM-ja do të angazhohet gjithashtu në aktivitete studimi dhe kërkimi në fusha prioritare të së drejtës, duke prodhuar materiale shkencore dhe informuese që ndihmojnë aktorët e sistemit të drejtësisë. Këto masa synojnë të rrisin cilësinë e trajnimit dhe të kontribuojnë në zhvillimin e një sistemi të drejtësisë më të fortë dhe më efikas.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030 ka rritje progresive të pjesëmarrjes së magistratëve në programet e trajnimit të vazhdueshëm pranë Shkollës së Magjistraturës, që evidenton përmirësimin e trajnimit gjyqësor dhe kurrikulave të trajnimit si edhe rritjen e profesionalizmit të magistratëve;

- Deri në fund të vitit 2030 ka rritje të interesit dhe përgatitjes së kandidatëve për të hyrë në Shkollën e Magjistraturës, evidentuar me rritjen progresive të raportit midis numrit të konkurrentëve që kanë marrë pjesë në provim në krahasim me kuotën e përcaktuar nga shkolla;

- Deri në fund të vitit 2030 është përforcuar angazhimi i rregullt i magistratëve në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe efektiviteti i programeve të trajnimit, të evidentuar me rritjen e numrit të përgjigjeve ndaj ftesave që u drejtohen atyre që kanë shprehur interes për trajnim.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 4.3 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 4.3 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

4.3.1 SHM-ja rishikon Rregulloren e saj të Brendshme duke siguruar që provimi i pranimit është në përputhje me standardet më të mira të BE-së dhe shkollave homologe të trajnimit gjyqësor dhe siguron që konkurrentët të vlerësohen mbi bazën e aftësisë dhe jo vetëm mbi bazën e njohurive mbi ligjin;

4.3.2 SHM-ja siguron staf dhe burime të përshtatshme në bazë të analizave, rishikimit dhe parashikimit të nevojave për burime njerëzore dhe akademike;

4.3.3 Përforsimi i programit dhe përmirësimi i mentorëve nga SHM-ja/gjykatat;

4.3.4 Rishikimi i kurrikulës së formimit fillestar, miratimi dhe zbatimi i saj gjatë vitit akademik;

4.3.5 Përmirësimi dhe pasurimi i programit të formimit të vazhduar që u përgjigjet nevojave të identifikuar për specializimin e magistratëve në detyrë;

4.3.6 Kryerja e analizës së përputhshmërisë së metodologjisë për vlerësimin e trajnerëve sipas standardeve evropiane;

4.3.7 Përgatitja e metodologjisë së re për vlerësimin e trajnerëve bazuar në rezultatet e analizës së përputhshmërisë;

4.3.8 Shkolla e Magistraturës angazhohet në veprimtari studimore dhe hulumtuese në fushat prioritare të së drejtës dhe harton produkte shkencore dhe informuese në funksion të institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Treguesit kryesorë:

- Përqindja e gjyqtarëve dhe prokurorëve që kanë marrë pjesë në të paktën 3 ditë trajnimi në vit;

- Raporti i konkurrentëve që kanë marrë pjesë në provimin e pranimit në Shkollën e Magistraturës me kuotën e përcaktuar nga SHM-ja;

- Përqindja e magistratëve që ndjekin rregullisht trajnimet për të cilat janë përzgjedhur nga Shkolla e Magistraturës.

Objektivi specifik 4.4: Sigurimi i aksesit në vendimet e gjykatave dhe qëndrueshmërisë së praktikave gjyqësore me qëllim përmirësimin e cilësisë së arsytimit të vendimeve dhe rritjes së transparencës për publikun.

Ky objektivi specifik 4.4 synon përmirësimin e cilësisë së arsytimit të vendimeve gjyqësore dhe rritjen e transparencës në sistemin e drejtësisë, nëpërmjet publikimit dhe kërkueshmërisë së vendimeve gjyqësore, ofrimit të trajnimeve për analiza të çështjeve gjyqësore, unifikimin e praktikës gjyqësore, vlerësimin e standardeve të arsytimit të vendimeve nga gjyqtarët dhe prokurorët, si dhe sigurimin e monitorimit dhe vlerësimin transparent të aktiviteteve të gjykatave.

Gjykata Kushtetuese do të përmirësojë aksesimin në vendimet duke e bërë praktikën e saj gjyqësore më të qasshme dhe transparente. Po ashtu, KLGJ-ja do të sigurojë publikimin e vendimeve dhe do të përmirësojë kërkueshmërinë e tyre, me fokus të veçantë në vendimet e Gjykatës së Lartë, për të lehtësuar analizën dhe kontrollin e praktikave gjyqësore.

Një tjetër masë do të jetë ofrimi i trajnimeve për hulumtimin dhe analizën e çështjeve gjyqësore nga SHM-ja, për të ngritur nivelin profesional dhe për të përmirësuar standardet e praktikës gjyqësore. GJL-ja do të vazhdojë të unifikojë vendimet e gjykatave, duke kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të praktikës gjyqësore.

Vlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nga KLGJ-ja dhe KLP-ja do të përfshijë standardet e arsytimit të vendimeve, për të siguruar që vendimet të jenë të bazuara në norma të larta profesionale dhe ligjore. Në përputhje me këtë, do të sigurohet një monitorim dhe vlerësim transparent i aktiviteteve të gjykatës për të garantuar llogaridhënie dhe besueshmëri në sistemin gjyqësor.

Këto masa synojnë të rrisin cilësinë dhe qëndrueshmërinë e vendimeve gjyqësore, duke ndihmuar në forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030, 100% e arkivave të gjykatave janë digitalizuar, për të garantuar modernizimin e sistemit gjyqësor, për të lehtësuar aksesin në dokumente dhe për të përmirësuar eficiencën në menaxhimin e çështjeve.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së, sipas MSA-së

Objektivi specifik 4.4 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor” të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 4.4 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

4.4.1 Gjykata Kushtetuese përmirëson aksesin në praktikën e saj gjyqësore;

4.4.2 KLGJ-ja siguron publikimin dhe përmirëson kërkueshmërinë e vendimeve gjyqësore, veçanërisht të Gjykatës së Lartë;

4.4.3 SHM-ja ofron trajnime për hulumtimin dhe analizën e çështjeve gjyqësore;

4.4.4 GJL-ja vazhdon të unifikojë vendimet e gjykatave dhe si rrjedhojë praktika gjyqësore përmirësohet më tej;

4.4.5 Vlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nga KLGJ-ja dhe KLP-ja, përfshin, ndër të tjera, standardet e arsytimit të vendimeve gjyqësore;

4.4.6 Sigurohet monitorim dhe vlerësim transparent i aktiviteteve të gjykatës.

Treguesit kryesorë:

- Përfundimi i digjitalizimit të arkivave në gjykata.

Qëllimi politik 5: Drejtësi më e afërt me qytetarët

Qëllimi 5 i politikës “**Drejtësi më e afërt me qytetarët**” synon të krijojë një sistem drejtësie më të qasshëm, transparent dhe të orientuar drejt nevojave të qytetarëve. Ky qëllim fokusohet në përmirësimin e marrëdhënieve midis qytetarëve dhe sistemit të drejtësisë, duke u siguruar që qytetarët të kenë një kuptim më të mirë të proceseve gjyqësore dhe të kenë mundësi më të lehta për të aksesuar shërbimet e drejtësisë.

Në thelb, ky qëllim synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për sistemin dhe institucionet e drejtësisë, duke bërë që qytetarët të ndihen më të informuar dhe më të fuqizuar për të kërkuar drejtësi. Kjo përfshin fushata të informimit dhe ndërgjegjësimit publik, përmirësimin e komunikimit të institucioneve gjyqësore me qytetarët, dhe krijimin e mekanizmave që lehtësojnë aksesin në drejtësi, veçanërisht për grupet më të cenueshme të shoqërisë.

Përmes këtij qëllimi, synohet gjithashtu të rritet besimi i qytetarëve në sistemin e drejtësisë, duke e bërë atë më të përgjegjshëm dhe më të orientuar drejt shërbimit të interesave të publikut. Kjo do të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të eficiencës dhe efektivitetit të sistemit të drejtësisë, duke e bërë atë më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë qytetarët.

Në kontekstin e zbatimit të politikës 5 është thelbësore të merren parasysh sfidat dhe rekomandimet e përfshira në analizën e situatës aktuale dhe vlerësimin mbi edukimin ligjor të publikut në Shqipëri. Kjo analizë tregon se edukimi ligjor ka fituar një rëndësi të jashtëzakonshme në forcimin e shtetit të së drejtës dhe krijimin e një shoqërie të drejtë dhe të informuar. Megjithatë, ka ende shumë sfida që duhen adresuar për të siguruar që ky proces të jetë i suksesshëm dhe të ketë ndikim të qëndrueshëm.

Një nga sfidat kryesore të evidentuara është mungesa e koordinimit dhe institucionalizimit në ofrimin e edukimit ligjor për publikun. Deri më tani, edukimi ligjor në Shqipëri është realizuar kryesisht nga organizata jofitimprurëse dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, por pa një qasje të mirëkoordinuar dhe të institucionalizuar. Kjo ka çuar në një situatë ku masat e edukimit ligjor janë të fragmentuara dhe shpesh të paqëndrueshme. Për zbatimin e qëllimit politik 5, është thelbësore që të sigurohet një bashkëpunim efektiv midis institucioneve të drejtësisë, qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile për të krijuar një strukturë të qëndrueshme dhe të koordinuar për edukimin ligjor.

Një tjetër sfidë e rëndësishme është mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore. Institucionet përballen me kufizime të mëdha financiare dhe me mungesë të personelit të trajnuar për të realizuar

aktivitetet e edukimit ligjor. Kjo ka ndikuar në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e programeve të edukimit ligjor, duke i bërë ato të varura nga financime të përkohshme dhe të pamjaftueshme. Në këtë kontekst, zbatimi i politikës 5 kërkon një investim të qëndrueshëm në burime financiare dhe në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, për të siguruar që aktivitetet e planifikuara të realizohen me sukses dhe të kenë një ndikim afatgjatë.

Për më tepër, korniza ligjore e paqartë ka qenë një pengesë për edukimin ligjor në Shqipëri. Ligjet ekzistuese shpesh përmendin institucionet përgjegjëse për edukimin ligjor, por nuk specifikojnë detyrime të qarta për to. Kjo ka rezultuar në përgjegjësi të papërcaktuara qartë dhe në mungesë të mekanizmave të qarta zbatimi. Për zbatimin e politikës 5, është e nevojshme të krijohet një kornizë ligjore më e qartë dhe e detajuar që përcakton rolet dhe përgjegjësitë e secilit institucion në ofrimin e edukimit ligjor dhe në përmirësimin e aksesit në drejtësi.

Megjithatë, pavarësisht këtyre sfidave, edukimi ligjor dhe përpjekjet për të afruar drejtësinë me qytetarët kanë përfitime të mëdha dhe afatgjata. Siç përmendet edhe në analizën e situatës aktuale, një shoqëri e informuar ligjërisht është një shtyllë e rëndësishme për një shtet të fortë të së drejtës. Kur qytetarët janë të informuar mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, ata janë më të aftë për të kërkuar llogaridhënie nga institucionet publike dhe për të luftuar kundër korrupsionit dhe abuzimit të pushtetit. Kjo do të kontribuojë në krijimin e një sistemi drejtësie më të besueshëm dhe më të qëndrueshëm.

Për arritjen e këtij qëllimi politik, institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me institucione partnerë vendës dhe ndërkombëtarë do të fokusohen në përmbushjen e tre objektivave specifike si OS.5.1, OS. 5.2, OS. 5.3.

- **Objektivi specifik 5.1:** Informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi sistemin e drejtësisë përmes përdorimit të mjeteve dhe metodave inovative të komunikimit.

- **Objektivi specifik 5.2:** Forcimi i bashkëpunimit efektiv të institucioneve të sistemit të drejtësisë për realizimin e ELP dhe rritja e aksesit të qytetarëve në informacionin mbi kuadrin ligjor dhe sistemin e drejtësisë.

- **Objektivi specifik 5.3:** Rritja e njohurive dhe kuptueshmërisë së publikut mbi proceset e integritimit evropian përmes iniciativave të edukimit ligjor të publikut.

Lidhja midis qëllimit politik 5 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi politik 5 lidhet me objektivin 16 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ, “Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”. SND 2024–2030, lidhet me nënobjektivin 16.3, “Promovimi i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë”. Gjithashtu, SND 2024–2030, lidhet me nënobjektivin 16.6, “Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet”, me nënobjektivin 16.7, “Sigurimi i vendimarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet” si dhe me nënobjektivin 16.10, “Sigurimi i aksesit të publikut në informacion dhe mbrojtja e lirive themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare”.

Objektivi specifik 5.1: Informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi sistemin e drejtësisë përmes përdorimit të mjeteve dhe metodave inovative të komunikimit.

Objektivi specifik 5.1 fokusohet në informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi sistemin e drejtësisë dhe synon të krijojë një komunikim më efektiv dhe të qasshëm midis institucioneve gjyqësore dhe qytetarëve. Kjo realizohet përmes përdorimit të mjeteve dhe metodave inovative të komunikimit, që synojnë të thjeshtësojnë informacionin dhe ta bëjnë atë të kuptueshëm për të gjithë shtresat e shoqërisë.

Sipas vlerësimit të situatës aktuale mbi edukimin ligjor të publikut në Shqipëri, deri në fund të 2023 disa hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë për të realizuar informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi sistemin e drejtësisë përmes përdorimit të mjeteve dhe metodave inovative të komunikimit. Këto masa janë bazuar kryesisht në parashikimet e Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019–2023. Në zbatim të planit të veprimit të hartuar në kuadër të

kësaj strategjie gjatë periudhës 2019–2023 janë hartuar dhe publikuar materiale informuese në gjuhë të thjeshtë për publikun, të cilat synojnë të shpjegojnë funksionimin e institucioneve të drejtësisë, procedurat që duhet ndjekur, dhe të drejtat e qytetarëve. Këto materiale janë shpërndarë kryesisht përmes faqeve zyrtare të institucioneve dhe mediave sociale, si një përpjekje për të siguruar që qytetarët të kenë akses në informacion të saktë dhe të kuptueshëm.

Gjithashtu, institucionet gjyqësore kanë nisur të krijojnë dhe përditësojnë llogari në platforma të ndryshme të mediave sociale, si Facebook dhe LinkedIn, për të ofruar një burim të besueshëm dhe të përditësuar informacioni për publikun. Këto platforma përdoren për të shpërndarë lajme dhe informacione të rëndësishme rreth aktiviteteve dhe vendimeve të institucioneve gjyqësore.

Në të njëjtën kohë janë realizuar disa përpjekje për të promovuar reformat në sistemin e drejtësisë përmes intervistave në media dhe fushatave mediatike. Institucionet kanë zhvilluar intervista televizive dhe janë angazhuar me median për të shpjeguar ndryshimet në hartën gjyqësore dhe përfitimet që sjellin reformat e fundit në drejtësi. Gjithashtu, krijimi i videove shpjeguese nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dhe Ministria e Drejtësisë për të ndihmuar qytetarët të kuptojnë më mirë se si mund të aksesojnë institucionet e drejtësisë është një tjetër hap i rëndësishëm i realizuar deri më tani. Këto video janë krijuar me qëllim që të ofrojnë udhëzime të qarta dhe të thjeshta për qytetarët lidhur me procedurat që duhet ndjekur dhe të drejtat e tyre procedurale.

Institucionet e sistemit të Drejtësisë kanë zhvilluar disa sesione informuese për publikun, veçanërisht për grupet vulnerabël, për t'i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë të drejtat e tyre dhe të kenë qasje më të lehtë në shërbimet e drejtësisë. Këto sesione janë pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të fuqizuar qytetarët, veçanërisht ata që janë më të prekshëm nga padrejtësitë ligjore.

Megjithatë, siç evidentohet në vlerësimin e situatës mbi zbatimin e edukimit ligjor të publikut, një pjesë e mirë e masave të parashikuara në Strategjinë e Edukimit Ligjor të Publikut nuk u realizuan plotësisht ose kanë hasur pengesa në zbatimin e tyre për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet institucioneve, burimeve financiare të pamjaftueshme dhe kufizimeve në burimet njerëzore.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme që të intensifikohen përpjekjet për të përmbushur masat e parashikuara në kuadër të zbatimit të këtij objekti specifik për të siguruar që Objektivi Specifik 5.1 të realizohet me sukses. Kjo do të kërkojë një angazhim të fortë nga të gjitha institucionet e përfshira dhe një qasje më të mirëkoordinuar dhe të qëndrueshme ndaj edukimit dhe ndërgjegjësimin të publikut për çështjet ligjore.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030 ka rritje progresive të numrit të sesioneve informuese të mbajtura mbi sistemin e drejtësisë nga institucionet e drejtësisë, për të përforcuar informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin publik mbi sistemin e drejtësisë përmes përdorimit të mjeteve dhe metodave inovative të komunikimit.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

- Objektivi specifik 5.1 lidhet me kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së, “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor”, të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 5.1 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

5.1.1 Hartimi dhe publikimi i materialeve informuese në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme lidhur me organizimin, kompetencat dhe funksionimin e gjykatave dhe përditësimi periodik i tyre;

5.1.2 Intervista në media me qëllim informimin mbi ndryshimet/risitë/përfitimet që solli Reforma në Drejtësi dhe promovimi i rezultateve të arritura;

5.1.3 Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut lidhur me sistemin gjyqësor nëpërmjet platformave të mediave sociale;

5.1.4 Hartimi dhe publikimi i informacioneve shpjeguese për qytetarët mbi aksesin në institucionet e drejtësisë dhe publikimi i tyre në faqet zyrtare të institucioneve të drejtësisë;

5.1.5 Hartimi dhe publikimi i buletinit periodik të gjykatave;

5.1.6 Hartimi i materialeve informuese mbi procedurën që ndiqet në çështjet penale, civile dhe ato administrative; mënyrën e paraqitjes së çështjeve, kërkesave/ankesave drejtuar gjykatës; formatet standarde; shërbimet që mund të merren nga gjykatat; e drejta e ankimit/rekursit dhe afatet;

5.1.7 Përditësimi i materialeve informuese mbi procedurën që ndiqet në çështjet penale; mënyrën e paraqitjes së kallëzimeve drejtuar prokurorisë; formatet standarde; shërbimet që mund të merren nga prokuroria; e drejta e ankimit/rekursit dhe afatet;

5.1.8 Informimi i publikut mbi veprimtarinë e prokurorisë së posaçme dhe BKH, aksesin i qytetarëve, llojet e çështjeve që trajtojnë, e drejta e ankimit/rekursit dhe afatet;

5.1.9 Organizimi i aktiviteteve informuese rreth kompetencave të ILD-së, procedurave, afateve, të drejtave të palëve;

5.1.10 Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi mjetet alternative të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim;

5.1.11 Informimi i publikut mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti;

5.1.12 Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese në javën e drejtësisë.

5.1.13 Planifikimi dhe organizimi i takimeve në ditë të veçanta për sistemin e Drejtësisë dhe të drejtave të njeriut (Dita e Drejtësisë, Dita e të Drejtave të Njeriut).

Treguesit kryesorë:

- Numri i sesioneve të informimit mbi sistemin e drejtësisë (çdo vit).

Objektivi Specifik 5.2: Forcimi i bashkëpunimit efektiv të institucioneve të sistemit të drejtësisë për realizimin e ELP dhe rritja e aksesit të qytetarëve në informacionin mbi kuadrin ligjor dhe sistemin e drejtësisë

Objektivi Specifik 5.2 synon forcimin e bashkëpunimit efektiv midis institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe rritjen e aksesit të qytetarëve në informacionin mbi kuadrin ligjor dhe sistemin e drejtësisë. Ky objektivi është thelbësor për krijimin e një sistemi drejtësie që është jo vetëm transparent, por edhe i qasshëm dhe i besueshëm për publikun e gjerë. Analiza e vlerësimit të zbatimit të SELP ka treguar se bashkëpunimi efektiv midis institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe rritja e aksesit të qytetarëve në informacionin mbi kuadrin ligjor dhe sistemin e drejtësisë është përballur me një sërë sfidash që kanë ndikuar në progresin e tij. Një nga sfidat më të mëdha ka qenë mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve. Institucionet shpesh kanë vepruar në mënyrë të pavarur, pa një strategji të përbashkët dhe të koordinuar. Ky fragmentim ka krijuar boshllëqe në përpjekjet për të përmirësuar edukimin ligjor të publikut dhe ka ndikuar në aftësinë e institucioneve për të komunikuar në mënyrë efektive me qytetarët. Si rezultat, qytetarët shpesh hasnin në mungesë informacioni të unifikuar dhe të qartë mbi të drejtat dhe procedurat ligjore. Gjithashtu, mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore për të zbatuar iniciativa që synojnë të përmirësojnë qasjen në drejtësi ka çuar në zbatimin e projekteve të përkohshme dhe të varura nga financime të jashtme, duke bërë që rezultatet të mos jenë të qëndrueshme dhe të plota.

Një sfidë tjetër ka qenë mungesa e një infrastrukture teknologjike të përbashkët dhe të avancuar ndërmjet institucioneve të drejtësisë. Teknologjia është një mjet thelbësor për të përmirësuar qasjen e qytetarëve në informacion ligjor, por mungesa e mjeteve të duhura teknologjike ka kufizuar aftësinë e institucioneve për të ndarë dhe përhapur informacion në mënyrë efikase. Kjo ka krijuar pengesa të konsiderueshme për qytetarët, të cilët kanë nevojë për informacion të azhurnuar dhe të saktë për të drejtat dhe procedurat ligjore.

Megjithatë, pavarësisht këtyre sfidave, ka pasur edhe disa arritje të rëndësishme. Gjatë viteve të fundit, institucionet e sistemit të Drejtësisë të koordinuar nga Ministria e Drejtësisë kanë bërë

përprjekje për të përmirësuar bashkëpunimin e tyre, duke nisur iniciativa të përbashkëta për zhvillimin e materialeve edukative dhe fushatave ndërgjegjësuese. Këto përprjekje janë pjesë e një procesi më të gjerë për të krijuar një sistem më të integruar dhe të koordinuar të edukimit ligjor, që synon të fuqizojë qytetarët dhe të përmirësojë qasjen e tyre në drejtësi. Aktivitete të përbashkëta janë zhvilluar kryesisht në ditë të veçanta për sistemin e Drejtësisë si Dita e Drejtësisë apo Java e Integritetit. Sidoqoftë, për të arritur sukses të plotë në këtë objektiv, do të nevojiten përprjekje të vazhdueshme dhe angazhim i fuqishëm nga të gjitha institucionet e përfshira, si dhe një qasje më e mirëkoordinuar dhe më e qëndrueshme ndaj zbatimit të reformave në sistemin e Drejtësisë.

Në këtë kontekst, Plani i veprimit të SND 2024–2030 parashikon realizimin e një serë aktiviteteve të përbashkëta midis institucioneve të drejtësisë për të rritur bashkëpunimin e tyre në kuadër të informimit ligjor të publikut mbi sistemin e drejtësisë.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030 ka rritje progresive të numrit të fushatave mediatike mbi kuadrin ligjor dhe sistemin e drejtësisë, për të rritur aksesin e qytetarëve në informacionin në këto fusha.

Lidhja e objektivit specifik me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objektivi Specifik 5.2 lidhet me Kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut”, me nenin 78 të MSA-së, “Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, dhe me nenin 88, “Bashkëpunimi statistikor”, të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektiv lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 5.2 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

5.2.1 Zhvillimi i fushatave të përbashkëta të institucioneve të drejtësisë mbi ELP;

5.2.2 Fushata ndërgjegjësuese dhe edukuese për publikun mbi legjislacionin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

5.2.3 Koordinimi dhe zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta të institucioneve të drejtësisë me OSHC-të dhe grupet e interesit me qëllim forcimin e bashkëpunimit për rritjen e informimit të qytetarëve mbi sistemin e drejtësisë;

5.2.4 Forcimi i bashkëpunimit me Fakultetet e Drejtësisë për ofrimin e ELP-së;

5.2.5 Rritja e Bashkëpunimit me Median për të Promovuar Ndërgjegjësimin Ligjor mbi sistemin e drejtësisë;

5.2.6 Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të institucioneve publike (nivel qendror e vendor) lidhur me zbatimin e ELP-së;

5.2.7 Forcimi i komunikimit dhe transparencës për të rritur mirëkuptimin dhe besimin e publikut në reformën në drejtësi dhe sistemin e drejtësisë.

Treguesit kryesorë:

- Numri i fushatave mediatike mbi kuadrin ligjor dhe sistemin e drejtësisë (çdo vit).

Objektivi specifik 5.3: Rritja e njohurive dhe kuptueshmërisë së publikut mbi proceset e integritetit evropian përmes iniciativave të edukimit ligjor të publikut.

Specifik 5.3 synon rritjen e njohurive dhe kuptueshmërisë së publikut mbi proceset e integritetit evropian përmes iniciativave të edukimit ligjor të publikut. Ky objektiv është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin e aspiratave të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duke qenë se kuptimi i proceseve të integritetit dhe harmonizimit me legjislacionin evropian është thelbësor për qytetarët dhe për institucionet publike.

Aktualisht, njohuritë e publikut mbi proceset e integritetit evropian dhe ndikimin e tyre në legjislacionin dhe praktikën gjyqësore në Shqipëri janë të kufizuara. Shumë qytetarë kanë një kuptim të përgjithshëm për integrimin evropian, por mungesa e informimit të detajuar dhe e kuptueshmërisë së ndryshimeve që sjell ky proces është një sfidë kryesore. Edukimi ligjor në këtë kontekst mbetet i fragmentuar dhe shpesh i orientuar vetëm ndaj grupeve të vogla të popullsisë. Ekziston një nevojë urgjente për të zgjeruar këto përprjekje, duke përfshirë një gamë më të gjerë të

popullsisë dhe duke përdorur mjete më të qarta dhe të aksesueshme për të përçuar mesazhet e rëndësishme.

Megjithatë, disa përparime janë bërë në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit të publikut për proceset e integritimit evropian. Gjatë 2023-shit, Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë disa iniciativa për rritjen e informimit ligjor të publikut mbi proceset e integritimit evropian. Me rëndësi është sidomos hartimi i broshurave informuese të përshtatura për nxënësit e shkollave 9-vjeçare me qëllim që edhe ata të kenë njohuri të mjaftueshme mbi këtë proces me rëndësi për shtetin shqiptar. Gjithashtu, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, tema e integritimit evropian është përfshirë në programin e trajnimit mbi edukimin ligjor për nëpunësit e administratës publike. Gjithashtu, MAS-i ka filluar analizën e kurrikulave arsimore me qëllim përfshirjen e temës së integritimit evropian në të gjitha kurrikulat e arsimit parauniversitar. Në të njëjtën kohë janë zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë fushata informuese që synojnë të shpjegojnë ndryshimet ligjore që vijnë si rezultat i procesit të integritimit dhe që janë të lidhura me standardet evropiane.

Një tjetër arritje ka qenë përfshirja e mediave në promovimin e këtyre iniciativave. Intervistat dhe programet televizive që trajtojnë tematikën e integritimit evropian dhe ndikimin e tij në Shqipëri kanë ndihmuar në zgjerimin e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë.

Megjithatë, pavarësisht se janë bërë disa hapa përpara në drejtim të rritjes së njohurive të publikut mbi proceset e integritimit evropian, mbetet ende shumë punë për të bërë për të siguruar që kjo njohuri të jetë e përhapur dhe e mirëkuptuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Për të arritur objektivat e plota të këtij objekti specifik, do të kërkohet një përpjekje më e madhe për të integruar temat e integritimit evropian në programet e edukimit ligjor dhe për të krijuar një strategji të përbashkët dhe të mirëkoordinuar midis të gjitha institucioneve të përfshira.

Rezultati i pritshëm:

- Deri në fund të vitit 2030 ka rritje progresive të edukimit ligjor të publikut përmes sesioneve të informimit mbi njohuritë dhe kuptueshmërinë e proceseve të integritimit evropian.

- Deri në fund të vitit 2030 ka rritje progresive të numrit të nxënësve të informuar mbi njohuritë dhe kuptueshmërinë e proceseve të integritimit në BE, si dhe të barazisë gjinore në këto procese..

Lidhja e objektivit specifik me nënkaptullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Objektivi Specifik 5.3 lidhet me Kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me nenin 2 të MSA-së, “Respekti për *parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut*”, me nenin 78 të MSA-së, “*Fuqizimin e institucioneve dhe shtetit të së drejtës*”, dhe me nenin 88, “*Bashkëpunimi statistikor*”, të MSA-së, e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare. Gjithashtu, ky objektivi lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, si dhe reflekton disa nga rekomandimet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2023. Objektivi specifik 5.3 lidhet me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Masat:

5.3.1 Rritja e ndërgjegjësimit mbi proceset e integritimit evropian përmes iniciativave të edukimit ligjor të publikut;

5.3.2 Integrimi i njohurive mbi ligjet dhe politikat e Bashkimit Evropian në kurrikulat kombëtare të arsimit;

5.3.3 Organizimi i aktiviteteve informuese në Ditën e Europës;

5.3.4 Aktivitete informuese dhe zhvillimi i programeve edukative mbi integrimin evropian në shkollat e arsimit bazë, të mesëm, dhe të lartë.

Treguesit kryesorë:

- Numri i sesioneve të informimit mbi procesin e integritimit në BE;

- Numri i nxënësve të informuar mbi procesin e integritimit në BE.

PJESA III
PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, KOORDINIMI,
MONITORIMI DHE VLERËSIMI

1. Përgjegjësia e institucioneve

Për zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030 “SND 2024–20230”, do të angazhohen kryesisht institucionet e pavarura, disa prej ministrive të linjës, akademia etj.

Ministria e Drejtësisë si institucioni lider në hartimin dhe monitorimin e politikave në fushën e drejtësisë, do të hartoj raporte monitorimi mbi zbatueshmërinë e planit të masave. Institucionet përgjegjëse për çdo masë sipas objektivave specifike dhe fushave të politikës janë të përcaktuar në matricën që gjendet në aneksin 1 të këtij dokumenti.

Institucionet të cilat janë angazhuar në hartimin dhe konsultimin e strategjisë dhe do të jenë përgjegjëse për zbatimin e saj janë:

Ministritë e linjës dhe institucionet në varësi:

- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Financave
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Social
- Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin
- Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsion
- Departamenti i Administratës Publike
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
- Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës
- Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
- Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas
- Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve
- Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
- Drejtorja e Përgjithshme e Përmbartimit
- Arkiva Gjyqësore Shtetërore e Drejtësisë

Institucionet e pavarura:

- Kuvendi i Shqipërisë
- Gjykata Kushtetuese
- Këshilli i Lartë Gjyqësor
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë
- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi
- Kolegji i Posaçëm i Apelit
- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
- Institucioni i Komisionerëve Publikë
- Shkolla e Magjistraturës
- Gjykata e Lartë
- Prokuroria e Përgjithshme
- Byroja Kombëtare e Hetimit
- Prokuroria e Posaçme
- Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
- Avokatura e Shtetit
- Avokati i Popullit

- Autoriteti i Medias Audiovizive
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë
- Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
- Dhoma Kombëtare e Noterisë.

2. Llogaridhënia dhe koordinimi

Kuadri monitorues do të shërbejë për orientimin e politikave në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) i cili është sistemi kryesor vendimmarrës që përcakton drejtimin strategjik dhe alokimin e burimeve të vendit.

Bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 90, datë 1.8.2023, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, mekanizmi i menaxhimit ndërsektorial të integruar do të veprojë përmes grupeve të menaxhimit të integruar të politikave dhe të ekipeve tematike.

Në mbledhjet e GMIP-së dhe të ekipit tematik në fushën e drejtësisë, ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga partnerët e zhvillimit, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare të pranishme në Shqipëri. Në këto mbledhje mund të ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues nga institucionet e pavarura, akademia, shoqëria civile dhe organizatat e biznesit në vend.

GMIP-ja do të sigurojë udhëheqjen për ndjekjen e zbatimit të bashkërenduar të politikave prioritare dhe reformave, përmes raportimit dhe monitorimit për masat e lidhura me synimet dhe objektivat prioritarë (prioritetet) në lidhje me strategjinë, reformat dhe sektorët e rëndësishëm të veçantë, si dhe detyrimet që burojnë nga angazhimet në kuadër të integritetit evropian, përmes qasjes së jetësimit të prioritetëve dhe masave organizative e strukturave të ngarkuara për këtë qëllim, raporteve periodike të progresit, raporteve të monitorimit etj.

GMIP-ja dhe ekipi tematik do të sigurojnë shqyrtimin, diskutimin, konsultimin dhe miratimin paraprak të “SND 2024-2030”.

Ekipi tematik do të diskutojë çështje të ecurisë së zbatimit të objektivave dhe masave të “SNMVK 2024–2030” dhe ku do të realizohet bashkëpunimi ndërinstitucional me grupet e interesit. Ky grup do të drejtohet nga Ministria e Drejtësisë dhe do të ketë në përbërje të tij përfaqësues nga institucionet e tjera ligjzbatuese, që janë përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e treguesve në kompetencën e tyre, duke krahasuar objektivat e treguesve të performancës së planifikuar me ata aktualë.

Ekipi tematik për zbatimin dhe monitorimin e strategjisë “SND 2024–2030” mbledh dhe analizon raportet periodike të masave për zbatimin e Planit të Veprimit të këtij dokumenti strategjik, vlerësimin e ecurisë së treguesve të performancës, propozon rekomandime, bazuar në gjetjet e raporteve periodike etj.

Objektivi i mbledhjeve do të jetë kryesisht:

a) Vlerësimi i progresit të arritur dhe niveli i zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit për përmbushjen e objektivave strategjike të parashikuara;

b) Identifikimi i problematikave të hasura me qëllim marrjen e masave të nevojshme në kohën e duhur për të siguruar realizimin, pajtueshmërinë dhe koordinimet e duhura në lidhje me planin e veprimit/aktivitetet/rreziqet/pasaportën e treguesve etj. deri në fund të vitit kalendarik;

c) Miratimi në parim i raporteve të monitorimit të përgatitura nga Sekretariati Teknik;

Ekipi Tematik do të mbështetet në veprimtarinë e tij nga Sekretariati Teknik (ST), i cili do të drejtohet nga Ministria e Drejtësisë.

Sekretariati Teknik do të ketë këto detyra:

a) Mbledh, analizon dhe vlerëson kontributin për çdo aktivitet dhe çdo tregues nga institucionet raportuese;

b) Komunikon tek institucionet vendimet e Ekipit tematik së bashku me udhëzimet e lëna nga ky i fundit;

c) Harton raportin e zbatimit të integruar çdo gjashtë muaj dhe në bazë vjetore;

d) Publikon vendimet e marra dhe dokumentet e miratuara;

e) Përgatit agjendat dhe dokumentacionin e duhur për mbledhjet që do të zhvillohen sipas rregullores së brendshme për Monitorimin e Strategjisë dhe Grupin e Punës.

f) Harton minutat e mbledhjeve dhe e shpërndan te të gjithë anëtarët e ekipit tematik.

Në aspektin cilësor të monitorimit, ST-ja mund të sugjerojë të përdorë metodat e mëposhtme për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë:

a) Përditësimin e përmbyshjes apo jo të masave, sipas planit të veprimit dhe në bazë të vetëvlerësimit të institucioneve;

b) Vlerësime tematike (sipas objektivave specifike të “SND 2024–2030”), sipas udhëzimeve të mekanizmit vlerësues, lidhur me efektivitetin e veprimeve të ndërmarra;

c) Komunikimin me palë të treta dhe shoqërinë civile për vlerësimin e masave të zbatuara;

Çdo institucion i përfshirë në planin e veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, raporton çdo 6 muaj dhe në bazë vjetore për nivelin e zbatimit të çdo objekti strategjik dhe aktiviteti, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi, ndërsa Ministria e Drejtësisë ka rol koordinues dhe raporton në mënyrë periodike mbi ecurinë e zbatimit të strategjisë.

3. Monitorimi dhe raportimi

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në strategji dhe planin e Veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara për përmbyshjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky dokument, konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale gjatë zbatimit të tij me qëllim përmbyshjen e objektivave në mënyrë sa më efektive.

Më konkretisht do të ndërmerren këto masa:

- do të monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji me bazë vjetore;

- do të rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat, risqet, si dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet e progres raporteve të Bashkimit Evropian dhe dokumenteve të tjerë ndërkombëtarë;

- do të sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;



- do të kryhet monitorim dhe do të hartohen raporte gjashtëmuajore/vjetore për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave dhe masave të planit të veprimit.

Në kuadrin e këtyre masave eksperiencia e monitorimit dhe raportimit të SND 2021–2025 ka evidentuar nevojën për ngritjen dhe përdorimin e një Mekanizmi të Paralajmërimit të Hershëm në kontekstin e monitorimit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale së Drejtësisë. Mekanizmi ka për qëllim të sigurojë që vlerësimi mbi ecurinë e Strategjisë të kryhet në çdo fazë të zbatimit të saj, dhe kur konstatohet se progresi është i pamjaftueshëm ose i vonuar, ekipi tematik dhe eventualisht GIMP-ja të njoftohen sa më parë, për të mundësuar marrjen e masave të nevojshme për të trajtuar çështjen nëpërmjet mekanizmit për menaxhimin e integruar ndërsektorial. Mekanizmi i Paralajmërimit të Hershëm është një instrument plotësues i nevojshëm në nivelin e menaxhimit dhe në nivelin teknik ndër-institucional, i cili parashikohet të aktivizohet në fazën e analizës të të dhënave të raportuara nga institucionet mbi zbatimin e masave dhe aktiviteve (nëse ka mungesë informacioni, apo informacioni është i pamfjatueshëm), dhe sipas nevojës në fazën e konsultimit në Ekipin Tematik, ose në GIMP.

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përfrimin e kuadrit strategjik dhe prioriteteve në fusha të ndryshme dhe të informojnë për politikatat e vendit të lidhura me avancimin drejt rezultateve të reformave në drejtësi. Përdorimi i Mekanizmit të Paralajmërimit të hershëm konsiderohet një element thelbësor për të siguruar progres në zbatimin e Strategjisë, sipas planit, dhe një koordinim ndër-institucional efektiv që mundëson diskutimin dhe trajtimin e çështjeve problematike në kohën e duhur dhe efektivisht. Mekanizmi do të mundësojë përparim efektiv në zbatimin e SND 2024–2030 dhe në realizimin e arritjeve të synuara duke pasur parasysh integrimin në BE.

Në përputhje me procedurat që do të ndiqen për raportim & monitorimin në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, *“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit*




informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)”, për përgatitjen e raporteve të monitorimit do të ndiqen fazat e mëposhtme.

- | | | |
|--------|---|---|
| Faza 1 |  | Marrja e të gjithë kontributeve nga institucionet raportuese dhe konsolidimi i paketës në përputhje me standardet e sistemit. |
| Faza 2 |  | Dërgimi i paketës së plotë për vlerësim pranë Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), në Kryeministri në përputhje me standardet e sistemit. Paketa e plotë do të duhet të përfshijë materialet e mëposhtme:

2.1 Raportprogresin e konsoliduar në përputhje me standardet e sistemit dhe metodologjinë e agjendës së mirëqeverisjes;

2.2 Planin e zbatueshmërisë së masave për periudhën referuese në përputhje me standardet e sistemit dhe metodologjinë e agjendës së mirëqeverisjes;

2.3 Pasaportën e treguesve në përputhje me standardet e sistemit IPSIS për periudhën referuese;

2.4 Bazën e të dhënave për vitin referues në zbatim të raportimit të treguesve të strategjisë. |
| Faza 3 |  | Konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), në Kryeministri. |
| Faza 4 |  | Organizimi i mbledhjes së Ekipit Tematik për konsultimin e paketës së konsoliduar dhe marrjen e komenteve nga aktorët. |
| Faza 5 |  | Reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së raportit të monitorimit. |



Ministria e Drejtësisë do të jetë institucioni udhëheqës, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike 6-mujore dhe 1-vjeçare që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara në përmbushje të objektivave dhe masave përkatëse.

Institucionet duhet të raportojnë periodikisht për realizimin e masave, me periodicitet 6-mujor përmes të dhënave të raportuara në Sistemin Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSI) në Këshillin e Ministrave dhe në Sekretariatit Teknik.

Përfaqësuesit në Ministrinë e Linjës do të punojnë me përfaqësuesit në nivel rajonal dhe vendor për të përmirësuar cilësinë e të dhënave. Nevojitet ngritja e kapaciteteve për të garantuar që të gjitha institucionet shtetërore përkatëse të mund të mbledhin të dhënat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të “SND 2024–2030” duke pasur në fokus reformat në drejtësi.

4. Vlerësimi

Për shkak të kohëzgjatjes shtatëvjeçare të zbatimit të strategjisë kombëtare dhe përputhjes së saj me OZHQ-të, është menduar që përveç monitorimeve të zbatimit të kësaj strategjie, të ketë edhe një proces vlerësimi të përgjithshëm gjatë vitit të katërt të zbatimit të saj. Bazuar mbi këtë vlerësim mund të ndryshohen/hiqen (nëse janë realizuar plotësisht) dhe shtohen jo vetëm veprime e masa, por edhe objektiva specifike nën qëllimet strategjike bazë të dokumentit.

PJESA IV ANALIZA E BUXHETIT

Në këtë kapitull të strategjisë paraqitet shpërndarja e kostove treguese dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve të Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Drejtësisë 2024–2030. Kostimi i Strategjisë u realizua mbështetur në metodologjinë dhe praktikën e planifikimit buxhetor, ndërsa vlerësimi i kostove indikative është mbështetur në objektivat dhe treguesit e përcaktuar për arritjen e tyre, si dhe në masat, aktivitetet dhe produktet e identifikuara për secilin aktivitet. Përlllogaritjet buxhetore janë bërë duke përdorur instrumentin e rekomanduar nga IPSIS, të përshtatur sipas udhëzimeve përkatëse.

Procesi i kostimit u mbështet, gjithashtu, në konsultimin me Programin Buxhetor Afatmesëm 2024–2026 (faza e II), në konsultimet me të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit, si dhe në kostot historike nga zbatimi i strategjive së mëparshme dhe strategjive të ngjashme. Në disa raste janë marrë në konsideratë dhe kostot e produkteve të PBA-së ose projekte të ngjashme.

Plani i veprimit për zbatimin e kësaj strategjie shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i mbështetur në një detajim të hollësishëm të shpenzimeve për çdo aktivitet.

Gjatë procesit të kostimit janë identifikuar shpenzimet për secilin aktivitet dhe ato janë klasifikuar në kategori shpenzuese të paracaktuara, sipas formatit IPSIS mbi metodologjinë e kostimit. Për kategori të caktuara shpenzimesh si pagat, shpenzimet e trajnimit, seminarët, shpenzimet e udhëtimeve, shpenzimet e ekspertëve dhe disa kategori pajisjesh janë përdorur kostot standarde të përcaktuara në metodologjinë e kostimit. Përlllogaritja e kostove është bërë sipas viteve financiare.

Kostoja e përgjithshme e përlllogaritur për zbatimin e planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Drejtësisë 2024–2030 është rreth 5.93 miliardë lekë, ose rreth 56.4 milionë euro. Kursi mesatar për referencë është përlllogaritur me 105 lekë për 1 euro.

Tabela e mëposhtme, pasqyron kostot indikative, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 7 viteve të zbatimit të Planit të veprimit 2024–2030.


Qëllimi i Politikave	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale	Kostot e Planifikuara	Kosto për tu	Hendeku Financiar
		2024-2030	PBA 2024-2026 Buxheti & Donator	Planifikuar në Buxhetin 2027- 2030	2024-2030
Qëllimi i Politikës 1. Konsolidimi dhe qëndrueshmëria e arritjeve të reformes në drejtësi në përputhje me standartet Evropiane	Korrente	480,575,845	280,055,535	189,426,630	11,093,680
	Kapitale	0	0	0	
Qëllimi i Politikës 2: Forcimi i pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë	Korrente	432,301,790	209,687,280	222,614,510	0
	Kapitale	1,050,000,000	577,500,000	472,500,000	
Qëllimi i Politikës 3. Rritja e efikasitetit të institucioneve në sistemin e drejtësisë	Korrente	1,312,029,036	555,109,344	643,523,352	175,396,340
	Kapitale	1,976,595,000	1,483,915,000	430,680,000	
Qëllimi i Politikës 4. Forcimi i cilësisë së drejtësisë	Korrente	149,226,314	64,509,378	80,316,936	188,400,000
	Kapitale	184,000,000	0	0	
Qëllimi i Politikës 5. Drejtësi më e afërt me qytetarët.	Korrente	344,317,455	75,627,267	209,330,188	59,360,000
	Kapitale	0	0	0	
TOTALI [Leke]		5,929,045,440	3,246,403,804	2,248,391,616	434,250,020
TOTALI [Euro]		56,467,099	30,918,131	21,413,253	4,135,714
<i>1 euro 105 Leke</i>					

Tabela: Kostot indikative të SND 2024–2030


Për periudhën afatmesme 2024–2026, kostoja është vlerësuar rreth 3.58 miliardë lekë, të cilat janë planifikuar në buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2024–2026, të institucioneve përgjegjëse për realizimin e masave.

Për periudhën 2027–2030, kostoja indikative për zbatimin e Strategjisë është rreth 2.33 miliardë lekë. Për këtë periudhë është supozuar që për aktivitete të caktuara në planin e veprimtimit do të jenë në dispozicion fondet nga Buxheti i Shtetit për shpenzime korrente dhe investime.


Hendeku financiar për të gjithë periudhën 2024–2030 është 434.2 milionë lekë ose 7.3% e kostove indikative. Për periudhën 2024–2026, buxheti i shtetit pritet të financojë 54.8% të kostove indikative totale të zbatimit të planit, ndërsa 37.9% janë shpenzimet e planifikuara për periudhën 2027–2030.



Shpenzimet kapitale përbëjnë 54.0% të kostove indikative, ndërsa kostot korrente 46.0%.




Të ndara sipas qëllimeve të politikave, kostot pasqyrohen në grafikun më poshtë.



Qëllimi i politikës III, pritet të ketë në terma financiarë peshën më të madhe në zbatimin e PV-së, përkatësisht 55.5%. Hendeku financiar kundrejt kostove totale për këtë qëllim politik është vetëm 5.3%.


Pesha e kostove totale për secilin qëllim politik kundrejt kostos totale




Shpenzimet për qëllimin politikë II janë sa 25.0% e kostove totale, ndërsa hendeku financiar kundrejt kostove totale është zero. Shpenzimet për qëllimin e politikës I janë sa 8.1% e kostove totale, ndërsa qëllimi IV dhe V zënë respektivisht 5.6% dhe 5.8% të kostos së përgjithshme të planit.

